Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 10-11 (137-138). TETOR/NËNTOR 2017. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Intervistë

Agron Tufa: Ka maja, por nuk po ka alpinistë

Nga **Arlinda Guma**

Reportazh

"Festa e të vjelave" - dita e begatisë

Nga **Alban Tufa**



Boks

Ferit Keta, dibrani kampion i gjermanisë në boks

Nga **Defrim Methasani**

QEVERIA ZHVILLON MBLEDHJEN NË DIBËR: JA PROJEKTET E RILINDJES URBANE

RRUGA E ARBRIT: prezantohet projekti, gati firmosja e kontratës

Darkë e qeverisë në Dibër: Çfarë u diskutua me Kryeministrin? Kreu i qeverisë: Rruga e Arbrit nga premtim në realitet. Me Rrugën e Arbrit, Dibra kthehet në kopshtin e Tiranës

Një nga paradokset e mëdha është se Dibra me pasuritë e saj ka ndihmuar në zhvillimin e vendit, shumë më tepër seç ka mundur të ndihmojë veten, sepse nga njëra anë, mungesa e rrugës, gjë që shumëkënd e bën të jetë hezitues për të ardhur deri këtu dhe nga ana tjetër, mungesa e vëmendjes që ndjehej kudo në Dibër deri përpara shumë pak vitesh kanë bërë që banorët e kësaj zone të jenë dëshmitarë vetëm fushatash elektorale dhe të tjerët të mos bëhen dot dëshmitarë të bukurive e të pasurive të jashtëzakonshme që ka kjo zonë.

Me përfundimin e Rrugës së Arbrit, ne nuk do kemi vetëm një aks të brendshëm, por edhe një pjesë të rëndësishme të një korridori ekonomik në rajon. Prandaj, në takimin me kryeministrin e Maqedonisë dakordësuam për të realizuar së shpejti një mbledhje të dy qeverive, ku në pikën e parë të rendit të ditës, qeveria jonë do të vendosi domosdoshmërinë që edhe pala maqedonase ta kompletojë Rrugën e Arbrit në krahun tjetër, me qëllim që përmes Dibrës, porti i Durrësit dhe zona të tjera të Shqipërisë që lidhen jo vetëm me Maqedoninë, por dhe me Bullgarinë, me Turqinë dhe më tej...

Lexoni në faqet 2-5

NË BRENDËSI: ■ Investimi i munguar për Llixhat e Peshkopisë ■ Rruga Burrel-Stelush-Peshkopi, një projekt që do rigjallërojë turizmin ■ Vetëm konstato e premto, apo ndrysho edhe realizo? ■ Diaspora shqiptare në SHBA, rubini i kombit shqiptar ■ Letërkëmbime nga larg me Moikom Zeqon ■ Lutfi Manjani, një nga sportistët më të shquar të Dibrës dhe jo vetëm… ■ Shkolla e parë shqipe në Kala të Dodës, mbartëse e traditave shekullore të dijes e shkollimit ■ Shkolla që i dha frymëmarrje minierës ■ Një takim mbresëlënës ■ Nerilda Meda: Ëndrrat ndiqen duke punuar fort! ■ Fatma Methasani: Gjithçka arrihet me pak inteligjencë, shumë punë, përkushtim dhe dashuri ■ Vjen në skenë premiera "Gangsteret e Sufllaqes" **SPECIALE BOTIME:** ■ Routledge boton veprën e Gëzim Alpion 'Takimet e Civilizimeve:Nga Aleksandri i Madh tek Nënë Tereza' ■ Islam Çenga: Dy pëllëmbë qiell ■ Pyetje në albanologji ■ Shtek më shtek e skutë më skutë ■ Funeral, roman nga Artan Gjyzel Hasani ■ Kalila dhe Dimna ■ Filozofia popullore ■ Vogëlushja Kejt dhe Udha jemi ne, dy botime nga Mimoza Tola ■ Nostalgji per socializmin ■ Televizori

Kërkohen korrespondentë në Peshkopi dhe Dibër të Madhe

Të interesuarit për korrespondentë/ menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email në adresën
<rrugaearberit@gmail.com>
ose të telefonojnë në numrin
069 20 68 603.

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 10-11 (137-138). Tetor-Nëntor 2017
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit tetor

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA
Samet ZAGRADI
Defrim METHASANI
Kontribuan për këtë numër:
Halil RAMA
Islam ÇENGA
Ramiz GJINI
Xhemail PECI
Qemal CENAJ
Viktor CENOSINAJ
Viron KONA
Xhafer MARTINI
Sulejman TOMÇINI
Artan Gjyzel HASANI
Arlinda GUMA
Besnik LAMI
Zabit LLESHI
Beqir SHEHU
Mevlud BUCI
Izet DIBRANI

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

DARKË E QEVERISË NË DIBËR: ÇFARË U DISKUTUA ME KRYEMINISTRIN?

Me Rrugën e Arbrit, Dibra kthehet në kopshtin e Tiranës

Nga **BUJAR KAROSHI**

Më 10 nëntor, u bëra pjesë e një darkë që qeveria shtroi me anëtarët e saj të kabinetit, funksionarë dhe punonjës të administratës.

Salla e katit të poshtëm të Hotel "Verit", aty ku qeveria kishte zhvilluar më parë mbledhjen e saj, ishte e mbushur plot. Në secilën tavolinë ishin vendosur drejtuesit e ministrisë përkatëse dhe vartësit e saj në qark.

Në tavolinën nr. 1, përveç kryeministrit, ishte edhe zëvendësja e tij, Senida Mesi, deputetët e Dibrës, Ilir Beqja dhe Almira Xhembulla, prefekti i Dibrës Nexhbedin Shehu, Bajram Krrashi, ish drejtues lokal dhe një investitor i suksesshëm, kryetarët e katër bashkive të qarkut, Muharem Rama, Nezir Rizvani, Basir Çupa dhe Melaim Damzi, përkatësisht kryetarët e bashkive Dibër, Mat, Klos dhe Bulqizë, dhe kryetari i Këshillit të Qarkut Dibër, Hajri Laçi. Të gjithë së bashku janë rreth një tavoline, që më shumë se një darkë, ishte një tryezë debati dhe diskutimesh.

"Ju ftoj të kaloni një dark të këndshme, tha kryeministri Rama në fillim, dhe më pas u kujtoi të gjithë anëtarëve të kabinetit, që në fund të darkës, nga secila tavolinë të raportohej mbi problematikat e diskutuara".

Dhe Kryeministri e nis bisedën me kryebashkiakun e Matit, ku pak ditë më parë, shpërtheu një sasi tritoli në shkallët e pallatit ku banon. Kryeministri kërkon të dije më shumë rreth kësaj ngjarje, por asgjë nuk mësohet më shumë se sa shtypi ka njoftuar. Të dy bien dakord se ajo mund të ishte një mjet presioni.

Më pas, Kryeministri thotë se "më në fund, kemi arritur një rezultat të mirë në lidhje me rrugën e Arbrit". Ai tregon se për këtë çështje morën shumë kohë negociatat me kompaninë kineze, për të cilën, tha se ishin të detyruar të vazhdonin negociatat. Por tani jemi të kënaqur, sepse jemi në prag të nënshkrimit të marrëveshjes e cila është shumë favorizuese nga ana financiare.

Më pas, kryeministri flet për atë që do të fitojë jo vetëm Dibra me ndërtimin e rrugës së Arbrit, por edhe Tirana dhe Durrësi.

"Kur ne morëm ekspertët austriakë të na ndihmonin në ndarjen e rajoneve, ata na kështilluan se rajoni funksional nuk do të ishte trekëndëshi Elbasan-Tiranë-Durrës, por Durrës-Tiranë-Dibër.

Me Rrugën e Arbrit Dibra do të kthehet në kopshtin e pasmë të Tiranës" tha ai.

Kryeministri flet edhe për avantazhet që do të sjellë rruga, për fshatrat e bashkisë së Klosit, Xibër Murrizë, Drezës, Bastar. Ai thotë se kishte qenë më parë në këto zona dhe ishte e paimagjinueshme për të, që këto fshatra kaq pranë Tiranës, të jenë të izoluara.

Kryebashkiaku i Klosit thotë se në këto fshatra, përfshirë edhe Zall Bastarin në Tiranë, njihen për prodhimin e perimeve, sidomos të domates, por kanë vështirësi në nxjerrjen e tyre në treg. Kryeministri diskuton me të mbi mundësitë e sigurimit të tregut, dhe e fton atë të hartojë një projekt në lidhje me një frigorifer për ruajtjen e prodhimeve bujqësore.

Më pas, ai pyet kryebashkiakun e Matit, se pse matjanët nuk e duan investimin në rrugën e Arbrit. Ai thotë se një ditë më parë, gjatë një bisede me pronarin e "Gjoka Konstruksion", ky i fundit kishte theksuar me rëndësi në projektin e rrugës, lidhjen e Rrugës së Arbrit me Klosin dhe Burrelin. Sipas tij, kjo do ta afrojë shumë qytetin e Burrelin me Tiranën. Banorët e Matit nuk e kanë dashur këtë investim, pasi ata janë për të investuar në një rrugë tjetër që e lidh më shkurt Burrelin me Tiranën.

Neziri thotë se kjo nuk është plotësisht e vërtetë. Është e vërtetë që matjanët kanë një ide për një lidhje më të shkurtër me kryeqytetin përmes Qafë Shtamës, por me Rrugën e Arbrit distanca shkurtohet rreth 50 km, dhe ky është një avantazh i madh për të gjithë bashkinë.

Deputeti Beqja ndërhyn në bisedë dhe kërkon të dijë për se si po shkojnë investimet në bashkinë e Klosit, kryesisht unaza. Ai bën një vërejtje për unazën, pasi lidhja e saj me rrugën aktuale bëhet pingul në dalje të urës dhe krijon vështirësi në qarkullim.

Kryeministri Rama e përshkruan rrugën si skandaloze, si një tmerr që shpreson t'i jepet zgjidhje sa më shpejt.

Kryebashkiaku i Klosit thotë se ka vështirësi në atë segment, pasi është një urë e vjetër si dhe ka ndërtime rreth e rrotull. Por Kryeministri i kërkon që sa më shpejt të hartojnë projektin e urës, madje bashkë me projektin e shëtitores dhe sa më parë të sigurojmë financim për ndërtimin e saj. Po ashtu, kryebashkiaku i Klosit kërkoi mbështetje edhe për restaurimin e Kalasë së Petralbës, për të cilën kryeministri kërkoi të dinte mbi gjendjen aktuale të saj si dhe një projekt rehabilitimi, që do ta financonin menjëherë.

Është po deputeti Beqja që kërkon vëmendjen e kryeministrit për disa çështje të tjera në qark, sidomos ajo e mbylljes së thertoreve, që ka krijuar probleme, sidomos në furnizimin e institucioneve publike, spitaleve dhe kopshteve me mish, për zgjidhjen e së cilës, i kërkon kryeministrit të ndërhyjë që ato të rihapen sërish, së paku edhe 2-3 muaj, deri sa disa thertore në qytet plotësojnë kushtet.

Edhe për këtë çështje, Kryeministri thekson nevojën e zgjidhjes së problemeve në mënyrë afatgjatë, jo për momentin. Ai i fton kryebashkiakët që të jenë me aktiv në lidhje me projektet për sigurinë ushqimore, dhe qeveria është e gatshme që të financojë projekte për thertorët apo pikat e grumbullimit. Për këtë, ai i ftoi ata që të jenë më bashkëpunues edhe me bizneset që operojnë në këtë fushë, duke nxitur krijimin e ndërmarrjeve të përbashkëta.

Në tavolinë shtrohen për diskutim edhe probleme të tjera lokale, si ujësjellësi i Maqellarës, që megjithëse është ndërtuar, akoma nuk është vënë në funksionim apo probleme që kanë të bëjnë me sipërmarrjen. Për të gjitha rastet, Kryeministri i referohet ligjit përkatës për zgjidhjen e problemeve.

Më pas biseda shkon rreth buxhetit të ri. Kryebashkiaku i Matit i kërkon kryeministrit që në buxhetin e ri, të kihet parasysh që bashkitë të marrin një tarifë mbi pasuritë e tjera nëntokësore, ashtu siç u jepet bashkive për mineralet. Dhe solli rastin e ujit, përdoruesit e së cilës, kryesisht kompani të mëdha, e paguajnë një taksë fikse mbi xhiron për shtetin, por bashkitë nuk fitojnë asgjë.

Kryeministri fton Arben Ahmetajn, ministrin e Financave, që të dëgjojë sugjerimin e kryetarit të Matit. Ai nuk është dakord me këtë propozim, por Kryeministri, kur e kupton se për çfarë shumash bëhet fjalë, ndërhyn sërish: Le t'ua japim atë taksë! Me ato lekë ata (bashkitë) do të lyejnë ndonjë kopësht apo shkollë... Dhe biseda mbetet e hapur për diskutim.

Shkon nga shkon biseda, sërish dilet te Rruga e Arbrit. Pa të, çdo gjë duket e largët.

Deputeti Beqja thotë se me Rrugën e Arbrit lidhja me Lurën do të jetë shumë shpejt. Ai hedh idenë e ndërtimit të një tuneli, rreth 1 km, dhe nuk është e nevojshme që të ndërtohen rrugë malore, por nga fshati Çidhën dilet direkt në Gurë Lurë. Edhe kosto për këtë rritet vetëm me 1 milionë euro.

Po ashtu, ai hedh edhe idenë e ndërtimit të në aksi tjetër që lidh zonat e Selishtës me fshatin Zogje dhe prej aty bëhet lidhja me rrugën e Arbrit në Shupenzë.

Në fund, nga çdo tavolinë raportohet për problematikat e konstatuara. Shumë prej tavolinave bëjnë falenderimet dhe arritjet, por në disa prej tyre shprehen edhe shqetësimet.

Nga tavolina e Ministrisë së Arsimit raportohet për problematikat e hasura në klasat kolektive; nga ajo e Ministrisë së Brendshme nevoja për zyra të policisë në çdo njësi administrative, nga ajo Ministrisë së Shëndetësisë mbi nevojat në pajisje dhe mjekë, etj. Ministria e Energjisë kërkon më shumë fillëronjës gjatë periudhës së dimrit në detyrë, ndërsa Ministria e Kulturës raporton mbi nevojën e disa investimeve në vendlindjen e Skënderbeut, siç është Muzeu në Sinjë, etj.

Më të ashpra dhe më problematike u raportuan probleme në fushën e Ministrisë së Bujqësisë, ku është konstatuar se subvencionet në këtë drejtim kanë qenë joeficente. Ka fermerë që i kanë prerë mollët apo të tjerë që investimet në arrorë janë lënë në dorë të fatit, apo çmimet e ulura në treg për shkak të presionit mbi prodhuesit: shite lirë ose le të kalbet. Zëvendësministri mendon se duhet ndërhyrë urgjent në këtë drejtim, pasi kështu, investimet në këtë fushë në gjithë këto vite, rrezikohen të kthehen në pikën zero.

Shto pak qe ne tavolin

***

Kur takimi po shkon drejt fundit, deputeti Ilir Beqja më fton të kyçem në bisedë: Çfarë do të bëni me gazetën, tani që rruga do të fillojë?...

- Do ta bëjmë më të mirë, i them. Më pas shpjegoj shkurtimisht një histori gati 11 vjeçare të gazetës dhe më shumë se 25 vite në shoqërinë civile në përpjekjet për sensibilizimin e kësaj rruge.

"Atë që ekspertët austriakë kanë konfirmuar në ndarjen e re rajonale, ku Dibrën e kanë vendosur në një rajon me Tiranën e Durrësi, gazeta jonë vazhdimisht e ka përcjellë përmes shkrimeve të posaçme nga specialistë të fushave përkatëse. Theksova se gazeta nuk është vetëm një lobuese për këtë çështje, por po me të njëjtin seriozitet trajton edhe problematika të tjera të qarkut të Dibrës, si dhe është një hapësirë promovuese për turizmin, bujqësinë, artin dhe kulturën; gjithçka të mirë që ka Dibra.

Shpreha besimin se nga pikëpamja e leverdishmërisë ekonomike, Dibra do ta shlyejë shumë shpejt investimin në rrugën e Arbrit, por shpreha edhe shqetësimin e dyshimeve tona në lidhje me projektin aktual, pasi nëse segmentet e tenderuar që do të ndërtohen plotësisht të reja, premtohet se do të jenë sipas standardeve europiane, por segmenti i ndërtuar nga Fushë - Bulqiza deri të Ura e Çerenecit nuk i përmbush këto standarde, çka do të bëjë që rruga të jetë e mirë për Dibrën, por ajo nuk do ti kapë standardet që ne kërkojmë: lidhjen e Durrësit me Shkupin.

Beqja thekson se për standardet nuk duhet të ketë asnjë dyshim, pasi kompania do të paguhet 13 vite pas ndërtimit, kështu që ajo është në radhë të parë e interesuar për një ndërtim me standarde.

Më herët, Kryeministri kishte shprehur edhe besimin se edhe negociatat që do të vazhdojnë me qeverinë e Maqedonisë, do të jenë të suksesshme, me qëllim që edhe atje të ndërtohet rruga sa më shpejt, në mënyrë që Shkupi dhe Tirana t'a shkurtojnë distancën mes tyre në rreth 100 km.

kryesore

Fjala e Kryeministrit Edi Rama në prezantimin e projektit të Rrugës së Arbrit

Rruga e Arbrit nga premtim në realitet

Nga **EDI RAMA**

Viti i ardhshëm është viti i 550-vjetorit të vdekjes së Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriot Skënderbeut. Duke filluar nga 28 Nëntori deri në 28 Nëntorin e ardhshëm, qeveria e ka shpallur Vitin e Skënderbeut, i cili është një vit që pak më shumë se gjithë të tjerëve i përket zonës së Dibrës, sepse është pikërisht këtu, në tokën e kësaj krahine, ku mori jetë edhe legjenda e gjallë e Skënderbeut dhe bashkë me të mori jetë dhe historia e shtetformimit të Shqipërisë.

Viti i ardhshëm është viti i Skënderbeut dhe njëkohësisht është viti i Dibrës, sepse 19 nga 24 betejat e tij më të famshme u zhvilluan në Dibrën shqiptare, në Dibrën këndej dhe andej kufirit të sotëm. Svetigradi, Oraniku, Uji i Bardhë, Vajkali janë vetëm disa prej emrave të këtyre betejave që na kanë mbetur në mendje, qysh kur e kemi lexuar për herë të parë historinë e Skënderbeut, ku u shkrua me germa të arta një përpjekje kolosale e shqiptarëve.

Megjithatë, ndonëse kanë kaluar pothuajse 6 shekuj, në shumicën e këtyre vendeve që përmenda, përsëri, mënyra më e thjeshtë për të shkuar është si në kohën e Skënderbeut, me kalë, sepse rrugët, edhe aty ku ekzistojnë janë në gjendje aq të mjerueshme, saqë nuk ka automjet që të konkurrojë kalin. E gjithë krahina e Dibrës, në fakt, për çerekshekulli pas rënies së komunizmit u la në një izolim shumë të thellë. Rrënimi që në trashëguam ishte vepër e harresës së të gjitha qeverive të mëparshme ndaj një zone ku ka mjaftueshmërisht pasuri natyrore, trashëgimi historike dhe kulturore, që jo vetëm banorët e të gjithë Qarkut të Dibrës, por edhe vetë ekonomia jonë kombëtare të mund të ishin sot në një situatë krejt tjetër.

Është fakt se po të shkosh mbrapsht dhe të hapësh librat e Shqipërisë-shtet në këto 25 vjet të para, gjen më shumë emra koncesionarësh dhe më shumë kontrata koncesionesh për ndarjen e galerive të minierave, si të ishin thelat e një mishi pa zot, sesa investime për të gjithë këtë krahinë të bekuar me pasuritë dhe bukuritë e saj. Një nga paradokset e mëdha është se Dibra me pasuritë e saj ka ndihmuar në zhvillimin e vendit, shumë më tepër seç ka mundur të ndihmojë veten, sepse nga njëra anë, mungesa e rrugës, gjë që shumëkënd e bën të jetë hezitues për të ardhur deri këtu dhe nga ana tjetër, mungesa e vëmendjes që ndjehej kudo në Dibër deri përpara shumë pak vitesh kanë bërë që banorët e kësaj zone të jenë dëshmitarë vetëm fushatash elektorale dhe të tjerët të mos bëhen dot dëshmitarë të bukurive e të pasurive të jashtëzakonshme që ka kjo zonë.

Rruga e Arbrit është shfaqur si premtim, sa herë janë shfaqur këtu politikanët, kur u janë dashur votat dhe është harruar si premtim, sa herë kanë mbaruar zgjedhjet, deri kur ne e morëm seriozisht përsipër këtë zotim, me vetëdijen se Rruga e Arbrit nuk është thjeshtë një rrugë që do lidhë një zonë me një zonë, por është një zhvillim strategjik për ekonominë, për punësimin dhe padyshim për turizmin, që do të sjellë shumë zhvillim dhe shumë punësim në të gjithë këtë zonë.

Për të mos shkuar shumë larg, vetëm pak vite më parë, një paraardhësi im thoshte, "ky 4-vjeçar, (4-vjeçari para këtij që iku) do të jetë 4-vjeçari i përfundimit të rrjetit modern rrugor, që do të përgjysmojë distancën me Tiranën nga të gjithë skajet e vendit" dhe përmendte skaje pas skajesh dhe vjen deri te Dibra. Pra, sipas këtyre fjalëve, sot duhet të kishim ardhur ne nga Rruga e Arbrit dhe duhet të ktheheshim nga Rruga e Arbrit. Pastaj shkonte më tutje dhe thoshte "brenda dy viteve (pra, këtu e 6 vjet më parë) do përfundojë Rruga e Arbrit, do përfundojë Qafë Plloçë-Kukësi, do përfundojë boshti i

> Një nga paradokset e mëdha është se Dibra me pasuritë e saj ka ndihmuar në zhvillimin e vendit, shumë më tepër seç ka mundur të ndihmojë veten, sepse nga njëra anë, mungesa e rrugës, gjë që shumëkënd e bën të jetë hezitues për të ardhur deri këtu dhe nga ana tjetër, mungesa e vëmendjes që ndjehej kudo në Dibër deri përpara shumë pak vitesh kanë bërë që banorët e kësaj zone të jenë dëshmitarë vetëm fushatash elektorale dhe të tjerët të mos bëhen dot dëshmitarë të bukurive e të pasurive të jashtëzakonshme që ka kjo zonë.

> Me përfundimin e Rrugës së Arbrit, ne nuk do kemi vetëm një aks të brendshëm, por edhe një pjesë të rëndësishme të një korridori ekonomik në rajon. Prandaj, në takimin me kryeministrin e Maqedonisë dakordësuam për të realizuar së shpejti një mbledhje të dy qeverive, ku në pikën e parë të rendit të ditës, qeveria jonë do të vendosi domosdoshmërinë që edhe pala maqedonase ta kompletojë Rrugën e Arbrit në krahun tjetër, me qëllim që përmes Dibrës, porti i Durrësit dhe zona të tjera të Shqipërisë që lidhen jo vetëm me Maqedoninë, por dhe me Bullgarinë, me Turqinë dhe më tej...

jugut, trajektoret në Elbasan, Belsh-Kuçovë, Kardhiq-Delvinë, Konispol-Sarandë, do përfundojë autostrada Fushë Krujë-Ura e Limuthit dhe do shndërrohet në 4 korsi autostrada Shkodër-Vlorë". Keni parë ju ndonjë gjë nga këto? Zero. As për dy vjet, as për 4 vjet. Në fakt, ajo që keni parë ju dhe kanë parë të gjithë kanë qënë shiritat e pafundmë që janë prerë për këto rrugë dhe kilometrat e numëruara në letër, që i janë treguar popullit si kilometra të realizuar në realitet.

E vërteta është që gjithçka trashëguam nga ai kapitull ishte një mal me borxhe dhe rrugët të gjitha të lëna rrugëve. Vetë Rruga e Arbrit u la rrugëve pa filluar, me disa shfaqje mizerabël elektorale, me disa shirita e me daulle për një copë të vogël këtu, një copë të vogël atje, vetëm për t'iu hedhur hi syve njerëzve.

Sot, ne jemi këtu për t'ju thënë se tanimë, Rruga e Arbrit nuk është më as ëndrra shekullore e dibranëve, që këtë rrugë e kanë dashur të paktën prej një shekulli, as nuk është më një premtim politikanësh, por është një zotim i mbajtur, për të cilin ne jemi angazhuar qysh ditën e parë këtu e 4 vjet. Ky është momenti edhe për t'ju treguar sot, - sepse kur e tregoja më parë dukeshin si justifikime, - se çfarë kemi fituar me këtë vonesë. Rruga e Arbrit do të ndjekë rrugën e vjetër të karvanëve që e kanë lidhur historikisht Tiranën me Dibrën dhe do ta bëjë Dibrën mushkërinë tjetër të metropolit të Shqipërisë, bashkë me Durrësin, me Tiranën, si shtyllën kurrizore të këtij metropoli.

Është një rrugë shumë më e shkurtër dhe do të zgjidhë një problem kaq të madh, që i ka torturuar prej çerekshekulli, të paktën, të gjithë dibranët, nga Peshkopia në Klos, në Burrel dhe në Bulqizë. Nëse gjurma ekzistuese sot për të shkuar nga këtu në Tiranë është 125 km e gjatë dhe mirë që është 125 km, por është në atë derexhe që është në një pjesë të konsiderueshme të saj, segmenti i ri e bën Bulqizën vetëm 30-40 minuta nga Tirana dhe natyrisht, me standarde europiane, jo me standarde kalorësish.

Nga ana tjetër, nëse Tiranë-Bllatë është sot 160 km, atëherë, segmenti i ri e bën kufirin me Maqedoninë vetëm 75 km. Rruga e Arbrit ka një gjurmë që është pothuajse e drejtpërdrejtë. Me përfundimin e Rrugës së Arbrit, ne nuk do kemi vetëm një aks të brendshëm, por edhe një pjesë të rëndësishme të një korridori ekonomik në rajon. Prandaj, në takimin me kryeministrin e Maqedonisë, në tetor, dakordësuam për të realizuar së shpejti, në Pogradec, një mbledhje të dy qeverive, ku në pikën e parë të rendit të ditës, qeveria jonë do të vendosi domosdoshmërinë që edhe pala maqedonase ta kompletojë Rrugën e Arbrit në krahun tjetër, me qëllim që përmes Dibrës, porti i Durrësit dhe zona të tjera të Shqipërisë që lidhen jo vetëm me Maqedoninë, por dhe me Bullgarinë, me Turqinë dhe më tej të mund të aksesohen më shpejt.

Në fund të katër viteve të ardhshme, ne duam që jo vetëm Shqipëria të jetë më afër se asnjëherë Bashkimit Europian, por rrugët tona të jenë europiane. Sot, ne nuk kemi asnjë rrugë europiane. Rrugë europiane do të thotë një rrugë e certifikuar sipas standardeve të Bashkimit Europian, që garanton lëvizshmërinë dhe sigurinë e jetës së njerëzve.

Më thoni një rrugë ku nuk ndihesh i rrezikuar? Më thoni një rrugë ku hyn dhe del në fund, pa pasur kërcënimin e gjithfarëlloj ndërhyrjeve dhe interferencave të makinave, të njerëzve, apo edhe të kafshëve?

Nuk ka asnjë!

Për të mos thënë që rrugët tona, ato rrugë për të cilat janë harxhuar miliarda, janë ndërtuar edhe në një aks me standarde të ndryshme. Fillon me një standard, vazhdon me një standard tjetër, ecën me një standard tjetër. Për të dhënë një shembull më të thjeshtë, është njësoj sikur rrobaqepësi të më marrë mua masën për një kostum, por masën e mëngëve t'ia marrë Erion Braçes, masën e shpatullave t'ia marrë Mimi Kodhelit dhe unë ta vesh. Edhe pantallonat Bashkim Finos. Kështu janë rrugët e Shqipërisë. Ose e kundërta, t'i qepin Erionit ose Bashkimit kostum, me masën time për pantallona. Rrugë komplet jashtë çdo standardi.

Ne duam që të gjitha këto rrugë t'i fusim në standard. Ne duam që kur të shkosh nga Tirana në Vlorë, të shkosh me standarde europiane, me siguri të plotë përsa i takon kërcënimit që iu vjen drejtuesve të automjeteve, njerëzve që janë në automjete nga të tjerët që futen në rrugë nëpër shtigje që do të mbyllen të gjitha.

Ne duam që rruga nga Tirana drejt veriut, qoftë drejt Shkodrës dhe Malit të Zi, qoftë drejt Kukësit dhe Kosovës, në të gjithë gjatësinë e saj të jetë me standarde europiane.

Ne duam të njëjtën gjë për rrugën që shkon drejt Korçës.

Ne duam të njëjtën gjë për të gjitha akset kryesore të Shqipërisë, edhe për rrugën që shkon nga Vlora në Himarë e me radhë.

Ne për këtë jemi shumë të përgatitur dhe më vjen shumë mirë që rruga e parë me

(Vijon në faqen 4)

Rruga e Arbërit nr. 137

aktualitet

Rruga e Arbrit nga premtim në realitet

(Vijon nga faqja 3)



standarde europiane, nga fillimi në fund do të jetë Rruga e Arbrit, që do të jetë një rrugë edhe spektakolare për faktin se kalon përmes një natyre të mrekullueshme, që deri më sot ka mbetur tërësisht e izoluar nga shqiptarët, që as nuk e dinë fare se ekziston gjithë ajo pjesë e mahnitshme e natyrës dhe një natyrë e mrekullueshme që do të kthehet tamam në oborrin e pasmë të metropolit tonë, ku njerëzit që kanë emigruar do të shikojnë mundësitë për të investuar në turizëm, në agro-turizëm, në ferma bujqësore dhe blegtorale, që do të sjellin ekonomi, do të sjellin punësim, do të sjellin zhvillim.

Tani, më lejoni t'ju shpjegoj ato që deri dje dukeshin si justifikime. Ne sot kemi një rrugë që është projektuar me një dobishmëri shumë më të lartë, sesa projekti që trashëguam. Ne trashëguam një projekt dhe një marrëveshje të bërë me sy mbyllur, si të gjitha marrëveshjet që bënte më parë paraardhësi im, për një segment vetëm 26 kilometra, me një standard më të ulët, C3, ndërtimin e tunelit vetëm me një hyrje, me një tub dhe pa tub emergjence, d.m.th., që në fillim jashtë standardit të Bashkimit Europian dhe me kërcënim për sigurinë e njerëzve.

Në rast se ne do të kishim ecur me atë projekt, që ishte shumë i shtrenjtë, ne nuk do ta mbaronim dot rrugën. Edhe një tjetër rrugë që do mbetej rrugëve me filozofinë, "ta fillojmë njëherë, pastaj shohim e bëjmë". Nuk do vihej dot në funksion, sepse do të mbetej 1.1 kilometër për të bërë lidhjen me Tiranën dhe do të mbeteshin 9.1 kilometra për të shkuar në Bllatë, pjesë që as nuk ishin marrë parasysh dhe që sot janë të përfshira në projektin e ri. Nuk do të mund të ndërhynim dot në atë projekt në 15 kilometra që janë filluar dhe janë lënë rrugëve dhe nuk kanë as shtresa, as mbrojtje skarpatesh, as sinjalistikë. Pra, Rruga e Arbrit do ishte, hyr në një rrugë siç duhet dhe pastaj, po dole në fund, dole, duke vazhduar në një segment me gropa e me rreziqe nga të katër anët. Nuk ishte parashikuar degëzimi i Klosit, që faktikisht do të bënte që Klosi dhe Burreli të mos kishin akses në Rrugën e Arbrit. Për çfarë? Për 3.1 kilometra. Nuk do mund të bënim dot atë që do bëjmë me këtë projekt, rindërtimin e segmentit Maqellarë-Bllatë, që është jashtë standardit sot, është një shteg.

Vlera e këtij projekti, me pothuajse gjysmën e kilometrave që do ndërtohen sot, ishte më e madhe, sesa vlera e këtij projekti që është pothuajse dyfishi i kilometrave e që do t'i japë mundësi jo vetëm Bulqizës, apo Peshkopisë, si zona, por dhe Klosit e Burrelit, që të shkurtojnë dramatikisht distancën. Janë 90 kilometra në një shteg për të shkuar nga Burreli në Tiranë. Do bëhen 50 km, gjysmë për gjysmë dhe koha do jetë shumë më e shpejtë. Pa llogaritur Klosin që do të shkurtohet në 30 kilometra, ndërkohë që për të shkuar sot në Tiranë nga ajo rruga e dhive ka më shumë se 100 kilometra.

Rruga e sotme që u prezantua dhe që do fillojë nga puna na jep mundësinë që brenda një harku kohor, që është brenda këtij mandati nuk diskutohet, por që ne besojmë se do të jetë vetëm 3 vjet, ta kemi të përfunduar njëherë e mirë këtë rrugë që është një ëndërr 30 x (shumëzim) shtojeni vetë sa vjet e parealizuar, e gjithë kësaj zone.

Përfitoj nga rasti t'ju them ju dhe atyre që na ndjekin, - se nuk na ndjekin vetëm njerëzit që jetojnë në këtë zonë, por edhe të tjerë që janë jashtë kësaj zone, ose edhe jashtë Shqipërisë, - ne kemi buxhetin e vitit 2018, falë reformave, falë edhe dhimbjeve e sakrificave të bëra për reformat që bëjnë shtet, 42% më shumë financime për infrastrukturën, sesa në buxhetin e një viti më parë, që do të shkojnë jo vetëm për rrugët, por edhe për ujësjellës dhe kanalizime.

Përsëri dua ta nënvizoj, 90 ditë kohë, - tani janë disa ditë më pak, - kanë të gjithë ata që janë të lidhur në mënyrë të paligjshme me sistemin e ujësjellësit për të marrë ujë të pijshëm, që të shkojnë dhe të legalizojnë lidhjen e tyre. Çfarë iku, iku! Nuk do u kërkojë njeri para për çfarë kanë marrë deri më sot qyl, duke abuzuar në kurriz të atyre që e paguajnë, por në 1 shkurt nuk do përgjigjen më përpara ndërmarrjes, por përpara Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Uji është pasuri kombëtare. Uji nuk mund të vidhet. Mbi të gjitha është një pasuri që ne do ta kthejmë në mirëqenie, jo ta kemi problem, siç e kemi prej kaq shumë vitesh, pikërisht sepse e abuzojmë dhe e shpërdorojmë.

Në Shqipëri, për 1 litër nevojë shpërdorohen 4 litra ujë. Në Shqipëri, sikur ne të jemi normal në marrëdhënie me ligjin, në marrëdhënie me shtetin e komunitetin dhe secili të marrë përsipër atë që i takon, na mjafton 1% e pasurisë ujore që kemi, që të plotësojmë të gjitha nevojat për ujë. Është një turp shumë i madh për të gjithë ne, që jemi vendi i dytë më i pasur në Europë për ujë. Uji, sot konsiderohet nafta e shekullit XXI. Të tjerët nuk e kanë dhe ne të jemi shumë më keq se ata që nuk kanë ujë. Ky është një turp i qeverive shqiptare, një turp i politikës shqiptare, por është një turp që na mbetet të gjithëve si popull dhe si shoqëri, nëse nuk bëhemi të vetëdijshëm se secili duhet të japë kontributin e vet për aq sa konsumon.

Mos u merrni me puset, se nuk ka thënë njëri që do të vëmë taksë për puset e gjyshit, për puset e Skënderbeut. Nuk ka asnjë lloj takse, se nuk është taksë. Çmimi i ujit nuk është taksë, është mall. Do blesh mallin. Por nuk merremi me puset, as me ato që janë hapur për vaditje, aty ku nuk ka sistem vaditës, se nuk mund t'iu themi njerëzve, mbyllni puset dhe rrini pa ujë, për sa kohë shteti nuk i ka çuar ujë për vaditje. Thjesht, puset që janë për vaditje duhen regjistruar. Pastaj, në të ardhmen do t'iu takojë ndërmarrjeve të ujësjellësit të bëjnë atë që shohin të arsyeshme.

E dini që ka kompani që shesin ujë dhe e blejmë ne të gjithë. Nga e marrin ujin, nga shiu, nga lart? Jo, e marrin nga poshtë, nga toka. Prodhojnë me miliona litra dhe nuk paguajnë asgjë. Tani, për pusin e tyre duhet të paguajnë të tjerët?

Të tjerë që ndërtojnë resorte turistike dhe e marrin ujin vetë nga poshtë për të furnizuar të gjitha vilat, a duhet ta paguajnë ujin? Puse janë dhe këto. Për këto puse e kemi fjalën ne. Puset e tjera, ato që janë për vaditje do të regjistrohen dhe aty ku sistemi i vaditjes është në rregull, pastaj do të merret vetë bashkia, kompanitë e ujësjellësit, për të ndërtuar marrëdhëniet e duhura me ta. Por ideja që "unë e shpoj vetë, ç'të duhet ty...!", a nuk shpon për të marrë pasurinë e përbashkët poshtë? Shpo njëherë në Europë, në Gjermani dhe shiko, të del uji përpara, apo të del polici.

Njerëzit nuk kanë faj, se kështu u mësuan dhe kështu shkoi kjo punë, por s'ka si shkon më, në qoftë se duam të kemi investime. Disa thonë, investoni njëherë, pastaj tjetra, po ku i gjen shteti paratë për të investuar? Shteti është kontributi i secilit si familja. Ka ndonjë familje ku iu thuhet prindërve, na e bëni njëherë shtëpinë, pastaj të shohim, do të punojmë, apo s'do të punojmë. S'ka, sepse familja funksionon me të ardhurat që ka. Edhe shteti është një familje e madhe, që të ardhurat vijnë nga secili. Sigurisht, kush fiton më shumë do të paguajë më shumë. Kush fiton më pak, do paguajë më pak. Kush nuk ka fare, që është me ndihmë ekonomike nuk paguan, por për këtë është shteti, që të të mbështesë. Prandaj 16 milionë dollarë çdo vit i harxhojmë për t'ua dhënë familjeve me ndihmë ekonomike për faturën e energjisë elektrike, që të mos iu rritej çmimi i energjisë nga heqja e fashës. Atyre iu takon dhe për këtë është familja. Familja e ndihmon një nga anëtarët e vet që nuk ka aftësinë të shkojë në punë. Por nuk mundet dot që të jetë, babë ti paguaj ujin, unë po nxjerr tubin jashtë dhe po luaj me ujin. Kjo nuk shkon. Kjo është ajo që duhet të kemi parasysh.

Investimet në ujësjellës, që ne e kemi rritur si fond, do t'i bëjmë për ato bashki dhe ndërmarrje që do të bëjnë këtë dhe jo merr lekë këtej dhe hidh ujë andej. Sepse po të shikoni llogaritë e shtetit, me paratë që janë harxhuar nga arka e shtetit, që janë paratë tuaja, paratë e shqiptarëve, për të investuar në ujësjellës, do ishin ndërtuar të gjithë ujësjellësit e Shqipërisë dy herë nga e para. Pse nuk i kemi? Edhe për shkak të korrupsionit, projekteve mizerabël, kontratave mizerabël, zbatimit mizerabël e të supervizionimit mizerabël, edhe për shkak se nuk ka duk investimi, nëse ti vjedh veten. Pra, investo sa të duash, por, nëse aty lidhjet e paligjshme vazhdojnë dhe uji nuk paguhet, si do të dalim në një kapitull tjetër?

Përveç buxhetit që është 42% më i lartë, ne kemi edhe Programin "1 Miliardë për Rindërtim". Dëgjova që ky miku im Luli thoshte, "është programi i krimit", d.m.th., krimi ka filluar të ndërtojë edhe rrugë në Shqipëri.

Programi "1 Miliardë për Rindërtim" është programi i zhvillimit, jo i krimit. Është programi i një zhvillmi që i ka munguar këtij vendi për vite të tëra dhe që ne do t'ia japim këtij vendi, do, s'do Luli. Kush nuk do, le të mos dojë, ne do t'i bëjmë të gjitha ato që kemi marrë përsipër, se shqiptarët na kanë dhënë besimin dhe detyrën që të bëjmë këto punë. Atyre iu ka dhënë detyrën të merren me ne. Ata të vazhdojnë të merren me ne, ne do të merremi me Shqipërinë dhe me punët e Shqipërisë. Pastaj në fund, njerëzit le të gjykojnë.

Programi "1 Miliardë për Rindërtim" faktikisht do krijojë numrin më të madh të vendeve të punës, që një program shtetëror ka krijuar në këto 27 vjet. Do stimulojë ekonominë familjare, sepse do stimulojë rritjen ekonomike dhe në fund të këtij 4-vjeçari do stimulojë zhvillimin, biznesin, turizmin, zhvillimin social, duke filluar nga Milot-Balldreni që ka mbetur aty si një zonë pa zot, në lidhjen e Thumanës me Vorën dhe Tiranën, Karrdhiqin me Delvinën që është përmendur historikisht, se edhe ata atje poshtë e kanë një "Rrugë Arbri", në kuptimin e përmendjes dhe të premtimeve, aksi i ri Kashar-Rrogozhinë dhe rindërtimi i plotë i të gjithë aksit nga Plepat deri në Vlorë. Janë ambicie që ne do t'i bëjmë realitet, duke qenë të bindur se këto, Shqipëria nuk mund t'i presë më.

Këto nuk mund të dalin dot më nga kazani. Këto vijnë nga puna dhe nga përpjekja me vullnet dhe me durim. Ne nuk kemi shkop magjik. Nuk mund t'i bëjmë të gjitha ato që nuk u bënë, por, nëse në 4 vitet e para kam thënë që do të bëjmë në 4 vitet e ardhshme më shumë se çfarë është bërë në 20 e ca vite të marra së bashku dhe këtë njerëzit e dëshmojnë në çdo qytet ku jetojnë, sot po përsëris atë që kam thënë para 25 qershorit, në këto 4 vjet do të bëjmë shumë më tepër seç bëmë në 4 vitet e para dhe do t'u japim shpresë, do t'u japim mundësi, do t'u japim rrugë zhvillimi individual, familjar, komunitar dhe kombëtar të gjithë njerëzve të këtij vendi.

E fillova me Skënderbeun, po e mbyll me Skënderbeun, me një shprehje të tij që thotë: "Çfarëdo që të ndodhë, unë do të jem mik i virtytit dhe jo i fatit". Çfarë rezervon fati është punë e fatit. Unë nuk besoj tek fati. Unë besoj se fati është karakter i njeriut. Vendosmëria për të arritur realizimin e një ëndrre që e shohim me sy hapur, është mënyra që çdo ëndërr ta bëjmë realitet. Ja ku e keni këtu. Ishte ëndërr. Sot fillon të kthehet në realitet. Brenda 3 viteve do të jetë realitet. Në fushatën e ardhshme do vijnë dhe do dëgjoni çudirat e radhës, por ama Rruga e Arbrit do të jetë aty. Po s'deshët të merrni pjesë në miting, merrni makinën e për 40 minuta jeni në Tiranë dhe lërini ata këtu, të flasin e të premtojnë gjëra që s'do t'i bëjnë dot kurrë.

investime

Projektet e rilindjes urbane Dibër

Qytetarët e Peshkopisë do të kenë më në fund Unazën e qytetit, mungesa e së cilës krijonte kaos në lëvizjen e mjeteve. Gjatë vizitës në Dibër, Kryeministri Rama i shoqëruar nga kryetari i Bashkisë së Dibrës, Muharrem Rama inspektuan kantierin e punimeve që pritet të përfundojnë në pranverën e ardhshme.

"Është një projekt që është filluar qysh nga '85-a dhe sa herë janë ndërruar kryetarët e bashkive e kanë premtuar, kanë filluar punimet dhe janë lënë në mes. Tani po bëhet realitet kjo unazë, me një financim të qeverisë shqiptare, rreth 2 milionë euro, me gjatësi 3.5 kilometra dhe një urë 20 metra, me sistemimin e kanalizimit të ujërave të zeza dhe ujërave të bardha, me trotuare, me ndriçim" – u shpreh rreth projektit kryebashkiaku Muharrem Rama.

Një "rrugë e vogël e Arbrit" e konsideroi Kryeministri, për nga shpeshtësia e premtimeve që janë dhënë në 30 vjet për ndërtimin e saj dhe deri më sot vetëm sa është rrënuar. Përfundimi i saj ka rëndësi jo vetëm për lehtësimin e lëvizjes në qytet, por i jep zgjidhje një shqetësimi të madh qytetarëve, për praninë të mjeteve të rënda në rrugët e qytetit. "Edhe kjo është rruga e vogël e Arbrit. Premto, premto dhe edhe kjo tani po bëhet. Natyrisht është një gjë shumë e rëndësishme për qytetin dhe do ta lehtësojnë shumë pjesën tjetër që nuk do ketë më gjithë kamionët deri te shtëpia."

* * *

Një tjetër kantier në Qarkun e Dibrës është ai i rrugës Arras-Kastriot. Rruga lidh banorët e 20 fshatrave dhe do të shkurtojë kohën e lëvizjes nga 2 orë aktualisht në 20 minuta. Impaktin e saj, në radhë të parë do ta ndjejnë fermerët që duke lehtësuar daljen e tyre në treg, ulin koston e prodhimit.

"Janë 20 fshatra që e kanë bërë rrugën për dy orë. Tani me kombinimin e urës që është bërë pak më parë, rrugën tani e bëjmë për 20 minuta. Rruga vazhdon pastaj për Lurë dhe lidh gjithë pjesën tjetër me Dibrën", - u shpreh Benet Beci, drejtor i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Punimet konsistojnë në zgjerimin e trasesë ekzistuese, ndërtimin e kanaleve anësore të rrugës, nënshtresat dhe shtresat asfaltike dhe do jetë e pajisur me sinjalistikë vertikale dhe horizontale. Rikonstruksioni i rrugës deri në Kastriot, aty ku do të rindërtohet muzeu i Skënderbeut, sëbashku me Rrugën e Arbrit do të rivlerësojnë potencialin turistik të kësaj treve, duke i kthyer edhe bukuritë natyrore të saj në funksion të zhvillimit ekonomik.

"Është shumë e rëndësishme që kjo po bëhet dhe po bëhet me cilësi. Unë dëgjova fjalë shumë të mira edhe nga njerëzit dhe nga 2 orë në 20 minuta për gjithë këto fshatra është një shpëtim i madh. Ne duhet të lidhim segmentin e rindërtuar me Çidhen dhe muzeun e "Skënderbeut", që kemi bërë gati projektin. Ky është dhe viti i Skënderbeut që fillon në 28 Nëntor deri në 28 Nëntorin e ardhshëm dhe në këtë mënyrë i japim edhe një destinacion turistik dhe paralelisht krijojmë kushte për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë rurale, krijojmë kushte për nxitjen e mëtejshme të prodhimit, sepse tani kostot ulen jashtëzakonisht shumë dhe mundësia e daljes në treg bëhet e thjeshtë. Rruga e Arbrit nga njëra anë, krijimi i një infrastrukture solide në Dibrën rurale, ku ka një problematikë kaq të trashëguar keqas na japin një bazë tjetër për të krijuar më shumë impakt," - theksoi Kryeministri Rama

***

Unaza e Klosit është një tjetër kantier në përfundim në Qarkun e Dibrës, e cila do të shmangë trafikun dhe kalimin e mjeteve të tonazhit të rëndë brenda në qytet. Kryeministri Rama, i shoqëruara nga kryetari i Bashkisë së Klosit, Basir Çupa, pa nga afër punimet. Në të dyja anët, Unaza do të ketë trotuare, një brez pemësh, do të jetë e pajisur me sinjalistikë vertikale dhe horizontale dhe ndriçim.

Ndërkohë veç Unazës, Kryeministri Rama siguroi se projekti i ardhshëm do të jetë hyrja e qyteti të Klosit, për ta kthyer në një hyrje të standardeve bashkëkohore që do të lidhë Unazën me Rrugën e Arbrit, çka do të shkurtojë mjaft kohë drejt Tiranës. "Do të bëjmë dhe urën, do bëjmë dhe rrugën në hyrje. Kryetari e ka projektin për t'u lidhur me unazën. Kur bashkëpunojnë socialistët me demokratët për punët reale bëhen gjëra të mëdha" – theksoi Kryeministri Rama.

* * *

Mungesa e një ure në njësinë administrative Komsi të Qarkut të Dibrës ishte kthyer në kalvarin e përditshme për fëmijët që duhet të shkonin në shkollë, pleqtë dhe të sëmurët që duhet të shkonin në qendrën shëndetësore për të marrë shërbim. Sot, falë Forcave të Armatosura të Shqipërisë, do të jetë më e lehtë që nxënësit të shkojnë në shkollë e banorët të aksesojnë qendrat shëndetësore. Kryeministri Rama, i shoqëruar nga ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaxhça dhe nga kryetari i njësisë administrative, Fatmir Kola, ishin në fshatin Komsi, ku sapo është vënë në përdorim ura.

"Ura që i dorëzojmë sot, 1200 banorëve të Muzhakës dhe fshatrave përreth është një urë që i vjen në ndihmë shumë komunitetit, i vjen në ndihmë mbi 300 nxënësve të kësaj zone dhe i vjen në ndihmë banorëve për të aksesuar shumë më kollaj arteriet kryesore, për të komunikuar më kollaj mes fshatrave, por edhe për të aksesuar qendrat shëndetësore. Kjo është një nga 9 urat që ne kemi bërë në Qarkun e Dibrës" – u shpreh ministrja Olta Xhaçka.

Ura ishte një domosdoshmëri, nënvizon kryetari i njësisë administrative, veçanërisht në dimër. Ura e ngritur ka nivel më të lartë dhe gjithashtu një kapacitet më të lartë mbajtës. "Kjo urë është shumë e domosdoshme për gjithë zonën këtu, sepse në këtë shkollë vijnë jo vetëm nxënësit e fshatit Muzhakë por vijnë dhe nga Gërrmani dhe nga fshatra të tjerë. Po kështu është dhe qendra shëndetësorë këtu," - u shpreh administrator i njësisë Fatmir Kola.

"Mua më vjen shumë mirë që i kemi çliruar nga gjithë ky ankth i madh gjithë ato familje e prindër që kanë sjellë fëmijët për në shkollë, duke bërë cirk këtu dhe më vjen shumë mirë po ashtu që jemi në një bashkëpunim shumë të mirë me bashkitë e zonës, me kryetarët e bashkive dhe është një shembull i shkëlqyer që kur në terrenin e vështirësive, të problemeve, të halleve, të shqetësimeve, të shpresave, të nevojave të njerëzve jemi bashkë, të majtë e të djathtë, bëjmë ura," – nënvizoi Kryeministri Rama. Duke shtuar se projekte të tjera janë në proces në gjithë zonat rurale në Qarkun Dibër, për të mbështetur njerëzit dhe prodhimin.

Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit ose ndiq linkun: https://tinyurl.com/lcc3e2f

Bëj një abonim online ose në print...

Kushton vetëm 600 lekë në vit...

email: rrugaearberit@gmail.com

NJOFTIM PËR BASHKËPUNËTORËT!

Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët dhe korrespondentët tanë se shkrimet duhet t'i sjellin në redaksi para datës 20 të muajit. Për çdo rast, komunikoni me redaksinë!

Rruga e Arbërit nr. 138 .139.

Viti 1870 mendohet të jetë zanafilla e përdorimit për efekt kurativ të llixhave të Peshkopisë

reportazh

Investimi i munguar për **Llixhat e Peshkopisë**

Nga **HALIL RAMA**

Qyteti i Peshkopisë, gjatë këtij tetori ishte ndoshta ndër më të populluarit e rajonit. Kjo dyndje drejt qytetit verilindor, të njohur edhe si qyteti i blirëve, vjen jo vetëm nga joshja e peisazhit mahnitës që natyra i ka dhuruar Dibrës, por parasëgjithash, nga ajo pasuri e rrallë që gjendet vetëm një km në veriperëndim të tij. Kështu, në luginën e Bellovës rrëzë malit të Korabit, 1 km nga qyteti i Peshkopisë, ndodhen burimet termale. Një mrekulli natyre për efektet kurative, përdorimi i të cilave fillon që para dy shekujve. Rreth 20 mijë frekuentues për çdo vit dëshmojnë për fuqinë shëruese të këtyre ujrave që janë nga më të rrallat në botë. Dr.Mentor Prifti, i vetmi i specializuar si mjek për këtë Qendër Balneare, që shërben këtu prej 19 vitesh, flet me kompetencë e profesionalizëm për efektin e këtyre ujrave në shërimin e sëmundjeve reumatizmale kronike, të reumatizmave degjenerative, artrozave e neuriteve periferik kronike. Por sipas tij këto ujra ndikojnë edhe në gjendjet pas frakturave traumatike, në plegjit hemiplegjit e tetraplegjit, hipertensionin arterial esencial pa insuficencë kardiake, si dhe në disa sëmundje të aparatit tretës, si gastritet, kolitet, infeksionet kronike urinare, urolitjazat, kolelitiazat. Dhe të mendosh që llixhat e Peshkopisë kanë veti kuruese edhe për disa sëmundje gjinekologjike, si hipoplazit uteri, infeksionet kronike të uterusit, sterilitetin primar e sekondar e disa sëmndje të lëkurës, si ekzema e mykozat e lekurës, padyshim që është mëse e justikfikueshme kjo dyndje e pacientëve nga të gjitha trevat shqiptare, që nga Gjirokastra, Vlora, Përmeti e Fieri, Kruja, Shkodra, Tropoja, Prizreni, Suhareka, Malisheva Tetova, Gostivari, Shkupi....Kësioj, në këtë qytezë në prehër të maleve, të njohur si qyteza e shërimit, gjeografia e pacientëve është nga hapësira mbarëshqiptare,

VETITË MJEKUESE TË UJIT TË LLIXHAVE

(Sipas Dr. Mentor Prifti - Mjek i Qendrës Balneare)

1.Me banjo në ujin termomineral për 10-15 minuta për këto sëmundje: Reumatizmat kronike, reumatizmat degjenerative,artralgjitë, radikualgjitë,neuritet kronike, spondiliti dhe spondilartrozat, neuralgjitë, tendinitet, bursitet, gjendjet pas aksidenteve traumatike të reponuara,disa sëmundje gjinekologjike si steriliteti primar dhe sekondar, hipoplazit e uterusit, adneksitet kronike, endometritet kronike, disa semundje të lekurës si ekzema kronike,psoriaza, sëmundjet mikotike të lëkurës, kolelitiazat,urolitjazat.

2.Me pirje të ujit termomineral: Gastritet hiperacide e hipoacide,ulçerat kronike të stomakut dhe duedenitet,konstipacionet kronike,kolitet kronike, cistopielitet e mikrourolitiazat.

3.Me gargara e shpëlarje me ujë termomineral: Laringitet kronike,tonsilitet e disa sëmundje gjinekologjike.

Ditë qëndrimi mesatar zgjat10—14 ditë në vit dhe përsëritet për 3-5 vjet rresht.

Për këto veti kurative natyrale për kushtet e hotelerive që afrohen, kjo llixhë frekuentohet jo vetëm nga klientë brenda vendit, por dhe jashtë kufinjve të Shqipërisë.

Përveç hidroterapisë (mjekimit me banjë 10-15 minuta qendrim në ujë termomineral në ditë) përdoren dhe metoda tjera bashkëkohore si:

-Fangoterapia (terapia me baltë);
-Elektroterapia (fototerapia, diatermia);
-Masazhi terapeutik;
-Gjimnastika riaftesuese e kurative;
-Irrigacionet (klizmat dhe mikroklizmat).

Nga të dhënat fiziko- kimike mineralizimi i këtyre ujrave është si më poshtë:

-katione amonium	0.15	mil. eQ
-natrium + kalium	17.82	mil. eQ
-kalcium	67.14	#
-hidrosulfid (H S)	0.62	#
- sulfate SO 4	55.51	#
-chloride Cl	23.5	#
- hidrokarbonat	20.62	#
- acid silicilik	0. 75 mili	mol
- pH	6.8	
- mbetja e thatë	4 . 2 Mg / l	

PAK HISTORI...

Viti 1870 mendohet të jetë zanafilla e përdorimit për efekt kurativ të llixhave të Peshkopisë. Ishin banorë nga komuniteti i krahinës ata që filluan t'i përdorin dhe t'i mirëmbajnë këto burime natyrore. Dibranë të shquar, me dijeni në mjekimet popullore i kanë rekomanduar për përdorim për disa semundje.

Kuota absolute e daljes së këtyre ujrave është 750 m/l mbi nivelin e detit. Debiti (prurja) e këtyre ujrave është 14 litra në sek.

Janë tre burime afër njëri – tjetrit me të njejtën përbërje dhe temperaturë që janë bashkuar dhe temperatura në ujëmledhës është 42 °C. Mineralizimi i tij është rreth 4.2 mg/litër. Uji është i ngopur me gazin sulfhidrik dhe ka ngyrë të kaltër me erën karakteristike të vezës së prishur.

Gjeologjikisht ujrat ndodhen në depozitimet gëlqerore- ranore- argjirore me moshë paleozoike. Mendohet që uji është i tipit të çarjeve karstike dhe lidhet me kontaktin tektonik midis gipseve dhe depozitimeve të sipërpërmendura.

Përdorimi i tyre për efekt kurativ mendohet të ketë filluar që në shekulin XVI-të dhe në fillim të këtij shekulli janë ndërtuar dy banjo kolektive me shkallë guri.

Rreth vitit 1928, në kohën e Mbretit Zog I, u ndërtua i pari hauz me mbulesë dhe fillon të përdoret me pagesë nga bashkia e qytetit. Burimi i ujit termal është ruajtur me fanatizëm nga shkatërrimi.

Në vitin 1952, rreth 150 metra larg burimeve të ujrave termale u ndërtuar një hotel njëkatësh me 40 shtretër dhe pranë tij 20 vaska për larje individiuale.

Në vitin 1953 fillon shfrytezimi shkencor dhe ndertohet i pari ambjent për larje me vaska dhe hoteli pranë tyre për të shtruar.

Në vitin 1974, në lagjen Dobrovë të qytetit u ndërtua një hotel me 120 shtretër dhe anekset e tij ndihmëse. Pas shtatë vitesh, më 1981, pranë vendburimit të këtyre ujrave u ndërtua Kompleksi Balnear me 44 vaska për larje individuale, një pishinë me përmasa 10 x 8 m, kabineti i baltës me 6 ambjente, përfshi dhe një vaskë riaftësimi, kabineti gjinekologjik, kabineti i fizioterapisë + fototerapisë, gjimnastikës terapeutike e masozhoterapisë me palestër.

Në vitin 2000 hoteli në Dobrovë privatizohet, por pranë kësaj qendre balneare rriten kapacitetet në 100 shtretër. Që prej themelimit ndërmarrja ka qënë në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë. Në vitin 1994 ajo kalon me veprimtari ekonomike në vete (vetëfinancim) por me kapital shtetëror dhe si e tillë vazhdon të funksionojë që prej 23 vitesh.

DREJTIM VIZIONAR, ME KOMPETENCË DHE PROFESIONALIZËM

"Nëse shkon në llixhat e Peshkopisë, mos rri pa u takuar me Takun". Kjo porosi e mikut dhe kolegut të mirënjohur Defrim Methasani, ndër më të spikaturit e gazetarisë sportive në vend, pati vlerë të veçantë, pasi gjatë qëndrimit një javor në këtë qendër balneare, takimi me drejtorin e saj, Spartak Koltraka qe me të vërtetë mbresëlënës. Jo vetëm në aspektin e mirëtrajtimit, pasi këtë "status" e gëzonin pothuajse 2500 frekuentuesit ditorë të saj, por për vizionin dhe aftësitë drejtuese e organizuese që ai shfaq për këdo e më këdo. Ky i ri shembullor, që përveçse ekonomikut në Universitetin e Tiranës është diplomuar shkëlqyer edhe në të ashuquajturin "Universitet të Dibrës", si simbol i urtësisë dhe mençurisë dibrane, gjithë potencialin e tij intelektual e njerëzor e ka vënë në funksion të ndërtimit të një qendre balneare të standardeve bashkëkohore. Nëse para pak vitesh u evidentua si drejtuesi vizionar i OSHEE, që eleminoi informalitetin në sektorin e energjisë ekektrike, duke futur në shinat e zbatimit të ligjit edhe "të fortët" e Dibrës, tashmë është fokusuar tek një tjetër projekt madhor, jetik për Dibrën dhe dibranët. Si një nga drejtuesit e fushatës elektorale të PS-së, i është "qepur" dhe s'i ndahet deputetit Beqja, deri sa të bëjë realitet Projektin "Rikonstruksioni i godinave të Qendrës Balneare (Lixha), shembja dhe ndërtimi i llixhave të vjetra, sistemimi i sheshit dhe rrethimit, asfaltimi i segmentit të rrugës pargjatë rrethimit të Llixhave". Dhe ka besim se këtë projekt të mirëargumentuar nga ai dhe stafi i tij, do ta mbështesë ish-ministri i Shëndetësisë, tashmë përfaqësues i Dibrës në legjislativin shqiptar. Ky projekt, zbatimi i të cilit merr parasysh të gjitha masat e nevojshme për rikonstruksionin e godinave ekzistuese që janë shumë të rrënuara nga ana e finiturës, duke u konsideruar pothuajse jashtë funksionit të tyre, u prezantua dhe gjeti mbështetje, edhe nga kryebashkiaku i Dibrës, Muharrem Rama, në takimin që kryeministri Rama pati para disa ditësh me kryetarët e të gjitha bashkive. Projekti që arrin deri një miliardë lekë (ku të ardhurat vjetore nga rreth 20 mijë frekuentuesit arrijnë deri 2 milardë), në të vërtetë është investimi i munguar prej dy dekadash. E kanë premtuar atë qveritarë të majtë e të djathtë, kryeministra e ministra, dhjetra deputetët dibranë dhe kryebashkiakët e Peshkopisë të çerekshekullit të fundit, por vetëm tani duket se po merr drejtimin e duhur. Kjo për faktin se llixhat, ndër resurset kryesore të Dibrës, konsiderohen si "minierë ari", nga ku ripërtërihen qindra mijëra jetë njerëzish. Projekti i Drejtorit Koltraka, që tashmë është në zyrat e Bashkisë Dibër, por dhe të Ministrisë së Shëndetësisë e të kryeministrisë, sidhe të disa donatorëve prestigjiozë, konsiston në faktin se në këto godina duhet të futet në funksion ishina me ujë termal, si dhe organizimi i ndarjeve të hapesirave të tyre për ambjentet e administratës, të hotelerisë dhe shërbimeve për trajtime mjekësore e zgjerim të hapesirave për larje në vaska.

FLUKSI I MADH I TURISTËVE KA SJELLË ZHVILLIMIN E HOTELERISË

Llixhat e Peshkopisë me ujin më cilësor në Ballkan, vizitohen nga 20 mijë pacientë çdo vit. Kjo ka çuar në një bum të ndërtimit të hotelerive. Dr.Mentor Prifti që e ka ndjekur nga afër këtë zhvillim progresiv gjatë këtyre dy dekadave të fundit, tregon fluksin e madh të turistëve që ka sjellë zhvillimin e hotelerisë. "Pacientët që frekuentojnë llixhat e Peshkopisë dhe shtrohen tani nuk janë me planifikim si dikur. Kjo për shkak të rritjes të kapaciteteve të hotelerive, por ne u rekomandojmë dhe është mirë që para nisjes të konsultohen me mjekët e vetë në zonat nga vijnë për sëmundjen që do kurohen",-shprehet dr.Mentori. Ai bën të ditur se kapacitetet e larjeve ditore shkojnë deri në 800 pacientë. Por puna është sezonale, kjo për shkak të klimës së zonës ku shtrihen llixhat. Kapacitetet e shtretërve përbëhen nga kapaciteti i hotelit të ndërmarrjes prej 100 shtretër dhe kapacitetet e hotelerive private deri në 800 shtretër. (Gjatë 10 viteve të fundit janë ndërtuar 15 hotele të reja). Ditëqëndrimi mesatar zgjat 10 -14 ditë në vit dhe përsëritet për 3-5 vjet rresht. Nëse kapaciteti vjetor i të shtruarve arrin 10-12 mijë persona në vit, për ambulatorët kjo shifër arrin në 60-70 mijë ditë larje.

Pjesa më e madhe e frekuentuesve janë pensionistë, por ka edhe të sëmurë kronikë të moshave e profesioneve të ndryshme. Ing. Vasil Dhanili nga Fieri, Gjelina e Frrok Gjikola nga Lezha, Lumie e Ramadan Hasanaj nga Prizreni, Kadire e Rafet Islami nga Tetova, që frekuentojnë këto llixha prej 10-20 vitesh, flasin me admirim e respekt të veçantë për Dr.Mentorin. Ndërkohë, duke folur për mrekullitë kurative të llixhave të Peshkopisë, mjeku me përvojë M.Prifti, i miqësuar me pacientë nga e gjithë Shqipëria, Kosova e Maqedonia sqaron se përveç hidroterapise (mjekimit me banjë 10-15 minuta qëndrim në ujë termomineral në ditë), këtu përdoren dhe metoda të tjera bashkëkohore si: Fangoterapia (terapia me baltë); Elektroterapia (fototerapia, diatermia); Masazhi terapeutik, gjimnastika riaftësuese e kurative si dhe irrigacionet (klizmat dhe mikroklizmat). Po kështu trajtimet kanë veti të veçanta rehabilituese, për të aksidentuarit me fraktura e trauma të ndryshme.

Për të gjitha këto shërbime, koridoret e Qendrës Balnare mbushen përgjatë 24 orëve nga mijëra pacientët, që kontrollohen nga personeli shëndetësor, për të shmangur rastet e asfiksisë. Është ndoshta e pabesueshme, por këtu gjen pacientë që mund të kenë ardhur për të 50-tin vit rresht.

reportazh

“FESTA E TE VJELAVE” - DITA E BEGATISË

Nga **ALBAN TUFA**

Mëngjesi i datës 7 tetor e gjeti Peshkopinë ndryshe nga ditët e tjera, sepse së pari këtë mëngjes po fillonte Panairi i të vjelave 2017, dhe së dyti, ky mëngjes po dëshmonte se dimri po avitet dhe që këtej e tutje nuk mund t’i zëmë dot besë. E megjithatë të dyja ndodhitë me thënë të drejtën nuk i ndihin aspak njëra tjetrës, për të mos thënë janë në kundërshtim.

Me një dëshirë që nuk shterret kurrë (as nga rruga), nisem për në Peshkopi. Edhe pse mu desh të vendos dy-tre alarme, ia arrita të nisem që nga Tirana në orën 5:00 të mëngjesit. Është një mëngjes i ftohtë dhe të natën ka rënë shi me rrëmbim. Nisem për Peshkopi, për në Panairin e të vjelave 2017. Për rrugën nuk do të themi asgjë, sepse të gjithë e dinë si është, të gjithë e kanë provuar, thjeshtë iu duhet ta kujtojnë.

Sapo i afrohemi Maqellarës, nis një dëborë, (ose ne i afrohemi një dëbore që mund të ketë nisur pak kohë më parë) e cila bie pa hiç përtesë, ndjekur nga shtëllunga të tjera të pandalshme. Të them të drejtën habitem, e fill mandej mahnitem. Më përshtypin një çast pamjet e fshirëses tek fshin mbi xham kristalet e dëborës, e mandej fshin sërish të tjera, të tjera e të tjera... Dikush nga fundi i furgonit , një djalë i ri thotë: “Ka kohën tashti” ndërsa një burrë i thyer në moshë ia pret: “Jo mor bir, s’i ka ardh koha akoma, por janë punë të Tjetërkujt këto, megjithatë, kët shiun e pret. Ka me hap kohën”.

Apet kjo pamja e Peshkopisë që kurrë nuk më ngop, që për nga ndjesitë nuk krahasohet me vend tjetër në botë.

As kjo kohë e ftohtë dhe e beftë nuk i mbyll dibranët brenda. Punimet në Bulevardin “Elez Isufi” duket që kanë sosur, edhe pse nuk është vështirë të gjesh të pakënaqur. Tek pika që lidhet me Bulevardin “Nazmi Rushiti, është ngritur një shkallare.

Këtë ditë ALCDF në bashkëpunim me Bashkinë Dibër dhe Drejtorinë e Bujqësisë në Dibër organizojnë, Festën e të Vjelave, “Panairi i produkteve tipike dibrane”, në kuadër të projektit Dibra: Turizëm dhe Traditë (D2T), financuar nga USAID dhe Ambasada Suedeze.

Prodhuesit e mollëve, frutave të tjera, grupet e prodhuesve të arrorëve, dhe prodhimeve të dyta të pyllit, grupet prodhuese të grave me jufkat, perimet, gatime tradicionale, dhe agro-përpunuesit e bulmetit, pijeve dhe lëngut të frutave.

Muzika përhapet panda dhe pushton hapësirën. Që në krye të tendave, sapo fillon bulevardi, janë vendosur dy dengje jonxhe dhe sipër tyre qëndron nga një kungull i cili është i fundit që mblidhet nga vjeshta. Anash dengjeve të jonxhës qëndrojnë në këmbë dy stavë kashte misri, të cilat, edhe këtë janë simbol i vjeshtës e sigurisht i fshatit. Imazhin e tyre vjeshtak e përmbush me besnik një shi i imët dhe i ftohtë akull.

Brenda stendave fillohet me rrush, molla, ftonj, arra, e të gjitha frutat që prodhon vjeshta në Dibër. Nuk mungojnë kurrsesi gatimet e grave dhe nënave dibrane, me fli, petulla, llagaje, jufka, sheqerpare dhe ëmbëlsira të ndryshme. Mandej vijnë bulmetet, produkte blete dhe çajra të ndryshme. Të gjitha këto i japin kuptimin e duhur këtij panairi edhe këtë vit.

Xhevit Feta nga Zagradi, ka ardhur bashkë me të shoqen në panair për të promovuar produktet e tij. Ndër shumë e shumë produkte të tjera, bie në sy, edhe pirg pastërmaje, që me një aromë unike të ngjall njëherësh kujtime dhe oreks për fasule. E shoqja tregon:

“Mishi rrin gjashte javë në kripë, por tri duhet lënë se s’bën, ne lëmë më shumë. Sa më shumë ta mbash në kripë më mirë është sepse më tjetër aromë dhe shije. Do shumë kujdes, dhe duhet fut në kripë të zezë”.

Edhe pse organizimi i panaireve dhe organizimeve të tilla po shtohet nga viti në vit, I vetmi problem për fermerët mbetet gjetja e tregut dhe kostot e larta për prodhim.
Një shitës mollësh thotë se ka pas mollë vende vende, por jo në shumicë . Ai shprehet: “Edhe tregu dobët është. Duhet një fabrikë lëngjesh për ta konkurruar atë ekzistuese. Kur nuk ka konkurrencë, tregu është sa do vetë. Pa konkurrencë, fermeri është i mbarum.”

Ndërsa Xheviti thotë: “Ne nuk kemi patur shumë, tre-katër pesë qingja kemi therë. Dolëm sot edhe me të tjera gjëra. Me çajra dhe patate. Patatet nuk ecin, qytetarët marrin shumë pak, sepse mendohen, ta bëjnë të gjithë kokrrën apo gjysmën sepse janë shumë të mëdha.

Çdo gjë është bio. Edhe domatet I kemi bërë në stane, atje ku mbajmë dhentë, janë bërë vetëm me plehun e dhenve.”

Në stendën e tij, nuk mungon asgjë që në Dibër sjell vjeshta, duke nisur me thana, kaça, e duke sosur me boronicë të egra.

Ndërkohë shiu, nuk ndalet, njerëzi blejnë me kile. Secili me qesen në një dorë dhe çadrën në dorën tjetër. Gumëzhijnë stendat nga njerëzit, siç gumëzhijnë në një koshere bletët e Arjan Zogut, i cili e ka marrë kosheren me vete në panair. Ai ka mbi 200 koshere bletë dhe me to jeton. “Mbleta ka kosto, dhe nuk është e lehtë të mbahen. Bleta së pari kërkon që të jesh I ndershëm.” thotë ai. Në stendën e tij, veç mjaltës ai ka edhe polen, qumësht blete, dyll dhe plot produkte të tjera që japin bletët.

Edhe pse organizimi i panaireve dhe organizimeve të tilla po shtohet nga viti në vit, I vetmi problem për fermerët mbetet gjetja e tregut dhe kostot e larta për prodhim.

Një shitës mollësh thotë se ka pas mollë vende vende, por jo në shumicë . Ai shprehet: “Edhe tregu dobët është. Duhet një fabrikë lëngjesh për ta konkurruar atë ekzistuese. Kur nuk ka konkurrencë, tregu është sa do vetë. Pa konkurrencë, fermeri është i mbarum.”

Fermer nga Muhurri ka a ardhur ne Festën e të Vjelave me fasule , me rrush ,me mollë, me speca. “Speca mbjellim më shumë. Çmimi nuk është shumë i favorshëm për ne, por edhe populli nuk ka terezi. Infrastruktura është, sipas mendimit tim, zero. Zero krejt është, duhen rrugë për toka”, thotë ai.

“Festa e të Vjelave” është dita e begatisë të vjeshtës e cila festohet nga dibranët. Projekti Dibra: Turizëm dhe Traditë (D2T) që financohet nga USAID/Albania dhe Ambasada Suedeze, dhe zbatuar nga ALCDF, organizuan këtë event në formën e një festivali, ku mbi 10.000 vizitorë nga qyteti Peshkopisë, pushues në Llixha, vizitorë nga Tirana dhe Dibra e Madhe, vizituan dhe provuan prodhimet natyrale të më shumë se 200 fermerëve, agropërpunues, grupe prodhuesish të grave, artizane që reklamuan produktet në stendat e panairit. Vizitoret ndoqën edhe koncertet dhe aktivitetet e tjera të grupit artistik, cirkut, arteve marciale dhe mundjes, në një skenë të dekoruar me mjete dhe sende natyrore dhe bujqësore. Bashkëpunimi i mire mes ALCDF, Bashkia Dibër, CNVP Foundation, World Vision, Agritra Vizion, Drejtoria e Bujqësisë dhe shumë vullnetarë të tjerë bënë që eventi të kishte mbarevatje të mirë, megjithëse kushtet e motit ishin të vështira.” (ALCDF)

“Festa e të Vjelave” është dita e begatisë të vjeshtës e cila festohet nga dibranët. Projekti Dibra: Turizëm dhe Traditë (D2T) që financohet nga USAID/Albania dhe Ambasada Suedeze, dhe zbatuar nga ALCDF, organizuan këtë event në formën e një festivali, ku mbi 10.000 vizitorë nga qyteti Peshkopisë, pushues në Llixha, vizitorë nga Tirana dhe Dibra e Madhe, vizituan dhe provuan prodhimet natyrale të më shumë se 200 fermerëve, agropërpunues, grupe prodhuesish të grave, artizane që reklamuan produktet në stendat e panairit. Bashkëpunimi i mire mes ALCDF, Bashkia Dibër, CNVP Foundation, World Vision, Agritra Vizion, Drejtoria e Bujqësisë dhe shumë vullnetarë të tjerë bënë që eventi të kishte mbarevatje të mirë, megjithëse kushtet e motit ishin të vështira.”

Rruga e Arbërit nr. 138 .139.

NJË SHTESË KRYEMINISTRIT NË KËRKESAT PËR "DIBRANËT"

Bëhet fjalë për një zonë, që "arkitektja natyrë" e ka ndërtuar si ma të bukurin vend. Dora dhe shpirti njerëzor e kanë pasuruar me vlera, ku spikat bujaria, krenaria dhe besa për të qenë kurdoherë bashkë, me fjalën, mendimin, guximin, për të triumfuar e qëndruar besnik ndaj gjithçkaje që trashëguam ndër breza. Njohja dhe pasurimi i këtyre vlerave mbetet detyrë për çdo njeri që lind dhe ka thithur ajrin e këtyre bjeshkëve, që ka pirë ujin e kristaltë të burimeve, që ka dëgjuar e mbartur fjalën, amanetin e të parëve, të cilët jetuan, e deshën dhe lanë gjurmë në këto anë.

Rruga Burrel-Stelush-Peshkopi, një projekt që do rigjallërojë turizmin

Nga **QEMAL CENAJ***

Kohë më parë jemi njohur me 45 kërkesat për Dibrën, "zbuluar" nga kryeministri Rama, të bëra publike po prej tij. Mbetemi vetëm në leximin e tyre dhe asgjë s'mund të heqim, veçse të mendojmë se cila nga ato duhej të vendosej më parë, e cila më pas. Sidoqoftë, kryeministri i ka në dosjen e tij dhe shpresojmëtë jenë të parat konsiderata të punës së tij. Ajo që na vë në dilemë është tjetër gjë: A janë këto kërkesa vetëm për dibranët (bulqizakët), apo edhe për matjanët (klosjanët)?! Ndoshta kjo do të përbënte një temë më vehte, por i përmbahemi asaj që cituam në titullin e shkrimit: "Një kërkesë shtesë për dibranët". E kemi fjalën për zonën e Katër-Grykëve deri në Muhurr, Mbas-Dejen deri në Lurë, pllajat me fshatrat e banuara rreth maleve të Dejës, Runjës dhe Balgjajt, ku përshkon rruga Burrel-Stelush-Peshkopi dhe disa nga resurset që përfshihen në këtë zonë.

Në prag të zgjedhjeve të vitit 2013, ish-kryeministri Berisha, në prani të shumë matjanëve, preu shiritin e inagurimit të rrugës Ura e Matit-Lis. U pështpërit në atë kohë, se vetë Sali Berisha, edhe pse mburrte arritjet e qeverisjes së tij, për rëndësinë e kësaj rruge, nuk ishte shumë i lumtur, për faktin se rruga ishte premtuar të përshkonte Vigun, Kalanë e Stelushit në hyrje të Qafë-Murrës, në qendrën e ish-komunës Selishtë dhe të lidhej tek Ura e Drinit, në Muhërr me Peshkopinë. Gjithë kjo, sipas projektit, ishte me një gjatësi prej 52 km, projektuar nga specialistë të fushës dhe e propoganduar me entusiazëm nga përfaqësues të komunitetetit, deputetë dhe ish-kryetarë komunash. Pra, u inagurua një segment prej 10 km, ndërkohë që aritmetika na nxjerr diferencën prej 42 kilometrave, në të cilat jo vetëm nuk u bënë punime dhe asfaltimi i premtuar, por në gjithë këto vite, rruga nuk ka patur asnjë lloj mirëmbajtje nga Enti Kombëtar i Rrugëve. Si për inatë vitet e fundit, kjo rrugë, nga nacionale që ishte, ka kaluar rrugë rurale, në varësi të pushtetit vendor, ku përveç borderopagesave për ca "tanët", pushteti as që kujtohet, nëse ka apo jo rrugë.

Dëshmitë dhe realitetin nuk mund t'ia fshehim publikut, pasi ai e ka jetuar, por as brezave të cilëve u nevoitet, madje e kanë dhe ëndërr. Rruga Burrel-Stelush-Peshkopi është projekt dhe realizim i kohës së Zogut, vazhdim i rrugës Krujë - Qafë-Shtamë - Burrel, realizuar thuajse e tëra me forcën e krahut. Kjo rrugë plotëson gjatësinë prej 2437 km, të bërë në atë kohë në shkallë vendi. Këtu nuk ka as pak nostalgjizëm, por jemi para një realiteti, që kurrë nuk është njohur dhe pranuar, sa e rëndësishme ishte dhe është kjo rrugë?

Dibranët dhe matjanët i njohin mirë faktet dhe kohët, me rrugë, pa rrugë. Bëhet fjalë për rrugë para e pas çlirimit të vendit, ku lëvizja e njerëzve shpeshtohej dhe plotësimi i nevojave të tyre bëhej më i mundshëm. Rruga e parë automibilistike me Dibrën, nuk ishte e paqëllimëshme për ta kaluar nëpërmjet Stelushit. Zona u gjallërua. U shtuan më shumë lidhjet e bashkëpunimit midis fshatrave e zonave për punë dhe interesa të përbashkëta, si dhe ato miqësore. Në monizëm gjithë kjo zonë, meqenëse u përshkua nga segmente rrugore, u përfshi në projektet për menaxhimin e industrisë së pyjeve-kullotave, gjeologji-minierave, tregetisë etj. Nisur nga Vigu e Mbas-Deja, Lura, Balgjaj e Prati i Selishtës, punonin mbi 3000 punonjës në sistemin e industrisë, pa llogaritur bujqësinë e blegtorinë. Sot gjithkush mund të shtrojë pyetjen: "Ç'bënin kaq shumë njerëz në "këto male"? Pyjet e virgjëra të gjithllojshme shfrytëzoheshin dhe mirëmbaheshin sipas traditës e ligjit. Me shtimin e kuadrove pyjorë ndër vite, kur lënda e drurit u bë burim të ardhurash, kjo zonë pati interesimin e qeverisë, u shtuan rrugët dytësore dhe u rrit kujdesi për mirëmbjtje të vazhdueshme. Pas kërkimeve gjeologjike nisën shfrytëzimin minierat e kromeve në Balgjaj, Kacní, Mbas-Dejë dhe miniera e Gurit të Kuq në Muhërr. Nga shfrytëzimi i gurit gëlqeror të zonës u përfitua lëndë e parë dhe sasi e konsiderueshme gëlqereje që u fut në ndërtim për qytetet Peshkopi e Burrel dhe ndërtimet për entet e familjarët që numerikisht u rritën në 4-5 dekada. Studimet gjeologjike vendosën një sëri piketash për minerale të rralla. Objektet e ngritura në formë pallatesh në Vig, Vanas, Balgjaj, Kacnì, Mbas-Dejë i dhanë zonës më shumë jetë dhe mundësi turistike për t'u shfrytëzuar, pavarësisht se turizmi i mirfilltë nuk aplikohej. Në shpatin e liqenjve të Lurës u ndërtua kampi i pushimit. Në këto pllaja e gryka ishin me dhjetra baxho për përpunimin e bulmetit dhe mali kishte gjallërinë e tufave. Këto nuk i cilësojmë si nostalgji e kaluar, por si një nxitje e detyrim që të imponohej prej njerëzve, të cilët edhe në kushtet e një vështirësie të sistemit, i jepnin jetë zonës me forcë e kurajo, por edhe me shpresë. Kepi i Bizës dhe pyjet e Xhelasit kanë qenë të përmendura për dhitë e egra, kaprollët, gjelin e egër e një shumëllojshmëri faune, që e gjeje rrallë në vendin tonë. Shpërdorimi i pyjeve dhe zjarret që vijnë prej "ligësisë", afër e larg, thuajse e kanë degraduar ekosistemin e këtyre anëve, aq sa shtetarët nuk e kanë për gjë të shkarravisin deri dhe projektet e rrugës duke i lënë në sirtare pluhurash, të prishin muret mbajtës ekzistues, pavarësisht se të shumtat kanë qenë të bëra me gurë mermeri të gdhendur nga duart e arta të puntorëve, specialistëve, mjeshtërit e zonës.

Pas viteve '90, siç shpresohej në nisiativën e lirë, këto zona nisën të gjallërohen. Banorët iu futën punës, me plot besim nisën të shtojnë tufat me blegtori duke i kushtuar rëndësi malit e kullotave si pasuri e trashguar me vlerë të madhe. Të huajt u bënë vizitorë të përvitshëm. Megjithëse pushteti e la në dorë të lirë, nga ku pati vetëm shkatërrime, të huajt nuk i ndahen kësaj zone për çdo vit, që do të thotë se këtu ka se çfarë tërheq, ndaj duhet rikthyer edhe vemendja e qeverisë. Deri më tani palët qeverisëse kujtohen vetëm në kohë fushatash! Ku janë sipërmarrësit e politikës që rrahin gjoksin? Ku janë vendasit e "zgjedhur", forca e përfaqësimit, që e njohin zonën, njohin klimën, favoret e mëdha që ka falë perëndia për njerëzit e kësaj ane? Të gjitha këto harrohen, kur nuk njeh përgjegjësinë e votës për sipërmarrjen që bën dhe nuk njeh përgjegjësinë ligjore para institucioneve të shtetit, duke u kthyer në tradhëtor, jo vetëm të votuesit, por të kolegëve e subjektit politik që i përket.

Ardhja e demokracicë në Shqipëri ishte shpresë e madhe. Mundi dhe ekonomia, për të cilat populli thoshte "po ikën si uji nën urë", mendohej se do të shkonte te mundçarët, punëtorët hallexhinj dhe djersëhumburit, te fëmijtë e tyre, të cilët pse rriteshin në këto vende me pasuri të rralla, mirëqenia u kalonte tangent, për s'dihet se ku!

Ç'PO THEMI?!

Kush nuk ka dëgjuar për Malin e Dejës, Balgjajn, Runjën dhe pllajat që shtrihen midis këtyre maleve, të banuara që në hershmëri apo dhe të pasura e piktoreske? Shumë kush që nuk e ka njohjen e duhur për këto zona, do të shpreh edhe habi: si ato u lidhën që në fillim me rrugë makine! Habia më vjen edhe tani, pikërisht tani që po shkruaj, disi s'po më bëjnë duart, pasi shumë gjëra nuk dua t'i besoj. Vendlindja ime është Vigu, ngjit me Kalanë e Stelushit, që fëmijë, ende pa shkruar, brezat më parë na folën për Kalanë, historinë e Skënderbeut, të nënës e babës së tij, të nip Hamzait, si e tradhëtoi duke treguar vendin se nga mund të merresh kalaja prej pushtuesëve, si kërcei me kalin për të kaluar Përroin e Shalcës, në anën tjetër të malit, ç'ishin arat e bashtenat e Kastriotëve, si ishin të emërtuara, pse quhej Guri i Vashës, si i zbrapsi këtu forcat turke të kryesuara nga Dervish Pasha, lidhjet e familjes së Kastriotëve me fshatrat e zonës etj. Zbulimet arkeologjike të vitit 1967 në Varosh, kur unë isha nxënës në tetëvjeçre, do të më pasuronin gjithçka thuhej për të parët tanë autoktonë në këto zona.

Stelushi (Istellus), është Kalaja më e madhe në Qarkun e Dibrës, vendbanim i Kastriotëve, e njohur nga studiuesit shqiptarë dhe të huaj, që kanë shkruar e mbrojtur desertacione për punët studimore-shkencore. Me Stelushin lidhen pronat, ngritja dhe lulëzimi i familjes së Kastriotëve, puna e marrëdhëniet me fise e shtete të tjera, luftrat dhe trimëritë për mbrojtjen e flamurit e dinjitetit të kombit shqiptar. Të gjitha rrugët e njohura të karvaneve të herëshme kalonin në këtë qytezë. Këtu ishte pazari, selia e familjes, spahijtë dhe adaletet (dokumentet e shtetit, nga ai i Arbërit). Këtu janë gjetur gjurmë të shtetit mesjetar ilir, relike e bazorelieve që flasin sikur "me gojë", për jetën dhe funksionimin e të parëve tanë, nën organizimin e një shteti të mirëfilltë, me lidhje të gjata në perëndim e lindje. Nëpërmjet dhjetra kishave që e rrethonin Stelushin, gjejmë gjurmët dhe format e besimit mbi fenë, si ka vepruar ajo në kushtet e luftrave dhe mungesës së predikuesëve, por edhe shpërndarjes së popullsisë. Këtu është Shën-Trinia, së cilës i përket shkrimi i parë shqip, Formula e Pagëzimit më 1462, shkruar nga peshkopi i Durrësit Pal Engjëlli. Mu në majë të Malit të Shën-Mërisë, ku sot janë antenat e operatorëve televizivë, ka qenë e vendosur Këmbana e Kishës, lidhëse e orientuese për kishat Mat e Dibër dhe më gjërë. Në atë vend u mblodh kuvendi i vitit 1596, për organizimin e luftës kundër pushtuesëve turq, me mbi 1500 delegatë dhe që përgatiti 6 vite më vonë Kuvendin e Dukagjinit, 1601-1602, me pjesëmarrje e përfaqësim nga gjithë trojet shqiptare. Këtu e përgjatë Shkallës së Deshëve, mbeti vijë ndarëse ku pushtuesit serbë, më 1913, nuk u lejuan të depërtonin më në thellësi të Matit. Pikërisht këtu është aksioni i parë i çetës partizane të Matit, shtator 1942, në pritë kundër fashizmit. Stelushi, Kalaja e Çidhnës dhe objekte për rreth janë shpallur "Monument Kulture". Këtu është vendi që zoti e ka bekuar me bukuri e pasuri, por që njerëzit me pak njohje e vizion, i kanë kthyer shpinën, duke e lënë në harresë e prapakrahëve, në "dorën" e disa ekspeditave të pamëshirëshme.

Ç'U BËNË PROJEKTET?

Na qëlloi të rrugëtojmë drejt Burrelit me Bujar Karoshin, djalin e Dibrës, që banon në Tiranë. Ka ngritur e drejton një studio grafike dhe, së bashku me intelektualë të Dibrës, përgatit e nxjerr gazetën mujore "Rruga e Arbërit". Tymi i zjarreve anë e kënd shpateve, që larojnë me vatra të mëdha, të zeza, kish pushtuar edhe luginën e Matit, që në Grykë të Shkopetit. "Na lodh biseda, na këput po aq sa vapa me tymnajën, që nuk i ndahet këtij vendi për asnjë çast"! Gjithë këto vite të "demokracisë", kjo zonë është folur e përfolur. Me vlerat e saj është luajtur dhe spekulluar prej njerëzve të veshur me pushtet. Ajo që të ngjall keqardhje, mëri e inatë, është pasimi i qeverisjes dorë më dorë te të padituri. Shumë nga vlerat janë tjetërsuar dhe po humbin. Bujari është nga Fushë-Aliaj, mu në buzë të Drinit, 12 km nga qyteti i Peshkopisë. Ndërkohë, ai thotë se nuk ka rrugëtuar asnjëherë në jetën e tij, nga Muhurri për në Burrel, në xhaden e vjetër. E çuditëshme, kur kjo rrugë është sa gjysma e rrugës Peshkopi-Bulqizë-Burrel, ndërkohë nëpërmjet rrugës nga Selishta e Muhurri, hapur para 80 vitesh, shkelën së pari herë gomat e makinës në Dibër.

-Sa janë si unë, -thotë Bujari, i pizhmanuar dhe si humbës i gjithë këtyre viteve.

Vërtetë dibranët kanë lëvizur shumë edhe me familje në këto vite, por dibrani është punëtor, është i lidhur me pronën. Të shumtët nuk i kanë lënë tokat djerrë, por as pemët, aq më tepër pemët që i kemi në traditë.

-Të jetë funksionale kjo rrugë, do ishte vërtetë një mundësi dhe fitore, -shton ai në bisedë.

Nuk vonon të theksojë se popullsia e Dibrës ka qenë dhe është mbi 60% përgjatë Drinit, në perendim të qytetit të Peshkopisë, që do të thotë se asfaltimi e mirëmbajtja e kësaj rruge ka qenë lehtësuese dhe mjaft favorite për zhvillimin e Dibrës.

-Po lobojmë shumë për Rrugën e Arbërit dhe s'kemi arritur, veçse zhgënjimin deri më tani, -dëshiron të prononcohet Bujari, si një nga kuadrot dibranë, që është lodhur duke ngritur zërin e shkruar për 'të. Kjo nuk don të thotë se rruga nga Qafë-Murra, për të cilën bisedojmë, të lihet në shkatërrim. Kjo për qeverisjet e këtyre viteve ka qenë dhunti. Ka një shtrat me taban të sigurtë, nuk do shpenzime, përveç shtresës së asfaltit, shkurton ndjeshëm kohën në lëvizjen e njerëzve të zonës dhe nxit në drejtim të resurseve.

Siç mëson nëpërmjet shkrimeve e librave, tek bisedon me intelektual vendas, kur kalon në këto anë, kjo rrugë nuk u bë shtegtisht, por e mirëstudiuar në vlera e resurse. Pllajat e Pratit, të Runjës e të Vanësit, të Bizës që lidhen me liqenjtë e Lurës, Xirja e Linosi, Kroi i Bardhë e Kroi i Araut, shpatet me aromën e dredhëzave e mjetrave, boronicat, gjithllojshmëria e drurëve, e bëjnë këtë vend përrallor. Fatkeqësisht dora mjerane, prej vitesh ka goditur me ashpërsi, por pritet një dorë e butë njerëzore, që njeh dorën e zotit, t'ia përsëri, gjithçka ka humbur ky vend, si pasuri të brezave që vijnë, vlerë e krenari për Shqipërinë. Këtë e bën dashuria dhe ndërgjegjia e njeriut me kokën mbi supe, por kur të mos ketë mbi shpinë militantët pa mend në kokë që, sa t'u lëshojë zërin partia e vet, të lëshohen me të katra.

Në këtë barbarizëm kanë dorë, të përzgjdhurit militantë partish, ndonjë edhe sot nëpër njësitë administrative, skelete të komunave të

(Vijon në faqen 9)

opinion

Vetëm konstato e premto, apo ndrysho edhe realizo?

Nga **MEVLUD BUCI**

Të konstatosh apo të premtosh njëra anë më e thjeshta, më e lehta, të ndryshosh edhe të realizosh është e vërteta, dritësimi, vlera më e mirë intelektuale. Është sa e çuditshme, aq edhe e dhimbshme, sa e kuptueshme, aq edhe e vështirë, sa hyjnore në dukje, aq edhe çnjerëzore në praktikë fakti se si ky popull të gjithë ne u besojmë llafollogëve, të pabesëve, servilëve, gënjeshtarëve, hipokritëve, formalistëve, ngjyracakëve e mbi të gjitha karrieristëve. Përse?!

U mbushën plot 105 vite (fakt ky) që populli i Katër-Grykëve të Dibrës ish me rreth 7 mijë banorë, tani rreth 3 mijë banorë, është prerë në besë nga të gjitha qeveritë. Përse? Gjatë 105 viteve ky popull në vlera të çmuara në histori, me dhjetëra dëshmorë e prijsa popullorë, bazë për Mat e Dibër e më gjerë, i urtë e dashamir, një nga nëntë malet e Dibrës e bajrak me Mat, ka mbetur në harresë. 105 vite vetëm një sekretar komiteti ekzekutiv në Dibër, Haxhi Rama, vetëm një zv.kryetar komiteti ekzekutiv Sefer Ramadan Manreka, vetëm një punonjës i thjeshtë në Ministri të Bujqësisë Ibrahim Manreka. Stop. Asnjë deputet, asnjë drejtor, ndonëse ka në dhjetëra e qindra kuadro të lartë, të aftë, krijues e me plot vlera. Nuk është fjala të kritikojmë qeveritë, sepse ata edhe ish të votëbesuarit kritikojnë dhe e demaskojnë vetveten, i kanë ecur në hile, në heshtje e me bërryla si i thonë fjalës Katër-Grykëve të fisnikërisë, Katër-Grykëve të Dibrës. Nëse vështrojmë në histori ndihmesa e Katër-Grykëve, në periudhën e Skënderbeut, gjatë dhe pas, Katër Grykët kanë qenë vend betejash, strehëz për prijësat popullorë të Dibrës e të Matit, lidhje të ngushta me Abdyl Bej Frashërin, Iljaz Pashë Dibrën, Ismail Bej Vlorën, Ahmet Begun, udhëheqësat e qëndresës kundër fashizmit qëndrestarë në të gjitha betejat kundër turqve, serbëve, malazezëve, italianëve. Trimëria e Molla Limanit, prijësit popullor në Nish (Molla Liman Ndregjonit), Molla Bajramit (Haxhi Bucit) që u vra me babë e djalë kundër serbëve, qëndresa e Kurt Strakës, Shaban Margjokës (si Mic Sokoli), Ismail Nikës etj.

Po kështu Katër-Grykët edhe në LANÇ qëndruan, siç i ka hije. Më e çmuara është ajo që Katër-Grykët (Murra) dhe Lukani pritën e mbajtën Hebrejt, Llan Destan Ndregjoni, e Ymer Ndregjoni. Në Katër-Grykë u strehuan prijësit e lirisë. Janë disa baza lufte (disa të pa vëna nga lufta e klasave në monizëm).

Fakt i vërtetë: Edhe në monizëm edhe në të ashtuquajturën demokraci, Katër-Grykët kanë mbetur të harruara. Janë pa rrugë (qysh rruga "Fashizmi" 1938, 1939, janë pa pyje (me pyje të shkatërruara, janë të harruar, të tradhtuar. Dihet se qysh në 1945 janë ndërruar disa kryetarë komune, por secili ka nënshkruar vetëm pabesinë për popullin martir të kësaj zone martire. Përse? Secili është treguar servil i partisë shtet e në demokraci, servil i partive e i qeverive ka udhëhequr, ka bërë sikur punon dhe ka vënë bishtin në shpinë duke ikur për Tiranë, Durrës a gjetkë. Pra, si mund të nderohet një dezertor, një votëshpërdorues, një servil partish, kur popullin e vet e lë në rrugë gropa-gropa të paparë në histori më keq se në Somali, Afganistan a Siri? Të votëbesuarit, të vetëtradhtuarit vetëm kanë konstatuar, vetëm kanë premtuar! Një popull e një trevë nga në të mëdhatë e Dibrës e të Matit (Katër-Grykët) është harruar gënjyer e pushkatuar nga të gjitha qeveritë. Rruga e Arbërit vërtet është kryevepër, por s'ka të bëjë me Katër-Grykët, Qafëmurrën, Lunarën, Selishten, Muhurrin. Nëse hapet rruga Vinjoll-Muhurr mbi 80% e makinave Tiranë-Dibër do të lëviznin nga kjo rrugë, e cila shkurton mbi 36 km në kalimin Mat-Lis, Vinjoll-Qafëmurrë-Selishtë-Muhurr.

Në sa e sa takime, para shumë e shumë deputetëve populli i Katër-Grykëve ka ngritur si problem parësor rrugën automobilistike, Vinjoll-Muhurr. Zotimet, premtimet e bëra janë dëshmi sesi i zgjedhuri, i votëbesuari e baltos veten, sesi le një popull, një trevë nga më të mëdhatë në Republikë si Katër Grykët, pa rrugë. Pra, me sa sy e faqe dërdëllis në parlament a qeveri për turizëm? Për pyjet, kur pyjet e Katër-Grykëve janë prerë janë në kuotën zero, kur në minierë të Kacnisë vidhet kromi më i mirë në Ballkan e populli s'ka as rrugë, as objekte social-kulturore, as shkolla me palestra, as internet, a laboratorë? Këtu, s'është fjala të demaskojmë dikë, apo të kërkojmë qiqra në hell. Jo, kurrë jo! Këtij populli ish kryetarët e votëbesuar, ish deputetët i kanë ecur në hile, kanë konstatuar, janë zotuar dhe nuk kanë bërë asgjë. Të çudit fakti se si deputetët kanë mbyllur celularët, nuk vijnë në zonë të ulen, të veprojnë, të ndryshojnë. Pra, çfarë i duhen deputetët a ministrat një populli kur ai mbetet i harruar, i tradhtuar?! Zona më me vlera të rralla turistike si Prati, 11 liqejtë e Kacnicë, Vanasi, Rynja, Bena, Kanonet e Selishtës të lumit Murrë, Sheshi i Kacnisë e plot të tjera.

Faktet dëshmojnë se të gjithë ish drejtuesit në Katër-Grykë janë vënë në krye dhe secili ka vënë bishtin në shpinë si i thonë duke ikur në Tiranë, Durrës a gjetkë. Po zotimet? Po rruga si mos më keq? Po pyjet e rrënuara? Po miniera e Kacnisë? Po turizmi në ndihmë të zonës e të popullit?! Pra, e vërteta flet kjo nuk kërkon dëshmitarë. Populli i Katër Grykëve është vrarë e rivrarë nga të gjitha qeveritë. Një popull fisnik, trim e bujar, i harruar, pa rrugë, pa pyje, pa minierë, ndonëse i ka të gjitha meritat e pasuritë që ia rrëmbejnë qeveritë e hajdutërisë. Koha dhe e vërteta, tashmë e pranon se ky popull në zgjedhjet e ardhme nuk do të votojë, s'ka përse voton, s'ka nevojë për deputet-lanet, për qeveritarë gënjeshtarë e të pa vlerë. Është dëshmi e aktualitetit se të gjithë të votëbesuarit deri më sot vetëm konstatojnë, zotohen, por askush s'ka realizuar apo ndryshuar asgjë. Katër-Grykët, një popull, një zonë e harruar, e tradhtuar nga të gjitha qeveritë. Koha thërret në skenë guximtarët, të urtët, të mirët, ata që u thonë ndal karrieristëve të pabesisë. Është moto e jetës, e ditës: Vetëm premto e konstato, apo ndrysho edhe realizo?! Lum kush bën ndryshimin, lum kush thotë aq sa bën e bën, atë që thotë! Këtu është çelësi i vlerës, çelësi i dritës së votëbesimit.

Rruga Burrel-Stelush-Peshkopi, një projekt që do rigjallërojë turizmin

(Vijon nga faqja 8)

mëparëshme, thuaj në daç të ish-kooperativave bujqësore. Është kjo arsyeja, pse populli i zonës me raste, duke mos ditur tjetër, bën lojë me alegorinë e tij.

-Mos ma pe kaun (mëzatin) sot?

-Jo për besë! A i ke dhanë zabelit?

-S'dijë kah ka morë.

-A e ka kmonën?

-Padé, ku e ka ngatërru... a, ndoshta i ka hi' noj shtupë xhethi….

S'ka nga ata burra tani, që ta kapi fjalën pa e nxjerrë në buzë, -të thonë burrat e "vendit"!

Gjithë këto vite kontaktet e njerëzve që kanë tentuar të bëjnë një sipërmarrje, qoftë edhe në fushën kulturore apo historike, kanë gjetur pengesën në naivitetin e drejtuesëve komunalë dhe përfaqësuesëve të vet, të cilët kur është puna për të kërkuar votë, "të lahen e të lyhen", ndryshe marrin autoritet bajraktari, duke u kthyer në "fallso" e të papërgjegjshëm, ku shumica e kanë patur mendjen ose kanë dashur të mësojnë si vidhen e përvetësohen 2 lekë të "fakirit" popull, siç e kanë kthyer e paragjykuar menjëherë pas zhvatjes së votës!

Këto janë dialogjet e bisedave me banorët e zonës për drejtimin dhe organizimin gjithë këto vite, por ... "me kë e ke"(?), pyesin përsëri veten banorët, të lodhur e krejt siklet nga një qeverisje bajate, shpërfillëse, që s'e mori asnjëherë përgjegjësinë e duhur për menaxhimin e pasurive dhe drejtimin e vendit. Projektet në fjalë janë bërë e ribërë. Janë bluajtur në "garroçe" deputetësh, por veçse në kohë premtimesh, deri sa është arritur marrja e mandatit. Thuhet, se 3-4 muaj më parë dy bashkitë, Dibër e Mat, kanë dorëzuar projekte të reja për rrugën në fjalë.

-Janë dorëzuar! -të thonë si me gjysëm zëri, por... mèken për ta thënë me plot gojën: Të gjithë të kontribojmë për rrugën, për zonën që ta ripërtërijmë me gjithçka të bukur e të mundëshme. Duhet ndalur dora e lirë e njerëzve të pandërgjegjshëm, të afërt me qeverisësit mediokër që nuk njohin ligj e shpirt, godasin sa munden pasurinë e mbi 50 mijë hektarëve të ekosistemit që mbulon zonën, me pasuri mbi e nën tokë, me histori brezash që na mbajtën gjallë e me krenari si komb. Kërkesa për të ndërhyrë në këtë vend parajse, mendoj se ia vlen të regjistrohet si pikë e 46-të, në kërkesat ndaj kryeministrit, për qarkun e Dibrës, me shpresë se do të ketë vullnetin dhe interesin të vejë rrogatarët në punë, për ndjekje të çdo projekti të mundshëm. Shpresa, vullneti dhe mbështetja e popullit të kësaj zone është e madhe.

** Këshilltar i Bashkisë Mat dhe Qarkut Dibër*

Gjate nje veprimtarie te Shoqates Atdhetare Dibra ne New York. (Foto ilustruese)

Diaspora shqiptare në SHBA, rubini i kombit shqiptar

Nga **IZET DIBRANI**

Kur përmendim diasporën Shqiptare anekandë botës, si një aset vlerash, nuk mund të lemë pa përmendur dhe veçuar rolin dhe kontributin e diasporës shqiptare në Amerikë e sidomos asaj dibrane. Mërgatat e para që u larguan nga Dibra e Madhe, ishte ajo pjesë e veçantë dhe integrale e qytetarisë shqiptare, që u vendos në disa shtete të SHBA-ve. Kujtojmë të parin përfaqësues të dibranëve në USA, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, tregtarin e njohur dibran Eqerem Kllobuçista, i cili me punë dhe vullnet, për një jetë më të mirë, u largua nga Dibra amë për të shtegtuar në fillim në qytetet e Evropës si, Itali, Francë e pas disa vitesh u vendos përfundimisht në State Islande, NY, USA. Ai u bë pelegrini i pare dibran, i cili plot emocion, lot dhe vajtim për vendin e tij dhe të parëve të tij, tërhoqi me dhjetëra e dhjetëra familje shqiptare nga trevat e Dibrës, Kosovës, Malit të Zi, për një jetë më të mirë.

Sot po bëhen përpjeke të vazhdueshme nga ana e diasporës dibrane, që të kultivojë jashtë kombit zakonet, tradita, kulturën dhe doket e ruajtura brez pas brezi. Një rol tepër të rëndësishëm, ku mund të veçohen ekipet kulturore dhe muzikore, si dhe ato sportive, si p.sh., ekipi i futbollit "Korabi", në Amerikë, ku ka korrur suksese dhe mjaft trofe, në emrin e Kombit Shqiptar, në kampionatin amator të futbollit. E gjithë kjo mërgatë, tashmë pjesë e pandarë e vlerave amerikane, nuk i ka humbur e as nuk i ka eliminuar traditat e vyera, doket e mira. Këto familje shpesh mblidhen në raste festash kombëtare, si për ditën e Flamurit Kombëtar dhe thurin jehonë për Shqiptarinë, për të drejtat, liri dhe pavarësi për shqiptarët e Kosovës, Maqedonisë, e Çamërisë. Këto janë heronjtë e heshtur të kombit tonë, të cilëve ju valëvitet atdhetaria dhe trimëria kombëtare në Amerikë. Me profesionet e tyre të nderuara, me punët e tyre, qoftë intelektuale, akademike, shkencore, por dhe sidomos dhe me dëshirën patriotike, kanë kontribuar me të gjitha forcat për të ndihmuar shqiptarët kudo që ndodhen. Kanë ndihmuar me mijëra familje shqiptare në USA, në fillim të viteve 92', po ashtu u bënë protagonistë për liri dhe pavarësinë e Republikës së Kosovës, me ndihma mjekësore dhe humanitare, me veshmbathje dhe ushqime, logjistike, përmes donacioneve të biznesmenëve të ndryshëm dibranë në USA, por dhe përmes njerëzve të thjeshtë kur shihnin vuajtjet dhe gjenocidin serb mbi fëmijët, gratë dhe pleqtë e pafajshëm shqiptarë në vitin 1998; Ata përsëri bënë jehonë, ngritën zërin fuqishëm për të ndihmuar dhe shpëtuar mjaft jetë njerëzish të shqiptarëve të Maqedonisë në vitin 2000-2001; E kjo nuk harrohet! Nuk duhet harruar, përkundrazi duhet kujtuar si një piedestal dhe një obelisk i vyer i kombit shqiptar, besa dhe mirënjohja.

Familje dibrane të nderuara sot të ndodhura në Amerikë e kudo, e kanë për zemër kombin, e nuk e lënë të njolloset apo errësohet, nga e keqja. Ato mblidhen dhe shpesh kujtojnë, emocionohen dhe thonë: Ah, sikur të jemi aty me ju! Ah sikur të vij ajo ditë që Dibra e Madhe dhe Dibra e Vogël të bëhet një, me Rrugën e Arbrit. Është ajo diasporë dibrane ku me trimëri dhe guxim protestoi kundër devijimit të lumit Radika në selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara e ku zëri i saj u dëgjua. Sikur ta shohim Dibrën e lulëzuar dhe të bukur, siç ishte para 1912! Ah sikur!

Familje dibrane tashmë të emigruara në USA si, Klobuçista, Pilku, Shatku, Ushtelenca, Kaziu, Buxhaku, Paçuku, Duka, Ruci, Rexha, Rusi, Dema e shumë e shumë familjeve të tjera u themi, *Faleminderit dhe Mirënjohje*, që mbani gjallë në zemrat dhe shpirtin tuaj, kombin e vuajtur shqiptar e që sytë e juaj të lotuar nuk e humbën kurrë mallin për vendin dhe gjakun shqiptar, edhe pse jeni shumë larg, përtej oqeanit.

Rruga e Arbërit nr. 138 .139.

Nga arkivi i gazetarit

letërkëmbime

Letërkëmbime nga larg me Moikom Zeqon

I nderuar Abdurahim Ashiku,

Mora letrën Tuaj, të gjatë e të përmallur. Ju falënderoj me gjithë shpirt. E kuptova menjëherë se ç'ju ka shtyrë në shqetësimin Tuaj, që frymë merrte në çdo germë të shkruar. Më vjen mirë që ajo që kam shkruar unë për Himarën Ju ka bërë përshtypje. Por shumë interesante hanë ngjarjet, që më tregon dhe sidomos ato që më përshkruan për Lurën. Unë kam qenë shumë herë në Lurë dhe e dua jashtëzakonisht Lurën. Liqejtë përrallorë të Lurës nuk shkëlqejnë më si dikur, pyjet dhe njerëzit mbartin një trishtim sipas vargut rapsodik "shumë po ndrit ai Diell, por pak po nxen". Por Dielli i brendshëm i Lurës nuk mund të vdesë. Në hullinë e ekspeditave informative, që unë kam ndërmarrë në këto dy vitet e fundit në të gjithë Shqipërinë, mendoj se Lura do të jetë një motiv, që unë do ta rrok shumë shpejt dhe padyshim do të shkruaj diçka për historinë, për monumentet natyrorë, arkeologjikë dhe njerëzorë të Lurës.

Jepini të fala nga unë familjes Tuaj, tërë miqve e shokëve dhe shpresoni më shumë jo si shprehje të humorit, por të një bashkëpunimi konceptual për të ardhmen më të mirë të shqiptarëve dhe të gjithë të tjerëve,

Me respekt,
DR. MOIKOM ZEQO
Tiranë, 23.V.2003

I nderuar z. Moikom!

Larg dheut tënd çdo gjë mallzohet në atë shkallë sa shpirti njerëzor, shkon drejt rezonancës... Por nuk këputet, sepse ura që lidh dy brigjet e kujtesës, dy anët e brigjeve të dheut, ka këmbë e trarë jo vetëm mbi tokë e mbi ujë por thellë nëntokës e nën ujit. Ka rrënjë të thella siç do të thoshin biopoetët...

Para disa ditësh, në berberhanen e një elbasanlliu në Ipiru – 8, dhjetë kërcime trehapësh larg Omonias, e lashë gazetën "Koha Jonë" pa fletë mezi. Berberi që nuk lë gazetë pa marrë më telefonoi në shtëpi dhe më akuzoi se "kam vjedhë Moikom Zeqon (!)". Qesha në anën time të telefonit, ashtu siç qeshte babaxhanshëm edhe ai në anën tjetër.

E qetësova se nesër në mëngjes "do t'ia kthej Moikomin", madje i premtova se të shtunën që vjen, më 10 të majit, do t'ia ktheja në pesë mijë kopje. Të nesërmen, kur i dorëzova faqen e mesit të gazetës më tha se nuk do të më kishte shqetësuar për një fletë gazete në qoftë se nuk do të kishte gjetur belanë me një himarjot që pasi nuk kishte gjetur kopje gazete gjëkundi, kërkonte medoemos të lexonte atë që ju kishit shkruar për vendlindjen e tij.

Unë e futa "Himarën e tij" dhe "Himarën tënde" në disketë dhe pasi e bukurova me ato "rroba" që m'u ndodhën, ia përcolla lexuesit ikanak shqiptar ku ndodhej e ku nuk ndodhej në të gjithë "vilën e rrushit grek". Që mos më keqkuptoj ndokush me shprehjen në thonjëza, sqaroj se mua si biolog e tërë harta e Greqisë më ngjan me një vile rrushi me kaltërsinë e qiellit për sfond. Shihe po të duash dhe mos më jep të drejtë.

Unë vetëm një herë kam kaluar nëpër Himarë. Vetëm një herë në jetën time kam provuar të notoj në detin e saj. Vetëm një herë e kam bërë të plotë rrugën nga Vlora në Sarandë. E kam bërë kur isha student. Nuk e mbaj mend me siguri në se ishte viti 1962 apo 1964. Më vonë, në fillim të viteve shtatëdhjetë i jam afruar Himarës nga Veriu deri në Dhërmi, ku kalova trembëdhjetë ditë të bukura në kampin e punëtorëve, dhe një herë nga Saranda në Borsh. Jua thashë këto për t'ju siguruar se nuk e njoh gjerë e gjatë Himarën. Megjithatë mund të të pohoj një gjë: Bukurinë e saj, bukurinë me shikimin e parë, dashurinë me "shikimin e parë" e ruaj si një relike të çmuar të rinisë sime. Këtë dashuri të ngrirë thellë në kujtesën time mund të them se ma zgjuat ju me atë pathos të jashtëzakonshëm ku shkrihej poeti, shkrimtari, arkeologu, historiani, atdhetari...

Unë kam lexuar shumë libra tuaj. Disave u kam hyrë thellë dhe jam mbushur me gëzim kur kam mbyllur faqen e fundit. Disa të tjerë nuk i kam lexuar deri në fund. Ndoshta kjo thjesht sepse kam ndjerë ndonjë boshllëk kulturor për ato që shkruaje. Se njeriu nuk i din të gjitha dhe nuk arrin që t'i mësojë të gjitha. Kështu bën edhe miku juaj e miku im Kristo Zharkalliu, i cili ka një kujtesë fenomenale, ka një arkiv shkrimesh për tu pasur zili, por ka edhe një kleçkë që ato që i shkruan i mban për vete, u merr frymën duke i mbyllur nëpër thasë.

Unë e mora shkrimin tuaj dhe e ribotova në gazetën "Rilindja XXI" gazetë në të cilën, pas punës së lodhshme të kopshtarit, çlodh paksa shpirtin, çmallem me fjalën e bukur shqipe, çmallem nga larg me vendin tim.

Nuk ka shqiptar që të mos e njohë Naim Frashërin, poemën e tij, të mos dijë përmendësh vargje të tëra ku shprehet brenga dhe malli për mëmëdheun. Por Naim Frashëri, dhe të gjithë rilindësit e tjerë, kuptohen vetëm kur je larg Shqipërisë. Vetëm atëherë Naim Frashërit hyjnë në gjak, bëhen rruaza të kuqe dhe qarkullojnë nga zemra në tru, në shqisa, në gjymtyrë, vrapojnë rrugëve të jetës çmenduriSht...

Më mungon dheu im i dashur Moikom, më mungon shumë. Në moshën që jam (më 11 maj 2003 hyra në të gjashtëdhjetë e tretin vit të jetës) do të doja fizikisht të jem atje, të merresha me kultivimin e luleve të dheut shqiptar, të zbukuroja një vilë shqiptari e jo një vilë greku. Në moshën që kam do të doja që dijet dhe përvojën modeste jetësore t'i shkrija për vendin tim. Më mungon vendi im Shqipëria por mbi të gjitha më mungon Dibra ku linda, ku hodha shtat, ku u burrërova dhe iu gëzova lindjes së tre fëmijëve.

Ju nuk e njihni Dibrën, i dashur Moikom, ose, më saktë do të thosha, e njihni aq sa njoh unë Himarën.

Dibra, dhe e gjithë e ashtuquajtura Verilindje, ka qenë gjithnjë larg vëmendjes së intelektualëve cilësorë, larg penave të tyre. Po të hulumtosh shumicën e shkrimtarëve tanë të djeshëm, shumicën e kineastëve, do të konstatosh se vende të tilla janë trajtuar gjithnjë si vende internimi të intelektualëve. Në letërsinë dhe artin e asaj kohe heronjtë i çonin për "qarkullim" në Peshkopi, Kukës, Tropojë, Pukë...

Në vitet '80-të, i dashur Moikom, në fjalorin e politikanëve të lartë hyri slogani "Verilindje" në kuptimin si të thuash "Afrika e Zezë". Për të ndihmuar këto zona u shpik termi "dublant". U dubluan drejtorët, shefat e seksioneve, kryetarët e kooperativave duke dërguar njerëz të rëndomtë, çinovnikë, nga administrata qendrore, me paga e dieta speciale. Kjo ka qenë ofeza më e rëndë që i është bërë intelektit të këtyre zonave. Asokohe në Dibër qarkulloi një mesele, thelbin e së cilës po ta përcjell shkurt...

...Ishte kohë mbjelljesh pranverore. Një kryetar kooperative merr në telefon sekretarin e parë të komitetit të partisë dhe pasi i raporton gjendjen dhe mundësinë që mbjelljet t'i përfundojë në afat, i kërkon ndihmë...

Po të dërgoj menjëherë dy instruktorë. – i thotë sekretari

Kryetari i kooperativës, i njohur për humorin e tij, i thotë:

O shoku sekretar ! Më mirë më dërgo dy traktorë se sa dy instruktorë...

Dublantët në Dibër i quajtën "galloshe". Nofka rrjedh nga një lloj veshjeje llastiku, prodhim i NISH-gomës së Durrësit, që u vishej këpucëve për të mos u hyrë uji. Për to ka aq mesele sa po të dilte njeri t'i mblidhte do të kishim një libër të veçantë alegorik.

Me siguri, i dashur Moikom, keni dëgjuar për Universitetin e Dibrës. Dibra ka një Universitet të madh. Ai fillon kur njeriu lidh fjalët e para dhe zgjidh fjalët e fundit. Është një lloj universiteti ku njeriu "plaket duke nxënë" siç thuhet, është student i përjetshëm. Nuk jep diplomë por "diploma" e tij njihet në të gjithë botën. Unë e ndjek këtë universitet edhe pse jam larg dhe do ta ndjek tërë jetën.

..."Unë kam mbaruar Universitetin e Oksfordit, por mbarova edhe një universitet të dytë, atë të Dibrës" shkruan Reginald Hibbert...

... "Katër ditë në Dibër më kishin mësuar më shumë thelbin e politikës, se sa të gjitha librat për teorinë e kushtetutës dhe të ekonomisë politike që i kisha lexuar në Oksford" – shkruan JulianEmery.

Se kush janë Reginald Hibbert dhe Julian Emery, nuk po zgjatem. Ju i dini dhe vepra e tyre tashmë është edhe në shqip.

Shpesh, këtu në vendin ku detyrueshëm u ngujova, pyes veten: Deri kur ne shqiptarët do t'u referohemi të huajve për aksiomat historike të gjenezës sonë ? Nuk marr përgjigje. Nuk jap përgjigje. Nuk më le politika dhe politikanët tanë truri i të cilëve është në perëndim dhe jo në lindje. E kam fjalën për jetën e jo për gjeografinë e botës...

Eja, i dashur Moikom, të bëjmë një udhëtim nëpër Dibër. Unë po nisem nga Athina falë lejes së "Panagjisë së gushtit" që na japin çdo vit grekët, kurse ju nisuni në daç nga Tirana ku drejtoni Muzeun Historik Kombëtar e në daç nga Durrësi ku keni rrënjë e degë të forta të jetës suaj.

Ku thoni të takohemi?

Ku të doni por unë kam dëshirë të të pres në Fushë – Lurë.

Dikur, i dashur Moikom, kam shoqëruar në trajektoren e rrugës që lidh si një zinxhir perlash pothuajse të gjithë liqenet e Lurës, një grup gazetarësh të huaj, gazetarë profesionistë që punonin asokohe në Radio-Tirana, në emisionet në gjuhë të ndryshme. Kishte në mes tyre argjentinas, braziliané, portugezë, spanjollë, francezë, turq, kinezë, vietnamezë e ku ta mbaj mend unë. Nuk mund t'i harroj ata njerëz, përgjërimin, mahnitjen e tyre. Ishte e para herë që shihja njerëz të binin në gjunjë para bukurisë së liqeneve dhe gjelbërimit rrethues. Jo vetëm tek Liqeni i Koçekut (që ka një legjendë të mahnitshme) apo Liqeni i Madh siç quhet rëndom nga që është më i madhi ndër të gjithë, por edhe tek Liqeni i Zi, më i thelli nga të gjithë, tek Liqeni i Kallabës i fshehur pas gjelbërimit të pishave e deri tek Liqeni i Luleve më i bukuri dhe më i njohuri në fototekën e bukurive shqiptare. Ata njerëz të shkolluar në vendet e Perëndimit dhe të Lindjes, binin në gjunjë dhe murmurisnin në gjuhët e tyre lutje me vështrimin herë nga bukuria e natyrës së virgjër dhe herë nga qielli si për t'i kërkuar Zotit llogari se pse e ka fshehur kaq kohë një bukuri të tillë, pse e mban "për vete" këtë parajsë të mbitokës.

Nuk e di në se keni qenë ndonjëherë në Lurë zoti Moikom apo jo. Në qoftë se keni qenë shkoni përsëri. Do të desha të isha shoqëruesi juaj, një shoqërues modest. Do të desha t'ju marr përdore dhe t'ju çoj diku sipër Borie Lurës, aty ku gurë të mëdhenj, ciklopikë siç thoni ju arkeologët, janë vënë njeri mbi tjetrin e kanë bërë mure. Hamendjet e njerëzve që i kanë marrë si gurët në tespie nga hamendje dhe i kanë përcjellë brez pas brezi si të tilla, thonë se ata janë gurë në mure iliriane. Edhe vetë emri LURË thonë se vjen nga emri ILIRI. Do të sugjeroja t'u çoje fjalë arkeologëve të vinin dhe në mos të përdornin kazmën për gërmime, të përdornin sytë dhe të shkruanin rreshtin e parë të një historie të lashtë luriano – arbërore.

Do të desha t'ju fusja krahun dhe pasi të qarkullonim një për një liqenet t'ju çoja në Fushë të Pelave, në atë vend ku thonë se Skënderbeu kishte bazën kryesore të mbarështimit të kuajve luftarakë, ku, siç thonë legjenda pelat lindnin nga dy mëza e mëzat rriteshin e bëheshin kuaj për shalë e luftë me ditë.

Më pas do t'ju ngjisja kreshtës së malit, atje ku në njërin krah varen bukuritë e luginës së Matit me kanionin madhështor të Zall – Gjoçajt dhe me malet e Mirditës, ku mëngjeseve të maj – qershorit shihet deti. Në anën tjetër shikimi merr e ve në pëllëmbë të dorës liqenet, malet, luginat, buronjat...Në fund do të të zbrisja në Gurë Lurë, ku rakia e thanave është më aromatikja në botë, ku ka një mëhallë që quhet Thanë, mëhallë e zhytur në një pyll të tërë Thanash.

Këtu do t'ju vija para një prove, sigurisht në qoftë se nuk të lëviz tensioni dhe nuk të merren mendtë, provës së një monumenti ku natyra, dora dhe mendja e njeriut janë ngjizur e kanë formuar një konglomerat të pashkëputshëm.

Në fund të Gurë Lurës ka një burim të madh uji, një burim që del jo si zakonisht rrëzë e poshtë shkëmbit por dhjetë apo më shumë metra mbi shkëmb e në shkëmb. Del me forcë, shkumbëzueshëm, i bardhë si të dilte suferinë dëbore. Del dhe bashkohet me ujërat e tjerë që rrjedhin përrejëve që formohen nga shkarkimet e liqeneve dhe burimeve lart malit.

Pak metra poshtë burimin e Setës (kështu tash e tutje quhet) e pret një digë që i jep ujë një kanali.

Këtu nis një histori jo shumë e largët, e jetuar dhe e shkruar. Në qoftë se do ndonjë hollësi shfleto gazetën "Bashkim " të fund gushtit 1967 dhe lexo reportazhin e bukur të njërit prej gazetarëve të mëdhenj shqiptar, Hamit Boriçit.

Piketimi i atij kanali është bërë me pushkë, me një karabinë grykëgjatë gjermane trofe lufte. E ka bërë Gani Tuçepi, një legjendë (po ua marr hua këtë fjalë gazetarëve sportivë) e kanaleve ujitëse, jo vetëm në Dibër por në të gjithë Shqipërinë, tregimet për të cilin nuk i nxë asnjë duzinë librash jetësorë e artistikë.

Kalimi i Gjalicave të Lurës përbën një lloj heroizmi, një lloj guximi djaloshar. Këtë cilësi e kishin vendasit, në veçanti gurëlurasit. Megjithatë as edhe ata nuk mund të ngjiteshin e të vinin piketa në linjën nga do të kalonte kanali. Atëherë, Gani Tuçepi mori gjermanen, e vendosi mbi një niveli uji në atë lartësi ku do të niste nëpër kanal uji, e fiksoi mirë e mirë, siç dinte t'i fiksonte ai instrumentet popullorë dhe... tërhoqi këmbëzën...

Në pikën ku ra plumbi do të kalonte kanali...

Hapat e parë për hapjen e kanalit u bënë në vitin 1960. Fatkeqësisht ata hapa çuan në një tragjedi. Gjatë piketimit të kanalit ranë në hon tre punëtorë. Puna u ndërpre...

U ndërpre për gjashtë vjet. Në pranverë të vitit 1967 rifilluan punimet. Brenda pesë muajve, pa hyrë asnjë ferrë në këmbë, varur në litar u hap traseja, u hap kanali, shtatë tunele, metrazhet dhe volumet e të cilëve në këtë moment që shkruaj nuk i mbaj mend aq sa të mos bëj gabim. Në fund të gushtit 1967 Çidhna e më vonë Dardha, Reçi dhe më tej, me anën e një sifoni, mori ujë edhe Sina e vonë e më vonë uji i Setës kaloi edhe Drinin e doli në Fushë të Çidhnës, Kandër e Vakuf. E mban mend aksionin e 14 dhjetorit 1969 të dibranëve që brenda një dite "me goditje të përqendruar" hapën një kanal shtatëmbëdhjetë kilometra të gjatë ? Atje e kishte burimin...

Nejse. Sikur na mori Seta e shpejt ikëm nga Gurë Lura pa iu ngjitur atij litari, do të thosha unë, se rrugë nuk mund t'i thuash, litar në të cilin duhet t'i vesh këmbët si pehlivani në tel në donë që të të mos shohin të tjerët në fund të humnerës dhe, edhe alpinistët e Korabit me Taxhedin Shehun e madh të sportit dibran do të sëkëlldiseshin kur të zbrisnin për të të gjetur e ngjitur, sigurisht kufomë, lart.

Unë kam kaluar nëpër atë "litar" dhe tashti që tensionin e kam të lartë dhe më merren mendtë nuk do të dëshiroja një kalim tjetër. Sigurisht edhe ty nuk do të ta rekomandoja. Pastaj nuk do të na linin në këtë lloj heroizmi as edhe vendasit, testimi paraprak i të cilëve është shumë i rreptë dhe shoqërimi deri në kalim rreziku është kokëfortësish i prerë.

Dibra: Lura, Korabi, Kacnia, Tërnova, bjeshkët e saj të pambarim për të njëjtën gjë kanë nevojë. "Guaskë e moluskut", janë njerëzit, të punës dhe të penës. Pa ta, pa ndihmesën e tyre deri në vetëmohim, nuk ka "Shqipëri e Bukura e Dheut" siç thoshte një njeri i kohës i politikës shqiptare, nuk ka "Perlë"...

Mua më vjen keq që Lura është harruar, është jo "Princeshë në gjumë", siç do të thoshit ju, por është një "Princeshë e ngrirë". Po, po, e ngrirë kallkan. I vetmi zë që vjen nga Lura është një kronikë televizive e marrë para dhjetë vjetësh, kronikë që ne emigrantët jemi të detyruar ta shohim 3 – 4 herë në javë nëpërmjet televizionit satelitor, kronikë e cila pasi shpalos në një mënyrë tepër të zbehtë bukuritë e Lurës nuk mungon të fusë mes për mes "boshtin ideologjik", të shajë të kaluarën që e ka harruar Lurën, madje e ka përçudnuar bukurinë e saj duke ngritur "një digë mbi Liqenin e Madh" ndërsa nuk flet fare për përçudnimin që ka bërë sëpata me bisht të vënë nga pushtetet e kohës që jetojmë. Besoj se e dini atë fjalën e urtë që thotë se "kur pylli i dha një copë dru sëpatës për bisht i dha vdekjen e vet".

Por, zoti Moikom, Lura për mua është një bukuri jo e pa shoqe por një bukuri që ka shoqe, madje shoqe që janë po aq të bukura, në mos më të bukura se ajo.

Liqenet e Kacnisë janë fantastikë. Nuk e di por syri i aparatit tim tek ato liqene ka rrokur bukuri që ua kalojnë bukurive të liqeneve të Lurës. Liqeni i Valikardhës, afër Bulqizës, ka po ashtu një bukuri të rrallë. Në qoftë se bukuritë e liqeneve të Lurës janë "kallkan të ngrira", bukuritë e liqeneve të Kacnisë dhe të Valikardhës janë afër ngrirjes absolute. Ata më duket se nuk janë në asnjë lloj kujtese dhe bukurinë e tyre nuk e ka fiksuar asnjë fotoreporter profesionist i Tiranës.

Por të gjitha këto nuk do t'i krahasoja me bukuritë e bjeshkëve të Korabit. Në zemër të malit më të lartë të vendit, rruazës së parë të kurrizit shqiptar të ndarë nga Londra siç ndahen berrat e varur në çengel, ka një bjeshkë që quhet Ponair në theksimin vendas apo Panair në theksimin drejtshkrimor. Atje, në kohën e Turqisë, kur në bjeshkët e Korabit (në këtë anë e në anën tjetër të tij) kullosnin, siç thotë Haki Stërmilli, dy milionë dele, bëheshin panaire blegtorale, zhvilloheshin gara se kush do të paraqiste dashin më të madh e më të rëndë, delen më qumështore, qengjin rudë më leshator, djathin më të mirë, kalin më të shpejtë...

Në bjeshkën e Ponairit kam qenë në korrik 1988 me Gani Xhengon, fotoreporterin e ATSH-së. Atje kam edhe një kujtim të jetës sime, një foto nga Gani Xhengo. Ganiun e pata marrë "për dore" siç do të desha të të merrja ty, dhe i pata shpalosur tërë bukuritë e Korabit, që nga Pylli i Gramës ku flejtëm në dy shtretër mbi degët e një ahu shekullor, tek liqeni artificial, në burimet e mrekullueshme të Preshit (atje merr ujë Peshkopia dhe disa fshatra në linjën e ujësjellësit) në Fushë të Korabit e në majë të Sorokolit... Është një bukuri që nuk ka të krahasuar me asnjë vend tjetër, një bukuri vere por ndoshta një bukuri e pa arritshëm dimri. Atje, me siguri, brezat që do të vijnë, do të organizojnë sllallome gjigande skish, do të organizojnë jo olimpiada dimërore ballkanike por evropiane dhe pse jo, edhe botërore. Si historian që jeni, i dashur Moikom, po ju tregoj se misioni ushtarak britanik gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, verës së vitit 1944 çadrat i kishte vendosur pikërisht në Bjeshkën e Zonjave prej ku edhe rrjedhin kujtimet e cituara për "universitetin e Dibrës"...

E dini, i dashur Moikom se në Kala të Dodës ka një kala që i ka dhënë emrin tërë krahinës? E dini se në fshatin Ceren ka një varrezë dëshmorësh (apo shehitësh siç thonë vendasit), njerëzish të masakruar nga serbët në shtator të vitit 1913, të tridhjetë e pesë emrat e të cilëve unë i kam lexuar në "Përlindja e Shqipërisë", gazeta me kohë botimi Shpalljen e Pavarësisë ? E dini ju se karvanët me dasmorë (në krye të të cilëve ka prirë kurdoherë flamuri ynë kombëtar) kur kalojnë rrugës poshtë varrezave ndalojnë, kalorësit u zbresin kuajve dhe i marrin përdore, daullet e curlet pushojnë dhe të gjithë ecin në këmbë në shenjë nderimi dhe respekti? Njihni ju si historian, shkrimtar, e poet ndonjë rast që i ngjan kësaj? E dini Ju se në Fushë të Korabit ka një vend që quhet "Luftinë" e ku në luftë kundër serbit ka rënë me armë në dorë një grua kaladodase, Naxhije Muraku me të vëllanë? Kush e shkroi këtë histori kaq madhështore ? Askush, i dashur Moikom, askush.

Unë duhet të pohoj se Dibra ka pas pena, pena të vogla do t'i quaja, të cilat, nisur nga psikologjia e mbajtjes së "grykës së pushkës në gropë të zjarrmit" nuk kanë arritur të kapërcejnë kohët. Eles Isufi është cilësuar nga të huajt "Gjenerali me shajak" dhe është pritur e përcjellë me nderime të mëdha nga kancelaritë mbretërore e perandorake të kohës. Kush shkroi për bëmat e këtij tribuni të vegjëlisë pa u tërhequr nga litarët e padukshëm të psikologjisë së mësipërme dhe të mërive që pasuan rënien heroike të Tij kundër kundërrevolucionit zogolljano – serbo – bjellogardist të dhjetorit 1924, barrikadë e të cilit ishte Eles Isufi dhe nipi i tij Sufë Xhelili të cilët dhanë jetën, pa u tërhequr nga litarët ideologjikë që pasuan tragjedinë e familjes Ndreu në vitet '50-të? Nuk e di por e njëjta psikologji, ajo e "pushkës në gropë të zjarrmit" por edhe "boshti ideologjik" i kohës vepron me të njëjtën forcë...

Një histori dibrane ka përcjellë Dritëro Agolli i madh i letrave nëpërmjet romanit "Njeriu me top", histori të cilën e ka marrë në detajet më të hollësishme, aq sa edhe emrat e heronjve janë emrat e fiseve të vendngjarjes, Luznisë. Emrat Mere, Fizi, Mate, Gruda etj. Janë emra fisesh të fshatit Katundi i Ri, Arap i Poshtëm e Lishan i Poshtëm. Meret janë qëlluar me mortajë nga një kodër e Arapit të Poshtëm...

Dritëroi e mori ndodhinë nga Luznia dhe e përcolli në Jug, në Devoll...

Kur isha herën e fundit në Dibër mora me vete edhe një hartë që një grup intelektualësh dibranë kishin skicuar një rrugë që ata i kishin vënë emrin e saj të vjetër, aq të vjetër sa mosha e truallit që përshkoi, "Rruga e Arbrit". Një ditë, rastësisht e gjeta midis materialeve të tjera që kam në emigracion, relike në kohë e hapësirë. E mora dhe pasi i shtova fakteve që përcilleshin nëpërmjet saj paksa nga "frigoriferi" i kujtesës sime e përcolla tek një gazetë ikanake, gazeta RILINDJA XI, një fletë të së cilës po jua përcjell për të mos lodhur me mallin tim. E zura në gojë këtë sepse të martën më 13 maj pashë në televizionin satelitor zotin Nikoll Lesi në një takim me aktivistët e partisë së tij në Burrel dhe Bulqizë, në maratonën elektorale që ka filluar. Ndërmjet logjeve të zakonshme politike dëgjova se Nikoll Lesi premton se do të shtrojë në Kuvend çështjen e ndërtimit të Rrugës së Arbrit. Që ai do ta ngrejë në kuvend një gjë të tillë, në këtë kohë zgjedhjesh, ndjej disi siguri. Që Berisha dhe Nano, por edhe të gjithë satelitët e tyre të vegjël, në udhëtimet elektorale në Mat, Bulqizë e Dibër kryefjalë të premtimeve të tyre elektorale do të kenë "Rrugën e Arbrit" për këtë jam i sigurt. Këtë them se ky emër i vjetër (Rruga e Arbrit) është bërë edhe më parë i njohur, vetëm në fushatat elektorale. Me sa duket fati dhe emri i kësaj rruge do të lidhet dhe përmendet vetëm në raste zgjedhjesh dhe vetëm si "pagë votash" në fushatat elektorale. Qofsha i gabuar por kështu do të ndodhë.

Do të desha, i dashur Moikom t'i studiosh vlerat e kësaj rruge në rrafshin historik (ashtu siç din ti), në rrafshin ekonomik dhe shoqëror. Do t'ju sugjeroja një udhëtim kësaj rruge, nëpër Shkallën e Tujanit (oh, sa histori tragjike ka kjo shkallë !) e deri tek Tre Mullinjtë. Të merrje me vete edhe Sabri Shinin, njeriun që çau tunelin e Selitës dhe tunelet e hidrocentraleve të tjerë. Do të mësoje shumë prej tij ashtu siç do të mësoje shumë prej njerëzve që do të takoje. Mos harro se kjo rrugë ka një histori të madhe, histori që nuk i ka shkruar kush deri në rrënjë dhe e ka lënë të thahet. Ajo është kaq pranë kryeqytetit, kaq afër njerëzve të ditur të kombit tonë. Shpresoj që një ditë do të lexoj (ose do të ma dërgosh për gazetën tonë) një shkrim elite për këtë rrugë.

Në shtypin shqiptar gjithnjë e më shumë po bën vend "Bathorja", i kuptuar si një rrethim i Tiranës, Durrësit por pak a shumë edhe i qyteteve dhe fshatrave të ultësirës bregdetare shqiptare. Më duket se fenomeni si nga gazetarët po ashtu edhe nga qeveritarët dhe antipodet e tyre po trajtohet me një frymë raciste. Askush, të paktën nga sa kam lexuar unë në këtë skaj ku jam i imponuar të jetoj, nuk i ka bërë një analizë të thellë historike, gjeografike, sociale, ekonomike etj. Kësaj "Ikje natën" të dibranëve, tropojanëve, pukjanëve, kuksianëve, mirditorëve, matjanëve...të të ashtuquajturve "Verilindorë". Historikisht njihet një ikje e madhe dhe dyndje masive, kryesisht e dibranëve të qytetit të Dibrës së Madhe në vitin 1913 si rezultat i dhunës dhe gjenocidit serb. Unë në shënimet rrjedhë e studimeve të mija kam shumë fakte për këtë "Tragjedi dibrane", shënime të cilat më kanë mbetur në Shqipëri. Ajo ka qenë ikja më biblike se sa të gjitha ikjet masive shqiptare. Karakteristikë e saj ka qenë se ata ikën nga "shtylla kurrizore e shqiptarëve" rruazat dhe palcën e së cilës e ndanë me sëpatë siç ndahet një berr. A e dini ju zoti Moikom se ku kalon boshti gjeografik i shqiptarëve dhe ku është qendra gjeografike e etnisë shqiptare historikisht në vendin e vet? Francezët si qendër gjeografike të Francës kanë Verdunin. Po ne kë kemi ? Studiojeni dhe do të mësoni se ajo kalon nga Veriu në Jug nëpërmjet Dibrës dhe me pikë ekuilibri Dibrën. Jo Dibrën – krahinë por Dibrën – qytet, Dibrën e Madhe në anën tjetër të kufirit shqiptaro – shqiptar. Në mos besofshi mua besoni Lasgush Poradecin, Fan Nolin, Haki Stërmillin e të tjerë që Drinin e cilësonin si palcën shqiptare.

Dibranët që erdhën në '13 – tën, qytetar den baba den, qytetëruan Tiranën. Një lagje e madhe e kryeqytetit shqiptar që asokohe ka marrë emrin "Lagja Dibrane" dhe numëron mbi shtatëdhjetë mijë pasardhës të tyre. A është analizuar kjo nga historianët tanë e shkëputur si ngjarje historike?

Pse ikën verilindorët në vitet '90-të nga trojet e tyre, nga ato vende që siç pohohej asokohe jepej 75 për qind e produktit të përgjithshëm shoqëror të Shqipërisë? Jepej kromi (edhe një milionë tonë në vit), jepej bakri, mermeri, lënda drusore dhe mbi të gjitha jepej (dhe jepet) pothuajse e tërë energjia elektrike që prodhonte (dhe prodhon edhe sot) Shqipëria. Sot në këto zona gjithçka është shuar me përjashtim të tre hidrocentraleve mbi Drin dhe dy hidrocentraleve mbi Mat.

Verilindorët, i nderuar zoti Moikom, u shpronësuan në mënyrën më drastike. Asnjë reformë në historinë e Shqipërisë (ma do mendja edhe të botës së qytetëruar) nuk ka goditur një pjesë kaq të madhe të popullsisë dhe në një hapësirë gjeografike kaq të madhe. Asnjë.

Pronarët e dikurshëm; feudalët, bejlerët, agallarët, mbreti... kërkojnë tokat e tyre, kërkojnë Myzeqenë e bonifikuar dhe sistemuar kryesisht me gjakun dhe djersën e minatorëve të kromit dhe të bakrit, të ndërtuesve të hidrocentraleve tanë të mëdhenj. Nuk i kundërshtoj. Le ti marrin.

Por a nuk është e drejtë që verilindja shqiptare të marrë nga ajo që ka krijuar nga duart e veta dhe nga ajo që ka trashëguar brez pas brezi ? Të marrë pjesën që i takon nga puna luanore që ka bërë në ndërtimin e hidrocentraleve, minierave etj. Të marrë pyllin e vet, pyll i cili e ka mbajte me bukë e gjizë dhe e ka mbrojt shekujve duke mos u asimiluar? Pse pyjet e Shqipërisë, të shtetëzuar nga pushteti komunist mbetën përsëri pronë e shtetit ndërsa tokat shtetërore të bukës u shpërndanë, madje të shndërruara në truall u bënë burim i madh pasurimi për pronarët e rinj ? Vlerësoni një metër katror tokë në Lurë dhe një metër katror tokë në Sukth të Durrësit (të mos flasim për ato të rrethinave të Tiranës apo të bregdetit) dhe do të shikoni se çfarë e ka shtyrë njeriun e maleve, pa plëng e pa shtëpi, të "ikë natën" nga trualli i të parëve, nga ai truall që nuk e shkuli asnjë rrebesh në historinë shumë shekullore të ekzistencës.

E di që ndokush mendimet e mija, sipas "shatit" të tij, i duken anakronike. Po a nuk jetojmë në një kohë ku çdo gjë është jashtë saj ? Në një kohë kur i mirë është ai që rrëmben hapur në dritë të diellit, një kohë kur batakçinjtë, imoralët, hajdutët, vrasësit u bënë të pasur ndërsa nderi dhe ndershmëria vdiqën ?

Më mungon vendi im, i nderuar Moikom, më mungon tmerrësisht. Më mungon në veçanti Dibra dhe dibranët e mi. Kur isha vitin e kaluar, në prill në Dibër mora me vete, nga kopshti i prindërve të mi të ndjerë një rrënjë zambaku me pak tokë. E kam mbjellë në një vazo dhe e mbaj në ballkon. Këto ditë ka shpërthyer në lule dhe unë zhys fytyrën dhe mbush gjoksin me aromën e tij duke ndjerë aromën e vendit tim, vendit ku u rrita, ku eca zbathur duke vrarë gishtat gurëve e mbushur tabanët e këmbëve me gjembat e ferrave.

Do të desha të isha në Dibër e të shkruaja për të.

E kam një merak për Dibrën, një merak të madh. Si gazetar më ka rënë një herë rasti i keq të bëhem "Lajmëtar i dhimbjes", kam qenë i detyruar të përcjell publikisht lajmin e kobshëm të humbjes së tridhjetë dibranëve në valët e Otrantos së zezë. Nuk e përcolla si kob, e përcolla si thirrje për të kërkuar zbardhjen e të vërtetës. Lajmin e mbyllja: "Duke uruar që djemtë të kenë arritur shëndosh e mirë në Itali e familjet e kësaj zone të mos shohin gjëmë e kob Maqellara kërkon të hidhet zyrtarisht dritë mbi këtë ngjarje të rëndë, të qetësohen zemrat e ngrira të prindërve". Ka tash kaq vite, që nga 13 marsi i vitit 1996 kur i përcolla gazetës "Zëri i Popullit" ku unë punoja lajmin "Maqellara nën trysninë e një tragjedie detare", që kjo ngjarje nuk ka marrë përgjigje, që është manipuluar dhe manipulohet. Një vit më vonë erdhi ngjarja tjetër e kobshme, mbytja e anijes Sibila, ngjarje që është zbardhur nga ata që mbijetuan dhe është në hetim ndërkombëtar. Ka kaq vite që për viktimat e Sibilas hidhen mes dallgëve nga nënat e motrat shamizeza të Vlorës tufa me lule në nderim të atyre që i mori deti i egër i kurbetit të dhimbshëm shqiptar. Bashkohem edhe unë me dhimbjen e tyre. Por, i dashur Moikom, më vjen keq që humbja e dibranëve nën dallgët e Otrantos së zezë, ende nuk është zbardhur. Unë nga kjo ngjarje kam përjetuar presione e tensione të mëdha, shpirtërore dhe shoqërore, jam ndodhur në situata të tilla presioni e kërcënimesh që skematikisht i kam përshkruar në ditarin tim të vogël, madje edhe i kam botuar në dy faqe të gazetës "Koha Jonë". Nuk do të zgjatem për këtë sepse më dhemb shumë. Një gjë ama do të doja:

Së pari, të zbardhej në radhë të parë e vërteta e fshehur aso kohe për qëllime të momentit elektoral (ishim përpara zgjedhjeve të famshme të 26 majit 1996) zgjedhje që pasuan me një dhunë makabre në sheshin Skënderbej, që mbarsën piramidat e që sollën vitin e egër 1997, shkatërrimin në rrënjë të Shqipërisë e të shqiptarëve.

Së dyti, do të doja të ngrihej për ta një monument. Po të isha unë qoftë edhe një muaj prefekt i Dibrës gjëja e parë që do të bëja është të ngrija tek ura e Topojanit një monument me emrat e të tridhjetë dibranëve, monument në të cilin të venin lule nënat, motrat, gratë dhe fëmijët e viktimave çdo Ditë Vere, vend ku Drini i Zi të mbushej me lule për t'i përcjellë në Fierzë, Koman, Va të Dejes e në Adriatik aromën e tyre si një kujtim ndaj një tragjedie të madhe...

E di që të mërzita, i dashur Moikom, me udhëtimin tim të çmendur nga malli dhe brenga e njeriut dhe e gazetarit. Himara që të jetë perlë dhe të rritet e madhohet si perlat ka nevojë për guackën e moluskut. Edhe Dibra: Lura, Korabi, Kacnia, Tërnova, bjeshkët e saj të pambarim për të njëjtën gjë kanë nevojë. "Guaskë e moluskut", janë njerëzit, të punës dhe të penës. Pa ta, pa ndihmesën e tyre deri në vetëmohim, nuk ka "Shqipëri e Bukura e Dheut" siç thoshte një njeri i kohës i politikës shqiptare, nuk ka "Perlë"...

Me respekt, miku juaj Abdurahim Ashiku

Athinë, pranverë 2003

Lutfi Manjani, një nga sportistët më të shquar të Dibrës dhe jo vetëm...

Nga **SHEMSI MANJANI**

Enjoh më mirë se kushdo tjetër.Kemi kaluar gjithë jetën bashkë; bashkë në lojërat dhe veprimtaritë fëminore, bashkë në shkollë e në të njëjtin profesion. Edhe më të lidhur në vitet e rinisë, në të gjitha aktivitetet sportive ku ai, për disa vite, qe mëi miri në Dibër, duke përfaqësuar rrethin me dinjitet. Në futboll si qendërmbrojtës, në volejboll e ping-pong, i paarritshëm nga të tjerë që nga vitet '50-tëtë shekullit të kaluar e deri më sot.Ishin vite kur në këto sporte Dibra përfaqësohej për herë të parë.

Që fëmijë, në lojërat e shumta që zhvillonim, dallohej nga të gjithë ne të tjerët, jo vetëm për pasionin, vullnetin e aftësinënë çdo lojë për të qenë më i suksesshmi, por dhe për komunikimin e durimin. Nuk e pamë asnjëherë qejfprishur, të zemëruar apo të grindej me ndonjë, siç ndodhte me ne të tjerët, cilësi e virtyte këto e të tjera si të prindërvetë tij në Homesh, që Luti i trashëgoi, i ruajtidhe i çoiedhe më tej gjatë gjithë jetës.

Në fshat, sidomos në vitet e shkollës fillore, u njohëm dhe me lojën me top, top me këmbë, që filloi të na pëlqente më shumë se çdo lojë tjetër. Pasionin për të na e ngjalli Ramiz Manjani, shumë më i rritur se ne, i shkolluar. Ai, sa herë vinte në fshat pranë familjes, sillte me vete mjete sportive, ski, topa etj. Luante me të rinjtë e lagjes, ndonjëherë na fusnin në lojë edhe ne më të vegjlit. Largohej duke na e lënë topin te familja e tij që ta përdornim ne.Futbolli u bë loja kryesore në shkollë e pas saj. Pas njëfarë kohe, kur ndaheshim në skuadra për t'u ndeshur, mëi zgjedhuri ishte Luti, i dalluar dhe në lojërat e tjera. I tillë u paraqit dhe në konvikt në Peshkopi, kur erdhi në vitin 1947 në shkollën unike, në ndeshjet që zhvilloheshinkatër me katër si përfaqësues të zonave nga vinim, në një hapësirë të vogël pranë konviktit. Në një nga numrat e gazetës "Konviktori", që nxirrej nga më të rriturit Z.Sula dhe L.Hanku, ky i fundit, ndër të tjera do të shkruante: "Luti, Shema e Rizai, kuadro të reja për sportin, i thonë njëri-tjetrit, do t'i mundim për zotin".

Katër vitet e shkollës pedagogjike i dhanë Lutfiut një formim dhe maturi të mirë jo vetëm si sportist, por dhe në çdo drejtim. Në futboll e volejboll, ai, më i riu, eci në gjurmët e më tëmirit në qytetin e Peshkopisë, Hazis Shehut (Isaku), qytetar i nderuar, sportisti mëi mirë për disa vite derisa ia lejoi mosha. Lutfiu, jo vetëm e arriti, por u ngjit më lart. Nëshkollën pedagogjike njohu dhe përvetësoi dhe lojën e pingpongut. Kontribut për njohjen dhe përvetësimin e kësaj loje si dhe të lojërave të tjera dha ish-kujdestari i konviktit Hajdar Haxhihyseni nga Elbasani, që krijoi ambient, pajisje e kushte për këtë lojë. E kujtojmë gjithnjë atë, sot 90-vjeçar, banues në Durrës.

Pas mbarimit të pedagogjikes, Lutfiu nuk vazhdoi arsimin e lartë, nga nevojat e ngutshme familjare, ndonëse doli shumë mirë me mësime, duke thyer konceptin frenues se sporti të pengon për të mësuar. Do të fillonte punën si mësues i përkushtuar në detyrë, përfshirë dhe kontributin për sportin me nxënësit e të rinjtë në zonat ku punonte, i lidhur ngushtë me mësuesit e fizkulturës

Ndeshja me "Partizanin", kategoria e pare, 1962. Lutfiu djathtas.

e të tjerët, gjithë pasion për sportin, duke u bërë mëi dashuri e ë i respektuariprej tyre.

Përfaqësimi i rrethit në takimet për sportet e sipërme, duke filluar nga kampionati në kategorinë e dytë për futbollin në vitin 1958, do ta gjente Lutfiun në qytetin e Peshkopisë, të nevojshëm e më të mirinpër këto aktivitete. Filloi punën si kujdestar konvikti, mëi afruari dhe mëi dashuri për konviktorët, pjesëmarrës me ta në të gjitha lojërat me top, kujdestari "tolerant"tamam si prind, cilësi këto të nevojshme e të mirëpritura prej tyre.

Trajneri ynë, Vasif Biçaku, ish-lojtar i kombëtares në Ballkaniadë, në përgatitjet për ndeshjet e futbollit në kategorinëe dytë, që në praktikat e para njohu aftësitë e Lutfiut, e zgjodhi kapiten të ekipit dhe, mëkryesorja, i gjeti vendin në ekip si qendërmbrojtës, pozicion të cilin e mbajti vazhdimisht. Në këtë pozicion, në të gjitha ndeshjet e kampionatit dhe në spartakiada, përballoi me shumë sukses jo vetëm sulmuesit e kategorisë së dytë, por dhe ata të kategorisë së parë, kur dolëm në këtë kategori, kategoria superiore e sotme. U ndesh me lojtarët sulmues më të mirë të republikës, Panajot Pano, Refik Resmja Jareci etj., duke bërë figurë të mirë. Kur ne kryesonim kategorinëe dytë, trajneri i "Partizanit", Sllave Llambi, në kërkim të një qendërmbrojtësi për skuadrën e tij, pasi kishte parë shumë ekipe, erdhi në ndeshjen tonë me "Traktorin" e Lushnjës. Lutfiu nuk dinte gjë për ardhjen dhe qëllimin e tij. Pas ndeshjes, aii pohoi trajnerit tonë se qendërmbrojtësi ynë ishte mëi mirii ekipevetëkategorisë së dytë.

Për tëpërcaktuar ekipin që do të futej në kategorinë përkatëse në volejboll, me Lutfiun si pikën më tëfortë të ekipit, arritëm deri në finale ku humbëm me Sarandën vetëm në pikën e fundit, të konsideruar faull kundër nesh nga arbitri. Po të kishim fituar, duke u përfshirë në kategorinë përkatëse, do të ecnim dhe në volejboll siç eci Saranda, siç ecëm edhe ne shumë vite më vonë me ekipin e volejbollit të femrave. Kjo arritje e jona në volejboll, pa përgatitje të planifikuar, vetëm me lojërat e liraqë zhvillonim shpesh pranë shkollës,iu dedikua lojës së Lutfiut, i cili, me aftësinë, trupin e gjatë e të formuar,i mori të gjitha pikët në gjuajtjet nga vija e parëe,në disa të tilla, dhe nga vija e dytë. Jo vetëm kaq. Ai pati shumë sukses në bllokimin e lojtarit më të mirë të Sarandës, i quajtur Leko.

Në njënga kampionatet e pingpongut në Korçë, Luti me lojërat e miraarriti deri aty sa t'i rrezikonte titullin kampionit, duke i marrë një set e duke rezistuar dhe në të tjerët. Figurë të mirë bëri në këtë sport edhe shumëvite më vonë, në vitet e pensionit, si përfaqësuesikësaj moshe në ndeshjet midis Shqipërisë, Kosovës e Maqedonisë, të zhvilluara në disa qytete, ndonëse kishte shumë vite diferencë në moshë me kundërshtarët. Pjesëmarrës në ndeshje e organizator i këtyre aktiviteteve ishte dibrani Shkëlqim Hoxha, ish-mësues fizkulture, i pasionuar për sportin (si daja i tij Hazizi, i përmendur më sipër). Ai e adhuronte Lutin si mësues e sportist, duke e vlerësuar sikrenari të sportit dibran.

Nuk mund të lihet pa u përmendur në mbyllje dhe fakti që Lutfiu, krahas marrjes me sport, shumëi angazhuar, me vullnetin e tij do të përfundonte dhe arsimin e lartë në Universitetin Shtetëror të Tiranës me korrespodencë me rezultate të mira duke i dhënë të gjitha provimet në afatin e caktuar pa asnjë shtyrje. Pas kësaj arritjeju emërua mësues në gjimnazin e qytetit, shumëi përkushtuar dhe i vlerësuar nga kolektivi mësues-nxënës e drejtori, legjenda e arsimit dibran, Selim Alliu.

Kam mall për Lutin si shumë të tjerë që, sa herë më takojnë, më pyesin për të. Mall dhe dhembje për ndarjen me të pas largimit të tij në Amerikë te djali dhe dy vajzat. Ai jeton tashmë atje, 83 vjeç,i rrethuar me nipër e mbesa, përfshirë dhe dy fëmijët e djalit tjetër qëe ka këtu në Tiranë, të cilët janë në Amerikë. Ata të gjithëi japin kënaqësi të veçantë me ecurinë e tyre në jetë. U ndamë në një periudhë kur kishim organizuar takime në disa ditë të javës te vajza ime në Sauk, me shtëpi afër tij. Ifillonim takimet me një kafe, 2-3 lojë shahu e përfundonim po aty me pingpong, lojëntonëtë preferuar e të ushtruar dhe në pleqëri,që na jepnin kënaqësi ne të dyve e vajzës sime prezent, Teuta, me shumë konsiderata për Lutin e fëmijët e tij. Konsiderata të veçanta prej vitesh kishte për Lutin si mësues, sportist e familjar, me moral e karakter për t'u admiruar dhe bashkëshortja ime, Nevrezi, mësuese e drejtuese në shkollat e qytetit, disa vite dhe në gjimnaz së bashku me të.

I urojmë jetë të gjatë me shëndet tëmirë e lumturi familjare Lutit tonë të nderuar e të respektuar!

Ekipi "Korabi", 1960.Ndeshja kualifikuese për në kategorinë e parë. Lutfiu - kapiten i ekipit.

arsim

Sipas Xhemal Domit(Arsimi në Kala të Dodës, Dorshkrim)në shkollën e Ploshtanit, që vazhdoi mësimin deri në vitin 1939, kur shkolla u mbyll, pati afërsisht 20-25 nxënës çdo vit.

Shkolla e parë shqipe në Kala të Dodës, mbartëse e traditave shekullore të dijes e shkollimit

Nga **Beqir SHEHU**

Krahina e Kalasë Dodës, me pozicionin e saj gjeostrategjik shumë të rëndësishëm nga ku sigurohet lidhja më e shkurtër dhe më e lehtë midis Ultësirës bregdetare e Luginës së Drinit të Zi me Kosovën e Pellgun e Pollogut, me kullotat alpine nga më të mirat në të gjithë zonën e Ballkanit Perëndimor, ku me sukses, banorët e kësaj krahine, që në lashtësi, kanë mbarshtruar delen rudë, duke siguruar një jetë ekonomike më të mirë në krahasim me krahinat tjera, ka krijuar një shtrat etneokulturor që krahas dukurive të përbashkëta kombëtare e makrokrahinore, kanë spikatur edhe disa veçori dalluese jo vetëm në zakone e tradita dhe në mënyrën e jetesës, por edhe në zhvillimin e dijeve e shkollës duke e përcaktuar Kalanë e Dodës një krahinë etnologjike elitare në të gjithë zonën verilindore të vendit tonë

Dicitura e fotos: Ministrja e Arsimit dhe Shkences, Lindita Nikolla, mes mësuesve të shkollës së Radomirës, nëntor 2017.

DISA VEÇORI TË ZHVILLIMIT TË DIJEVE E SHKOLLËS NË KALA TË DODËS.

Historia e zhvillimit të dijeve dhe shkollës, nuk mund të shikohet e shkëputur nga historia e përgjithshme e një vendi pasi ato janë tharma e përgatitjes dhe e gatimit të zhvillimeve historike, ndaj edhe zhvillimet historike të dijeve dhe shkollës, për banorët e krahinës së Kalasë së Dodës, ka qenë një obligim i përhershëm duke e konsideruar si pjesën më kreative të jetës. së tyre Duke shfrytëzuar të gjitha mundësit dhe lejimet e kohës banorët e këtij visi edhe kur kanë qenë mirë por edhe në periudha shumë të vështira arritën që të mbanin gjallë dëshirën për dije e shkollim.

Në visin e Kalasë së Dodës, dituritë dhe shkolla nuk janë zhvilluar të shkëputura nga njëra tjetra. Ato kanë patur gjithmonë lidhje e ndërveprim, madje edhe me kulturën e vendeve fqinjë dhe atë fetare. Për mungesë dokumentesh hershmërinë e zhvillimit të dijeve e gjykojmë mbi bazën e gjetjeve arkeologjike, të objekteve të kultit, të toponimisë, folklorit etnografisë etj. Të gjitha këto së bashku, ashtu të virgjëra siç janë, dëshmojnë një të vërtetë historike, për zhvillimin e një kulture të lashtë dijesh e deri te shkrimi i gjuhës në formën më të thjeshtë të saj. Shenjat e shkrimit të parë si piktografia, ideografia e më pas edhe të fonografisë i gjejmë për gjatë gjithë luginës së Drinit të Zi, Penestisë antike, e deri në Shkodër. Piktograme të tilla kemi edhe në teritorin e Kalasë së Dodës, si ato të gjetura në shpellën e Kalishtës, në të djathtë të grykëderdhjes së lumit Mallës në Drinin e Zi, të Kalishtës në bregun e Drinit të Zi, dhe në shpellën e Kepit të Fshatit, ku gjejmë vizatime skematike objektesh e kafshësh si dhe pjesë figurash njerëzore të mitizuara..

Hershmëria e zhvillimeve të dijeve e kulturës në Luginën e Drinit të Zi e cila nga Shkodra e deri në Prizren, Dibër e Ohër, shoqërohej nga rrugë të rëndësishme perëndim-lindje e anasjelltas ku ndodhej edhe visi i Kalasë së Dodës, e tregojnë edhe prania e dhjetra qendrave të banimit të quajtura Qyteza, emri i të cilave ruhet edhe në ditët tona si në Vilë, Fshat, Tallamaz (mes Shullanit e Radomirës, e Dode), të cilat flasin për një zhvillim ekonomiko-shoqëror, si dhe begati dijesh e kulture me vlera të veçanta :në fushën e organizimit shoqëror, në fushën e prodhimit, në kulturën e jetesës etj. Banorët e bashkësive blegtorale të Kalasë së Dodës, veçanërisht për mbarështimin e blegtorisë, sollën një begati të paparë eksperience e dijesh, të pasqyruara në mënyrën e jetesës e deri edhe me zbulime mjetesh e prodhimesh si djathi i Korabit, mishi i that i deles rudë, sexhadet e qylimat që punoheshin nga vajzat duararta dhe veshjet, veçanërisht ato të burrave që ishin të veçanta për bukurin, elegancën dhe vlerat e tyre në ruajtjen e shëndetit, të cilat u njohën jo vetëm në territorin e trojeve shqiptare por njiheshin dhe kërkoheshin edhe deri në dyert e Stambollit.

Për nivelin e lartë të dijeve në fushën e prodhimit po japim vetëm disa të dhëna për RABUSHËN, një instrument vlera e të cilit ishte një zbulim i madh i këtyre blegtorve mendjendritur që u shërbeu në qindra vjetë për marrëveshje, numërim e llogaritje para se të përdorej shkrimi. Rabusha ishte një mjet i thjesht i ndërtuar prej një copë druri, kryesishë lajthie, me gjatësi 20 deri në 50 cm. i gdhendur në katër anët, në faqet dhe këndet e së cilës, me majën e thikës, gdhendeshin shënja sipas një kodi të caktuar dhe bëheshin llogari të sakta të cilat ruheshin, madje edhe në vite, nga agallar esnaf e pronar bjeshkësh duke krijuar edhe biblioteka me këto instrumente, ku me studimin e tyre në vite përcaktonin edhe masat e një zhvillimi prespektiv. Rabusha përdorej në tregëti po veçanërisht në organizimin e staneve të bashkuara, ku shënoheshin krerët e deleve të gjithsecilit, sasia e bulmetit që do të merrte, shpenzimet që kryheshin në stan dhe sa duhet të paguante secili pjesëtar sipas numrit të bagëtive që kishte grupuar në stan etj.

Një veçori e zhvillimit të dijeve tek banorët e Kalasë së Dodës që tregon edhe hershmërinë e tyre dhe të banorëve të këtij visi është lidhja me fenë, madje që me paganizmin;ku njohuritë fetare nuk jepeshin e aplikoheshin si dogmë por lutja shoqërohej me rite..

Ndikim të rëndësishëm në përhapjen e dijeve e kulturës, veçanërisht për mënyrën e jetesës, në krahinën e Kalasë së Dodës kanë patur edhe rregullat e parimet e fesë Islame e cila që në mesin e shekullit XVI kishte pushtuar mendjen dhe zemrat e banorëve të kësaj krahine.

Me përhapjen e Islamit dhe ndërtimin e institucioneve fetare, teqeve dhe xhamive, në fshatrat e Kalasë së Dodos, krahas edukatës fetare këto institucione morën përsipër edhe përhapjen e dijeve krysisht në fushën morale si dhe të shkollimit në gjuhën turke me anë të mejtepeve që ngriheshin pranë këtyre institucioneve.

Mejtepet, si shkolla në gjuhën turke, në krahinën e Kalasë së Dodës, filluan kryesisht në mesin e shekullit XVIII në zbatim të reformave të Tanzimatit; ku për vilajetet shqiptare të myslimanizuara lejohej hapja e shkollave fetare (medreseve) vetëm në gjuhën turke. Këto shkolla, të cilat janë një hap drejt shkollës shqipe, u ngritën pranë Xhamijave:

Në Radomirë në vitin 1902(1318 h)me mësues Hafuz Nexhipi. U hap shkolla katër klasëshe fetare ku krahas dijeve fetare jepeshin edhe njohuri për gjeografinë, aritmetikë elementare, bukurshkrim etj.

Në Ploshtan;në vitin 1902 me mëses Molla Sadikun, Molla Tefiku, Molla Gafurri.

Në Kalis:Mejtepi u hap në xhaminë e katundit nën kujdesin e sheh Hasanit të parë, ku jepnin mësim:sheh Rremi, sheh Sheqiri e sheh Misimi.

Në Fshat;Mejtepi hapet nën kujdesin e sheh Salihit i cili ishte dhe nismëtar për shkrimin shqip me alfabet arab.

Në Xhaminë e Gjegje;Mejtepi hapet në vitin 1902;mësonin djemë por edhe vajza nga Gjegjet Bushtrica, Matraxhi e Vasija Jepnin mësim:Hafuz Shaban e Ramadan Lita

Mejtepi i Vasije u hap nga hoxhë Vasija, Haxhi Rexhepi, e Sheh Veseli.

Mejtepi i Vilës u hap në fillim të shekullit XIX. me mësues Osman Hasën (Molla Osmanin)

Mejtepi i Palushe;u hap pranë Xhamisë së këti katundi ku jepnin mësim Hafuz Potja, Molla Halili, dhe Sadik Potja i njohur si Molla Sadiku.

Sipas Selnames së vilajetit të Prizrenit të vitit1898 (1314h), ndërmjet të tjerash thuhet:"Ka një nahije që quhet Kalasi Nahije (Nahija e Kalasë). Kjo nahije ka 7 shkolla (mejtepe) me 350 djem dhe 100 vajza.. Kalaja ka kullota të mëdhaja ku kullosin mijra kokë bagëti. "(H. Kaleshi, Vilajeti i Prizrenit). Krahas procesit muslimanizimit, në fshatrat e Kalasë Dodës, ka ecur edhe përgatitja e klerit mysliman që kryenin edhe detyrën e mësuesit pranë mejtepeve. Në fillim imamët e xhamive kanë ardhur nga vise të muslimanizuara më herët, ku qenë ngritur medrese për të përgatitur hoxhallarë e misionar të islamit, si në Prizren, Shkup, Tetovë, Selanik, Stambollë. Më vonë, bijë blegtorësh shtegtarë, e familjesh të pasura nga krahina, që nuk ishin pak, u shkolluan në këto medrese, duke formuar klerin mysliman vendas, deri edh me grada e tituj shkencore si, imamllarë, hafuzllarë e deri Shehulislam të cilët me interpretimet dhe predikimet e tyre, dhe në bashkëveprim me shehëlerët e teqeve, krijuan një mjedis fetar, ku parimet e Islamit, gjetën një shtrat përbashkësishë kulturore, dhë pika të shumta kontakti, me kulturën e jetesës dhe zakonet e traditat e këtij visi.. Njohja me parimet dhe rregullat Islamit, të banove të krahinës së Kalasë Dodës, nga këtë personalitete dhe detyrimi religjioz për t'i zbatuar ato, gjeti aq përshtatshmëri dhe pika takimi me proçeset e zhvillimit të jetës, të zakoneve e traditave të banorëve të Kalasë Dodës, sa duket sikur vetë jeta e këtyre banorëve e gjeti rrugën e Islamit duke dhënë një produkt me vlera në formimin e identitetit kulturor e moral për banorët e krahinës së Kalasë së Dodës..

Një nga rregullat themelore të Islamit që gjeti një shtrat kulturorë me përbashkësi deri në intimite të jetës së banorëve të Kalasë Dodës ishte Namazi, (lutja islame). Namazi nëpërmjet dy aspiratave; as lutje pa pastërti dhe As përpjekje shpirtërore pa përpjekje të njëkohshme fizike e shpirtërore, ndërtoi një dimension të ri në organizimin e jetës për banorët e myslimanizuar të këtyre fshatrave.. Falja e namazeve gjatë ditës, duke kryer dy elementët racional të namazit, pastrimin (abdestin) dhe lëvizjet në procesin e faljes, jo vetëm gjallëruan jetën e banorëve, veçanërisht të moshuarve dhe grave, por pas ndërtimit të xhamive dhe teqeve dhe kryerjes së namazit të përbashkët (në xhami me Xhematë), namazi fitoi edhe një dimension të ri shoqërorë. Namazi i përbashkët në xhami i bashkonte besimtarët, jo vetëm për lutje të përbashkëta, por edhe për takime të drejtpërdrejta midis tyre ku bisedonin, këmbenin mendime, merrnin informacion, dëgjonin imamët që bënin zbërthimet e Ajeteve të Kuranit dhe jepnin edhe porosi për ndërtimin e jetës me punë të ndershme dhe larg haramit e punëve të këqija. Kështu Namazi i përbashkët ku merrnin pjesë edhe gratë, për bashkësitë fshatare të Kalasë Dodës, mori atributet e një shkolle të bashkimit të përditshëm të besimtarëve vullnet mirë.

PËRPJEKJET E PARA PËR SHKOLLIM NË GJUHËN SHQIPE DHE SHKOLLAT E PARA NË PLOSHTAN E KALISË.

Zhvillimi i procesit mësimor në mejtepe pranë xhamive e teqeve, ishte i nevojshëm por jo i mjaftueshëm. për fshatrat e krahinës së Kalasë së Dodës. Në Radomirë, në vitin 1917, u bë përpjekja e parë për hapjen e Shkollës shqipe. nga një mësues që populli e quajti, "Hoxhë Llatini", por duket se nuk u përkrah nga paria e vendit dhe u detyrua të largohej.

Sipas Xhemal Domit, Shefki Manellari, nga Radet e Radomirës, i cili kishte ra në kontakt me rilindës shqiptar në Selanik, në vitin 1918, hapi një Klasë për mësim në Rade por nuk arriti të grumbulloi fëmijë, pasi drejtuesit e mejtepeve kishin autoritet dhe të lidhur me parinë nuk e lejuan.

Përpjekje për hapjen e Shkollës shqipe u bënë edhe në Fshat. Mësuesi Ahmet Jashifi nga Gjakova, dhe Kol Shala nga Shkodra me gjithë përpjekjet e tyre nuk arritën të mbledhin nxënësit, të penguar nga kleri fetar e paria e fshatit. që nxitën popullin ti përzane pasi propogandonte shkrimin me shkronjat e Kaurrit, (shkronjat e alfabetit latin).

Lufta ballkanike e viteve 1912-13, dhe vitet e luftës së parë botërore, për banorët e fshatrave të Kalasë së Dodës ishin periudha më e errët e historisë së ksëaj krahine. Çdo vlerë e krijuar në shekuj, u përmbys dhe u shkatërrua si në ditën e kjametit. Të njëjtin fat patën edhe medreset e ngritura pothuaj në të gjitha fshatrat.

Vetëm në vitin 1922, pas largimit të pushtuesve serb Qeveria e Tiranës, me kërkesën e Osman Litës, dekretoi hapjen e dy shkollave shqipe në Ploshtan dhe në Kalisë. ndërsa mejtepet u rihapën në Radomirë, Caren, Ploshtan, Gjegje, e Fshat e vazhduan të funksionojnë deri në vitet 1943-44. Shkolla e parë shqipe në Kala të Dodës hapet në nentor të vitit 1922 në fshatin Ploshtan. Në shkollën e Ploshtanit mësuan djem nga Ploshtani, Cereni, Radomira, Shullani, Vasijet, Matraxhi, Palushet, Bushtrica dhe Gjegjet. Shkolla e Ploshtanit filloi në Xhaminë e fshatit, me mësues Besim Dalliun, i cili kujtohet me respekt, deri edhe në ditët e sotme për përkushtimin e tij në detyrën e mesuesit por edhe si njohës i zakoneve e traditave në këtë krahinë që i pëlqente aq shumë. Besim Dalliu vinte nga familja e Dallinjëve, ku shquhej edhe një personalitet tjetër pinjoll i këtij fisi, Hafuz Ibrahim Dalliut nga Tirana, i cili veç veprimtarisë fetare, atdhetare e publicistike, ka lënë edhe vepra me vlera të larta edukative mes të cilave përmendet "Patriotizma në Tiranë".

. Ndihmesë të rëndësishme për shkollën shqipe në Kala të Dodës, në fillimet e vitit 20 të shek:XIX., ka dhënë Harun Jakup Domi. i cili solli një abetare të gjuhës shqipe nga Konstanca e Rumanisë që u përdor në shkollat e Ploshtanit, Kalisit dhe Radomirës, ku Haruni kreu edhe detyrën e mësuesit.

Sipas Xhemal Domit(Arsimi në Kala të Dodës, Dorshkrim)në shkollën e Ploshtanit, që vazhdoi mësimin deri në vitin 1939, kur shkolla u mbyll, pati afërsisht 20-25 nxënës çdo vit. Gjatë këtyre viteve, në shkollën e Ploshtanit shërbyen edhe mësuesit Gjon Kabashi, Riza Riza, Gafurr Brika, Ibrahim Riza, Zeqir Zeka, Mahmut Josufi, Tef kuqani, Ali Sadik Ndreu, Rifat Domi Dhe në shkollëne hapur në Rade më 1937 Alush Isak Abazi.

Shkolla e Kalisit u hap në nëntor të vitit 1922 në shtëpinë e Adem Bajës me 34 nxënës me mësuesin nga Kosova, Mahmut Rrotulla. Kjo shkollë me disa nderprerje do të vazhdoj deri në vitete Luftës së Dytë Botërore, ku kanë dhënë mësim edhe mësuesit, Harun Jakupi, Mehdi Daci, Xhemali Shehu, nga Bicaj e Ali Dika (Ndreu), nga Sllova. Nxënësit e kësaj shkolle, sollën në fshatrat e Kalisit, jo vetëm dije e shkollim por edhe kulturë e zhvillim në të gjitha fushat e jetës.

(vijon në numrin e ardhshëm)

Rruga e Arbërit nr. 138 .139.

Me rastin e 50-vjetorit të shkollës së Minierave në Bulqizë

arsim

Shkolla që i dha frymëmarrje minierës

Bulqiza para vitit 1942 kishte dy lagje Kola dhe Dëriçe, pjesë të fshatit Vajkal. Më 1945 u hap një dhomë mësimi me 4 klasë, e cila shërbeu edhe për kursin kundër analfabetizmit. Më 1953, pesë vjet pas hapjes së minierës, filloi shkolla 7-vjeçare pa shkëputje nga puna, kryesisht për punëtorët e minierës, me një mësues. Më 1955 u ndërtua shkolla me 4 dhoma mësimi,u hap rruga për shkollën 7-vjeçare me shkëputje nga puna, rreth 100 nxënës, ku jepnin mësim 8 mësues. (B.Lami Rruga e Arbërit Prill 2012)

Për 20 vjet qyteti u rrit 30 herë, më 1968 kishte 3268 banorë, numri i nxënësve u shtua, u zgjeruan shkollat fillore dhe 8-vjecare prandaj shkolla e mesme ishte kërkesë e kohës dhe detyrë e ditës.

Pesëdhjetë vjet më parë, më 1 tetor të vitit 1967, një shkollë e mesme pa shkëputje nga puna hapi dyert në qytetin minatorëve me tre degë miniera, gjeologji, elektro-mekanikë. Më 1970- 1971 dolën 34 elektromekanikë,21 teknike miniere e 26 gjeolog. Nxënësit punëtorë si Shefqet Deriçi, Nuredin Dervishi, Faik Shehu, Hasan Deda, Fitore Cani u bënë mjeshtër të vërtetë të prodhimit, një pjesë prej tyre kuadro si Zenel Deriçi, Hysen Voka, Lutfi Loka, Panore Kolloshi, Hasan Gjini, Kapllan Alia, Hysen Hoxha, Abas Deda, Isuf Kurti, Esat Keta, Sabri Cara etj.

Më 1969-70 filloi mësimin shkolla profesionale e Minierave me shkëputje nga puna. Për minierën dhe arsimin e qytetit të minatorëve ishte një ngjarje e madhe. Të rinjtë e fshatrave Zerqan, Shpenzë, Fushë-Bulqizë, fshatrave të afërt me Bulqizën, u jepej mundësia e shkollimit në arsimin e mesëm. Koha do të vërtetonte se shkolla i dha gjallëri e frymëmarrje minierës gjithë jetës kulturore e fiskulturoro-sportive qytetit.

Më 1973 u ndërtua godina e re, përballë spitalit, u siguruan kuadri mësimor i specializuar, laboratorë të fizikës, kimisë, bashkë me bazën materiale që nevojitej për mësim. Fillimisht shkolla ishte e bashkuar me 8-vjeçaren. Drejtues shkolle ishin Myfit Dervishi – drejtor, Zymbyle Zeneli e Jonuz Muça –zëvendësdrejtor. Mësuesit e parë ishin Bashkim Lami, Sabri Abdiu, Sejfulla Shehu, Hasan Lami, Hamit Dervishi, Andrea Simo, Ilir Belegu. Lëndët profesionale i jepnin inxhinierët e gjeologët më të mirë të minierës: Jorgo Kola, Agim Dobi, Koço Gushi, Bashkim Lleshi, Vasil Gruda, Hamza Gurra, Rustan Loka, Burhan Lohja, Hasan Bekteshi, Artan Ceka, Fatjon Tuku, Përparim Hoxha etj. Me zgjerimin e shkollës , hapjen e degëve të reja duheshin kuadro të tjerë prandaj erdhën mësues të rinj e me energji, si Zija Ndrukaj, Bedri Karapici, Fatmir Zaraliu, Arben Sinoimeri, Hajri Mandri, Bedrie Dani etj. Në ish shkollën e Vjetër u instalua baza Prodhuese me torno, kombinat druri, saldatriçe me oksigjen, ku punonte mjeshtri Vehbi Konesha, një punishte çiftelish me mjeshtrin Nazmi Gjoka nga Dushaj i Fushë-Bulqizës. Baza prodhuese i dha ndihmë shkollës me të ardhurat që siguronte. Tornoja prodhonte materiale të imta, për nevojat e minierës. Çiftelitë i merrnin institucionet kulturore të rretheve Mat, Kukës, Mirditë, si dhe shtëpitë e kulturës së fshatrave të rrethit Dibër.

Shkolla profesionale e Bulqizës krijoi e grumbulloi një eksperiencë, falë ndihmës së përhershme e të pakursyeshme të minierës e gjeologjisë, të drejtuesve e kuadrove të saj, si Todo Manço, Llambi Gegprifti, Martin Cukalla, Bujar Pata, Thanas Deda, Ismalil Losha, Bajram Puca, Sefedin Qorlaze, Nazmi Përkola etj.

Shkollës i hapeshin dyert dhe i plotësoheshin të gjitha nevojat për bazë materiale, pajisjen e kabineteve mësimore, realizimin e praktikave, ekskursionet mësimore, transportin e nxënësve e shoqërimin me personel inxhiniero-teknik gjatë praktikave mësimore sistemimin e mësuesve me familje dhe atyre beqarë në hotelet e punëtoreve. Vetë qytetarët, familjarët prindërit mësuesve u krijuan një ambient të ngrohtë e dashamirës, që padyshim ishte pjesë e suksesit dhe rezultateve të mira që e shoqëruan shkollën profesionale të Minierës. Puna plot pasion e mësuesve dhe nxënësve të shkollës i dha frytet e saj.

Pesëdhjetë vjet më parë, më 1 tetor të vitit 1967, një shkollë e mesme pa shkëputje nga puna hapi dyert në qytetin minatorëve me tre degë miniera, gjeologji, elektro-mekanikë. Më 1970- 1971 dolën 34 elektromekanikë,21 teknike miniere e 26 gjeolog. Nxënësit punëtorë si Shefqet Deriçi, Nuredin Dervishi, Faik Shehu, Hasan Deda, Fitore Cani u bënë mjeshtër të vërtetë të prodhimit, një pjesë prej tyre kuadro si Zenel Deriçi, Hysen Voka, Lutfi Loka, Panore Kolloshi, Hasan Gjini, Kapllan Alia, Hysen Hoxha, Abas Deda, Isuf Kurti, Esat Keta, Sabri Cara etj.

Në frontet e Minierës u shquan teknikët e rinj si Ilmi Manjani, Mustafa Lami, Bashkim Toçi, Kujtim Manjani, Kadri Zeneli, Hysen Terziu, Fadil Hidri, Islam Uka, Destan Loca, Hajdar Pasha Shpëtim Ferruku etj.20% e nxënësve të shkollës mbaruan Universitetin e Tiranës, Fakultetin Gjeologji-Miniera, ku një pjesë e tyre u bënë drejtues të Minierës si Vehbi Musta, Agim Vargu, Kujtim Gjoka, Fadil Cani, Gëzim Dauti, Petrit Deva, Kujtim Alliu, Afrim Okshtuni etj. Inxhinierë të Pasurimit dolën dhe vajza, si Llomi Kola, Rolanda Dervishi, Luljeta Krosi, Luiza Tuma Natasha Velia, Albana Alla etj. Një grup që mbaruan shkollën e mesme të Bulqizës shkuan në Kinë për të rritur shkallën e kualifikimit, duke u përgatitur për fabrikën e Pasurimit(1971-1972),disa te tjetër në vitin 1977-1978 shkuan në fabrikën e Kalimashit në Kukës për të dhënë eksperiencë e përvojë të fituar në fabrikën e Bulqizës.

Në vitet 1980—1990 shkolla bëri emër shumë të mirë midis shkollave të mesme profesionale në shkallë vendi. Kjo u arrit në saj të ndihmës së madhe që dha fakulteti Gjeologji-Miniera, shkolla e mesme Përrenjas , mësuesit specialist të shkollës e në veçanti Zija Ndrukaj, Mustafa Sadiku, Hajdar Kacani, Zaim Trupja, Asllan Pata etj. Për 15 vjet Osman Miha (Drejtor) me kolegët e çuan me përpara traditën e shkollës, punoi me vullnet e pasion për konsolidimin e rritjen e cilësisë në procesin e mësimdhënies. Si autor hartoi tekste mësimore, si Makinat e Transportit I, II (për klasën III-IV; Art-Miniera etj, qe u përdorën në të gjitha shkollat e mesme të minierave të vendit tonë.

Në vitin shkollor 1976-1977 u hap dega e Agronomisë, lëndët profesionale i dhanë Nazmi Puca, Mustafa Kashari e Pëllumb Toska. Në vitin shkollor 1980-1981 u hap shkolla e mesme e përgjithshme, e cila vazhdon të plotësojë nevojat e qytetit me njerëz të ditur. Me përgjegjësi e me përkushtim shkrinë përvojën e tyre mësuesit Nafie Jella, Hajri Mandri, Besa Kata, Bashkim Novaku, Medin Karaj, Sami Rama, Flamur Gjymyshka, Diana Çule, Hamdie Beqiri, Bilbil Bardulla, Nafie Cani, Mukades Muça, Flora Asllani, Shemsi Qoku, Rami Hoxha, Ilir Disha etj.

Në shkurt të vitit 1989 shkolla e mesme e përgjithshme u nda nga Shkolla e mesme profesionale. Detyrën e drejtorit për profesionalen e mori Sadik Damsi, ndërsa në të mesmen e përgjithshme u caktua Agim Fejza. Pranë shkollës së minierave u regjistrua një klasë në degën elektrike, e cila u mbyll më 1998. Në vitin 1992 drejtor i shkollës së Minierave ishte Myrteza Kadria; 1995-1996 Zija Ndruka, më 1996-97 për degën Elektrike përgjegjës Afrim Biçi dhe 97-98 Ferit Lala. Këtu mbyllet cikli i shkollës së Mesme Profesionale në Bulqizë, duke mbushur plot 31 vjet.

Gjatë viteve 1967-1998 nga shkolla Profesionale e Bulqizës kanë mbaruar pa shkëputje nga puna në degën Miniera 476 teknikë, gjeologë 64, elektromekanikë 34, agronomë 61. Me shkëputje nga puna bilanci më i suksesshëm kështu në degën Miniera 533, shpim 318, degën elektrike 62. Nga shkolla e Bulqizës kanë mbaruar fakultetin e Minierave e të Gjeologjisë 90 inxhinierë; u zgjodhën 2 deputet të Kuvendit Popullor Dilaver Deda e Kujtim Gjoka. Shkolla ka patur një ansambël artistik i dalluar në shkallë rrethi me këngëtarë e instrumentistë të njohur si Lulzime Gjoka, Hide Jangulli, Jeta Mazari, Dëfrim Mandri, Fllanxa Qupi, Azem Teta,Myrteza Gjoka, Selim M Aliu, Fatime Gurra, etj, disa ekipe sportive, pjesëmarrës në spartakiada lokale dhe kombëtare.

Në vitin 1987, 82% e brigadierëve, normistëve, përgjegjësve të sektorëve, ndërtim Miniere, Gjeologji, 95% e punëtorëve të fabrikës së Pasurimit, kishin kaluar nga bangat e shkollës së mesme profesionale (Osman Miha, Kujtime në doreshkrim, 1989). Teknikët dhe inxhinierët që dolën nga kjo shkollë përbëjnë armatën e punonjësve të kualifikuar në minierën e Kromit "Todo Manço". Në çdo sektor, nivel, galeri e pus, gjen mundin djersën, rregullin, disiplinën, kulturën e punës të nxënësve që dolën nga kjo shkollë. Ata vazhdojnë t'i japin frymëmarrje Minierës edhe në ditët e sotme. Pas viteve '90 shumë nga ish nxënësit u bënë biznesmenë,ndër ta Bukurosh Koçi, Latif Miha, Luan Manjani, Eduart Keta etj.

Në shkollën profesionale të Bulqizës kanë dhënë mësim 160 mësues, Një pjesë e tyre kanë kontribuar gjatë gjithë karrierës, si Jonuz Muça, Emir Gjapi, Sejfulla Kata, Nafie Jella, Medin Karaj etj., mësuesit specialist inxhinierët Oman Miho, Jorgo Kola, Mustafa Sadiku, Asllan Pata, Hamdi Haka, Zaim Trupja, pa haruar inxh.Zija Ndruaj që e shoqëoi shkollën e Minierave për 32 vite. Në historikun e shkollës kanë zënë vend shumë mësues vendas dhe të ardhur që me punë e sakrifica kanë mbresa e kujtime të pashlyeshme. Ata u bënë pjesë e gëzimeve të qytetarëve e minatorëve dhe morën me vete respektin shoqëror, miqësinë që do të vazhdoj për shumë kohë.

Mbyllja e shkollës së Minierave për 20 vjet do të krijonte një boshllëk që nuk do të jetë e lehtë për ta rikuperuar. Kaluan afër dy breza, maturanti i vitit 1973, në vitin 2010 mbushi moshën 55 vjeç. Në vitin 2020, më shumë se gjysma e teknikëve të Minierës, dalin në pension. Kush do t'i zëvendësojë ata?Në vitin 2014-15 u hap përsëri shkolla e Minierave, që padyshim është një vendim me rëndësi, që kërkon shumë përpjekje për të fituar kohën e humbur .Dikasteri që mbulon shkollat profesionale duhet të japë shumë ndihmë, përkrahje e mbështetje në këtë shkollë. Mbështetje gjithashtu duhet të japin bizneset në fushën e kromit. Është në interes të tyre ta ndjekin nga afër shkollën, të sponsorizojnë veprimtaritë e saj, praktikat mësimore, pajisjen me bazë materiale për zhvillimin e mësimit sa më normal. Për t'i zgjatur jetën bizneseve të kromit, atyre u duhet që herë pas here të zgjedhin e të marrin në punë punonjës të kualifikuar, inxhinierë e specialist të aftë. Burimi kryesor është shkolla e Minierave. Do të ishte me shumë interes që në vitin e parë të shkollës, ata të kontaktonin me prindërit, nxënësit, t'i ndiqnin gjatë zhvillimit të mësimit, praktikave, kualifikimet, deri në moshën e punës. Kjo do të rriste më shumë interesin e qytetarëve për të vazhduar shkollën e mesme të Minierave.

Aktualisht në shkollën e mesme të Minierave vazhdojnë 114 nxënës, të ndarë sipas klasave: klasa 10 ,18 nxënës, klasa 11 , 38 nxënës, klasa 12 , 23 nxënës dhe klasa e 13 ka 35. Aty punojnë inxhinierët specialist Naxhi Plaku, Leonard Kazanxhiu, Nexhmedin Marku dhe Luljeta Dervishi. Zyra arsimore e Bulqizës, (siç na tha Kujtim Kërkuti, inspektor) ka dhënë një ndihmë të veçantë e të specializuar për hartimin e planeve e programeve mësimore. Drejtoresha e shkollës mesme të Përgjithshme, Fllanza Skarra (sot shkollat janë bashkë), është optimiste për mësuesit e degës Minerare, pasi janë të motivuar, punojnë për të realizuar objektivat që shtrohen sot para shoqërisë për shkollat profesionale.

Urojmë suksese bashkë me 50 vjetorin e shkollës!

Zabit Lleshi

Ish zv.drejtor i shkollës Minierave(1974-78)

ritakim

Në takim nuk u la pa përmendur edhe ngjarja e vitit 2018, për të kujtuar 70 vjetorin e shkollës pedagogjike Peshkopi.

Një takim mbresëlënës

Nga **Besnik LAMI**

Me 17 tetor 2017 në qytetin e Peshkopisë u takuam ne ish maturantët e shkollës pedagogjike ''8 Nëntori'' të Peshkopisë, klasa e IVa, për të përkujtuar 50 vjetorin e marrjes së maturës pas së cilës filluam punën në detyrën fisnike të mësuesisë në Dibër e rrethe të tjera të zonës verilindore nga ku kishin ardhur. Ishte një nga klasat e dalluara të shkollës, klasa më me shumë vajza, me mësuese kujdestare të paharruarën Nevres Manjani.

Në takim morën pjesë dy mësuesit tanë; Shemsi Manjani dhe Sabri Vraniçi, tashmë të moshuar, 84 e 80 vjeçarë. Mësues Sabriu kishte ardhur së bashku me bashkëshorten, Kujtimen, ish nxënëse e pedagogjikes. Me bashkëshoshortet kishin ardhur edhe iniciatori i këtij takimi, Ilmi Cani, Liman Lasku, Haziz dhe Natasha Ballabani, dy të fundit të dashuruar që kur ishin nxënës në klasën tonë, të cilët krijuan më vonë një familje dinjitoze me shumë kontribute në rrethin e Matit.

Sipas programit grumbullimi fillestar do të bëhej në orën 10 para hyrjes të ish shkollës pedagogjike, shkollës ku u përgatitën qindra mësues për Dibrën e zonën verilindore. Ndërtesa e shkollës, e vendosur në mesin e bulevardit kryesor, me bliret përballë i jep një pamje të bukur asaj zone dhe gjithë qytetit. Pak para orës së caktuar filluan të afroheshin një e nga një për t'u ballafaquar me njëri-tjetrin duke u përqafuar e puthur me mall pas 50 vitesh. Për mësuesit prezentë, për njohjen e nxënësve të tyre u bë i nevojshëm pa ndërprerje prezantimi. Momente emocionale! Pranë nesh në këto çaste ishin grumbulluar disa qytetarë që ishin duke lëvizur në bulevard. Ata pyesnin për këto takime të përzemërta, të papara ndonjëherë aty në bulevard, pranë hyrjes së shkollës, për të mësuar arsyen e këtij takimi.

Pas disa minutave, të udhëhequr nga shokët e komisionit organizator të takimit, Hilmi Cani, Natasha Ballabani, Gjuri Puci e B.Lami u futëm në shkollë duke u ngjitur në katin e dytë, ku ndodhet ish klasa jonë e maturës së 50 viteve më parë. U ngjitem duke hedhur sytë sa majtas-djathtas me mall e nostalgji në ato korridore plot dritë, me dritare të mëdha si ato të klasave nga ku vështron oborrin e shkollës me hapësira të gjera, dikur me fusha sportive ku ne luanim çdo ditë. Takimin e hapi shoku Hilmi, me një përshëndetje të shkurtër, duke falenderuar pjesëmarrësit për ardhjen në këtë takim. Pas kësaj, me propozim të tij u mbajt një minutë heshtje për mësuesit e shokët tanë të ndarë nga jeta gjatë këtyre 50 viteve të kaluara, si ish mësuesit tanë, Mufit Trepca, Nevres Manjani, Zenel Sula, Fadil Kaca, Bajram Mata etj., dhe për disa ish nxënës të ndarë nga kjo jetë. Që këtu nisën përshëndetjet e kujtimet e shokëve për të vazhduar gjatë tërë ditës. Fillimisht fjalën e mori mësues Shemsiu, ndër mësuesit më me shumë vite punë në pedagogjike, së bashku me bashkëshorten, por dhe drejtor shkolle e shef i seksionit të arsimit e të kulturës për 9 vjet në Dibër, i cili na njihte mirë ne si nxënës e arsimtarë të rinj në punë. Ai e nisi fjalën duke na përshëndetur të gjithëve, pastaj përgëzoi Hilmiun si organizator i këtij takimi, duke vënë në dukje dhe kontributin e tij në arsim si mësues e drejtor shkolle i suksesshëm për disa vite i pedagogjikes, kur ajo u rihap në vitet 2000. Kujtoi këtu dhe dy të ardhurit nga Burreli, Natasha dhe Haziz Ballabani, dy ish nxënësit e klasës me konsiderata të veçanta nga bashkëshortja e tij, mësuese Nevrezi. Prof. Shemsiu shprehu opinione shumë pozitive për kolegun e tij, Sabri Vraniçi, që punoi për disa vite në dy shkollat e mesme të qytetit, shkollën pedagogjike dhe shkollën e mesme bujqësore. Prof.Shema nuk harroi të sillte dhe përshëndetjen e ish mësuesit më të moshuar, Osman Turja, që jeton akoma, në pamundësi

Klasa IVa, 1967. Vajzat me mësuese Nevresin në mes.

për të ardhur në këtë takim. U larguam nga shkolla ku ishim me nostalgji se ajo është nga shkollat më madhështore të Republikës, e ndërtuar në vitet '48, si nga struktura e ndërtimit, ashtu dhe nga infrastruktura që ajo mbart. Pas mbylljes së shkollës pedagogjike kjo ndërtesë e bukur katërkatëshe u shndërrua në gjimnazin e qytetit, që mban emrin 'Said Najdeni". Kjo ndërtesë e bukur e qytetit shërbeu si Universiteti i Peshkopisë deri para dy-tre vjetësh, kur ky filial u mbyll. U larguam me keqardhje nga ish shkolla jonë e bukur, pasi atje ishin hequr stolat dhe tavolinat e nxënësve, ishte boshatisur nga orenditë shkollore dhe ishte planifikuar nga bashkia të kthehej në zyra bashkiake. Ky vendim i organeve vendimmarrëse është një vendim absurd, i kundërshtuar dhe i protestuar nga qytetarët, nxënësit, ish nxënësit dhe mësuesit e kësaj shkolle. Keqardhje ndjemë edhe kur dolëm grup nga shkolla për të shëtitur në bulevard, sepse godina e shkollës është rrethuar nga disa lokale dhe hotele private që ia marrin frymën shkollës. Këto lokale dhe hotele private kanë pushtuar të gjithë lulishten më të bukur të qytetit, që ndodhej përkrah shkollës pedagogjike para ish shtëpisë së kulturës, Peshkopi. Për shumë pjesëmarrës të takimit ishte e gabuar edhe ngritja e shkallëve të betonuara që lidh bulevardin 'Elez Isufi' me bulevardin 'Nazmi Rushiti' të qytetit. Një xhiro në grup gjatë bulevardit kryesor të qytetit. Takime të përzemërta e çmalluese me shumë shokë të njohur. Disa fotografi të bukura para Prefekturës si kujtim i paharruar i këtij takimi.

Rreth orës 12.00 iu afruam ndërtesës ku do të drekonim, në një sallë të bukur e komode, ku gëzimi e hareja arritën kulmin. Ishin prezentë në këtë sallë edhe DJ e kameramanë. Për gjithçka komisioni kishte marrë masat përgatitore dhe takimi e dreka shkuan shumë bukur, si në një skenar filmi. Pasi shokët pjesëmarrës u ulën nëpër tavolina, filloi trokitja e gotave, përshëndetjet për njeri-tjetrin dhe profesorët tanë prezentë, kujtimet për ato vite të bukura të rinisë dhe për shkollën tonë pedagogjike. Pas përshëndetjeve të para filluan në tingujt e muzikës popullore dibrane vallet e hareshme që rritën atmosferën e këtij takimi mbresëlënës. I pari që hapi përshëndetjet ishte prof.Shemsiu, pastaj përshëndetën prof. Sabriun, ish nxënësit e kësaj shkolle si: Liman Lasku, Haziz Ballabni, Nevrus Kuka, Vjollca Kaca etj. Ish nxënësit Rasim Shehu e B.Lami përshëndetën këtë takim të bukur me nga një poezi. Ndërkohë muzika dhe vallja popullore vazhdonin pa pushim.

Me aktive ndër shoqet u paraqit në valle e përshëndetje Natasha Ballabani, ish shoqja jonë e klasës, e cila dhe atëherë ishte e dalluar në mësime dhe diskutime me shokët e shoqet e klasës. Gjatë takimit u kujtuan nga pjesëmarrësit dhe ish mësuesit e nxënësit e kësaj shkolle të ndarë nga jeta nëpërmjet shumë episodeve të përjetuara. Në takim përshëndeti dhe shoku ynë Avni Dino, i cili shërbeu shumë pak kohë si mësues e pastaj

Pas 50 viteve, ish-klasa IVa. 17 tetor 2017.

Takimi përfundoi me mall e përqafime me njëri-tjetrin, për t'u takuar sërish pas një viti në përvjetorin e shkollës tonë të paharruar që na edukoi, na rriti, na bëri kuadro, komisarë të dritës në Dibër e gjithë Shqiperinë.

u dërgua nga shteti për të bërë akademinë ushtarake, për t'u bërë oficer. Shoku ynë Avni Dino shërbeu për shumë vite me radhë si oficer në Vlorë e Sazan. Me duartrokitje u prit dhe përshëndetja e mësues Sabriut dhe bashkëshortes së tij, Kujtimes.

Në qendër të përshëndetjeve dhe kujtimeve për mësuesit ishte mësuesja kujdestare Nevresi, mësuesja e pasionuar e gjeografisë, që ishte për ne si nënë e dyte, por për keqardhje u nda nga kjo jetë që në 1993, në moshën 54 vjeçare, nga një sëmundje e rëndë dhe e pashërueshme.

Nga fundi i drekës, shoku Hilmi Cani i dorëzoi prof.Shemsiut, bashkëshortit të Nevresit, në emër të të gjithë maturantëve të vitit 1967 një "Mesazh mirënjohjeje" për mesuese Nevresin, si kujtim e përshëndetje për këtë mësuese të mrekullueshme e të paharruar, të pergatitur nga komisioni i këtij takimi. Në fund mesazhi mirënjohës mbyllej me fjalët: "E paharruar do të mbetesh për ne përgjithmonë mesuese Nevresi'.

Prof.Shemsiu, pasi mori mesazhin, falenderoi të gjithë pjesëmarrësit për konsideratat e shprehura për mësuese Nevresin në këtë mesazh dhe gjatë gjithë drekës. Pas vdekjes mësuese Nevresi ishte nga të parat mësuese që u shpall nga bashkia e Peshkopisë 'Qytetare Nderi'e Peshkopisë në vitin 2005. Perveç këtij titulli mësuese Nevresi ka marrë edhe shumë dekorata e medalje pune gjatë karrierës së saj si mësuese nga institucione shtetërore dhe arsimore. Gjatë kujtimeve e valleve të shumta u ngrit shëndet edhe për grupin e vajzave pjesëmarrëse si p.sh., Vjollca Pitarka, ish shoqja jonë e shkollës dhe bashkëshortja e ish mësuesit Fadil Kaca.

Në takim nuk u la pa përmendur edhe ngjarja e vitit 2018, për të kujtuar 70 vjetorin e shkollës pedagogjike Peshkopi, e mirëpritur dhe e vlerësuar që tani. 70 vjetori i kësaj shkolle që i dha dritë e dituri jo vetëm Dibresë, por edhe zonës verilindore të Shqipërisë, do të jetë një eveniment i rëndësishëm kulturor për qytetin e Dibrës në vitin 2018. Kjo shkollë u hap në Peshkopi në vitin 1948, në një kohë ku afro 90% e popullsisë së këtyre zonave ishin analfabetë. Mendimi i përgjithshëm është për ta kujtuar këtë përvjetor, duke e konsideruar si një nga festat më të mëdha pas çlirimit. Detyra të shumta na presin ne pedagogjikaseve të të gjitha viteve për të sensibilizuar të gjithë opinionin arsimdashës, atë shtetëror dhe shtypin lokal e qendror, organet e pushtetit lokal të qarkut e deri në ministri për të marrë me kohë masa për të festuar me madhështi përkujtimin e këtij përvjetori që do të zhvillohet në Peshkopi në shtator të 2018.

Takimi përfundoi me mall e përqafime me njëri-tjetrin, për t'u takuar sërish pas një viti në përvjetorin e shkollës tonë të paharruar që na edukoi, na rriti, na bëri kuadro, komisarë të dritës në Dibër e gjithë Shqiperinë.

Rruga e Arbërit nr. 138 .139.

sport

FERIT KETA

Fitore e madhe në Mynih, mes mijëra shqiptarëve, duke valëvitur flamurin tonë kombëtar në një shtet me 80 milionë banorë. Vëllezërit Keta, modeli për t'u ndjekur nga të rinjtë dhe ata që duan të bëhen dikush në jetë.

Nga Mynihu **Defrim METHASANI**

Udhëtimi ynë drejt Mynihut kësaj here kishte një emocion që kishte nisur që në prag të udhëtimit. Ftesës së kampionit të madh të botës dhe trajnerit po të tillë, Ismail Keta, i jemi përgjigjur po me atë dëshirë dhe ndjenjë që kishte dhe vetë kampioni, për të pasur krah në atë mbrëmje edhe bashkëkombësit dhe miqtë e tij. Së bashku me zotin Musa Riçku, botues i gazetës "Rruga e Arbërit", por edhe dy profesorët e nderuar Petrit Bara dhe Mehmet Spahiu, fluturuam nga Tirana drejt Mynihut, duke biseduar pikërisht për ndeshjen, nëse Ferit Keta do ta bënte për vete atë trofe, që nuk ishte i vogël, për Gjermaninë e madhe. Që në aeroportin e Mynihut, djemtë shqiptarë që na pritën, Valoni, Festimi dhe Eni, na treguan se Feriti ishte kthyer në "bishë" tashmë e jo thjesht në njeri. Mikpritja e Ismailit në shkollën e tij sportive, ishte një tjetër tregues, që më shumë se boksier dhe sportist kampion, këta janë njerëz të tillë, që atdheun dhe traditën dibrane dhe shqiptare e kanë kthyer në rit. Mbrëmja kaloi si pakuptuar dhe darka në një lokal shqiptarësh nga Kosova po ashtu, ku u fol vetëm për ndeshjen e së shtunës që Feriti kishte përballë gjermanit Toni Thes. Gjumë pak fjetën, sepse edhe neve na kishin pushtuar emocionet e mëdha dhe kishim nisur të përjetonim ringun dhe fatin e djalit tonë, Ferit Keta, një boksier që nuk njihte asnjë humbje në tetë ndeshjet e zhvilluara në boks. Ismaili na tregoi se pikërisht pak ditë më parë, Feriti kishte pësuar një dëmtim dhe një e çarë në ballë sikur ia kishte nxitur pak ankthin dhe pasigurinë, por besonte që do t'ia dilte vëllai i vogël i tij, Feriti. E nesërmja erdhi dhe mbrëmja na dukej gjatë. Në rrugët e Mynihut takojmë edhe dibranë, bulqizakë dhe shqiptarë të ardhur. Mes tyre dallojmë deputetin Përparim Spahiu bashkë me familjen e tij, por edhe biznesmenin e suksesshëm Latif Miha, djalin e tij Andin, por edhe mjaft të tjerë. Orët e ankthit tashmë kishin nisur dhe vizita e parë ishte tek arena ku do të zhvillohej ndeshja. Krahas gjermanëve, aty gjejmë edhe mjaft shqiptarë të interesuar për eventin, si fotoreporteri Fehmi Lleshi, djaloshi dibran që kish ardhur nga Korfuzi Festim Krrashi, Valoni, mik i vëllezërve Keta, Eni Murra i kudondodhur dhe dhjetëra të tjerë.

Një kompani gjermane e specializuar, kishte nisur herët në mëngjes montimin e ringut në një arenë gjigantë në dalje të qytetit, ndërsa makinat e televizioneve po montonin pajisjet e tyre të transmetimit. Kanali prestigjioz DSF dhe stacione të tjera në Gjermani dhe Shqipëri, do të sillnin live këtë mbrëmje të boksit, që kulm të saj kishte duelin e lajmëruar kohë më parë, Ferit Keta - Toni Thes. Një punë marramendëse, që të ngjante me një kantier ndërtimi. Vetëm pak orë më pas, do të niste mbrëmja gala, që fillimisht ka ngjitur në skenë boksierët dhe sportistët e rinj, mes të cilëve edhe dy djem nga Tirana, që stërviten nga Ferit Keta, në shkollën e vëllezërve Keta në kryeqytet. Mikel Alliu, një djalë i talentuar del fitues në kikboks pas një ndeshje spektakolare, ndërsa Roxhers Muslia edhe ky një nga talentet e shkollës Keta, fiton, por gjyqtarët nuk janë në të njëjtin mendim dhe ia japin kundërshtarit. Në sallë përjetojmë emocione të tjera, kur shohim që krah nesh, janë edhe kampioni i Europës dhe njëri prej boksierëve më të famshëm në historinë e këtij sporti, Luan Krasniqi dhe doktori e profesori duar artë i mjekësisë në Gjermani, më i famshmi shqiptar atje, Adnan Kastrati. Ndërkaq që presim me padurim orën 22. Këngëtarja e njohur shqiptare në Gjermani, Alma Hyskja, ndez motorët e fitores, duke kënduar dhe uruar në ring djaloshin shqiptar. Pas pak minutash, salla gumëzhiu. Fillimisht doli në ring kundërshtari i Feritit, 31-vjeçari Toni Thes, dy herë kampion bote në kikboks dhe me një përvojë të madhe në boks. Me një mendjemadhësi dhe eufori të pashoq, ai ngjitet i duartrokitur prej gjermanëve të shumtë në arenë dhe me një trup të mbushur plot tatuazhe. Nofka e tij ishte tigri. Por vetëm pak minuta më pas, nën frymëzimin dhe tingujt e muzikës së filmit Skënderbeu, në ring do të ngjitej luani shqiptar, djali i Bulqizës, Ferit Keta, 27-vjeçari që ishte betuar vetëm për fitore. Raundet nisin dhe epërsia e Feritit nis po ashtu. Edhe pse Feriti është superior, gjyqtari në ring duket disi i njëanshëm, ashtu si kundërshtari, tejet provokues. Madje vjen një moment që gjyqtari jep faull dhe i heq një pikë Feritit. Kjo acaroi njerëzit në sallë, por

THANË PAS NDESHJES

MALTE MÜLLER MICHAELIS, PRESIDENT I FEDERATËS WBC

Vlerësoj punën që vëllezërit Keta bëjnë në Gjermani dhe Shqipëri për boksin. Me Xhoni Ketën kemi një bashkëpunim të shkëlqyer. Sa për ndeshjen, ju e patë edhe vetë që ishte shumë luftarake. Feriti po bëhet dita-ditës një boksier profesionit dhe ky titull është i merituar. është akoma i ri dhe ka kohë për të shtuar titujt dhe sukseset e tij.

ISMAIL KETA, TRAJNER DHE ISH-KAMPION BOTE NË KIKBOKS

Akoma s'e kam marrë veten nga emocionet. Feriti ka boksuar si luan, ka zbatuar përsosmërisht të gjitha porositë dhe detyrat që I kisha dhënë. Kundërshtari përveçse I fortë, ishte edhe tejet provokues, por qetësia e Feritit në ring bëri të mundur që forca e goditjes së tij, të ishte në plan të parë. Falenderoj të gjithë shqiptarët, ata që ishin në sallë dhe ata që e mbështetën përmes rrjeteve sociale Feritin dhe mua në këtë ndeshje historike. Feriti është një boksier shumë I zoti, por ka rrugë të madhe për të bërë. Tashmë kjo fitore hap udhën e një rruge të re, asaj të titujve europianë dhe boterorë.

LUAN KRASNIQI, ISH KAMPION EUROPE NË BOKS

Ekam thënë edhe herë tjetër, që vëllezërit Keta po kthehen në krenari shqiptare këtu në Gjermani. Janë njerëz korrekt dhe profesionist. Fitoren e Feritit e vlerësoj, sepse ishte e merituar dhe luftoi si guximtar në ring. Feriti ka shumë mundësi të ngjitet lart. Ai ka kurajon, forcën dhe qetësinë e duhur për t'u bërë kampion, por mbi të gjitha, punon shumë për të arritur në majë. I përgëzoj vëllezërit Keta.

PËRPARIM SPAHIU, DEPUTET I DIBRËS

Emocion i papërshkruar me një ndeshje vërtet të madhe të Feritit. Na emocionoi të gjithëve me mënyrën se si luftoi në ring dhe se si e fitoi këtë betejë sportive, me gjak. Imazhi i kësaj familjeje kampionësh duhet të jetë në faqet e para të të gjitha mediave. Për fat të keq, sidomos këto kohët e fundit, po ndodh krejt e kundërta. I keqardhur që në kaq vite, asnjëherë nuk mundem që këta kampionë të mëdhenj, t'i kishim pranë nesh, në vendin tonë...

ARTENS HANKU, KONSULL I SHQIPËRISË NË MYNIH

Jam akoma I emocionuar dhe nuk gjej ndoshta fjalën e duhur për të përshkruar mrekullinë që na dhuruan këta djem. Feriti ishte brilant në ring, po ashtu edhe Ismaili si trajner dhe vëlla I madh. Ata kombinuan bukur dhe mundësuan këtë gëzim, këtë titull që na bën krenarë jo vetëm neve shqiptarëve që jetojmë këtu, por gjithë shqiptarëve në botë. E kam thënë dhe e përsëris, që vëllezërit Keta, janë një model për t'u ndjekur nga të gjithë të rinjtë shqiptarë. Falë punës së tyre dhe sjelljes, ata janë kthyer në personazhe shumë pozitiv këtu në Mynih dhe kanë bërë për vete edhe gjermanët. Këtu sonte kishte shumë gjermanë, por që e duartrokitën Feritin dhe Ismailin kur foli në ring. I përgëzoj, vërtet na mrekulluan.

PROF.DR ADNAN KASTRATI

Jam I mrekulluar me këtë që pashë sonte. Ftesës që më bëri Ismaili iu përgjigja me dëshirë, por kurrë s'kisha parë live një ndeshje të tillë. Vërtet ia paska vlejtur. Unë I njoh prej vitesh dhe më vjen mirë që Ismaili me punë ka arritur deri këtu. Të të duan gjermanët, nuk është e lehtë. Por këta djem ia kanë bërë vendin, ndaj edhe respektohen këtu. I uroj sepse na bëjnë krenarë të gjithëve.

PROF.DR PETRIT BARA, SHEF I SHËRBIMIT KARDIOLOGJIK TIRANË

Ishte hera e parë që ndiqja live një mbrëmje të tillë boksi. U bëra tifoz dhe më nisën rrahjet e shpeshta të zemrës edhe pse jam doktor I zemrës. Është krenari të shohësh djem të tillë të zonës tonë të pushtojnë ringun në zemër të Gjermanisë dhe valëvisin flamurin tonë kombëtar. E pabesueshme vërtet, por jam I mahnitur nga misioni I tyre. Ismaili, Gjetani dhe Feriti, janë kthyer në model. Fitorja e Feritit ishte më e bukura që kam parë në sportin e boksit. Tani e tutje do t'i ndjek të gjithë duelet e tyre.

LATIF MIHA, BIZNESMEN

Unë kam qenë edhe herë të tjera në Gjermani për të ndjekur ndeshjet e vëllezërve Keta. Kam provuar emocione të rralla që kur Ismaili doli kampion bote në kikboks. Kam shijuar më së miri, titullin e Gjetanit si kampion Europe në boks. Kjo ishte e treta e vërteta. Dinastia Keta ka tashmë një tjetër kampion të madh, Feritin. Ai luftoi si përbindësh në ring dhe tregoi se është I fortë si kromi i Bulqizës. Për këta djem ia vlen të udhëtosh dhe sakrifikosh, sepse ta zbardhin faqen vërtet.

ALLIU DHE MUSLIA, DY BOKSIERË TË SUKSESSHËM TË SHKOLLËS KETA

Në ring atë mbrëmje në Mynih, janë ngjitur edhe dy djem të talentuar të shkollës Keta në Tiranë, dy boksierë, që lanë gjurmë me ndeshjet e tyre luftarake në ring dhe me dinjitet treguan vlerat më të mira të boksimit. Njëri ishte Mikel

cyan magenta yellow black

I gjithë ringu është për shqiptarët që valëvisin flamurin kuq e zi, por edhe atë gjerman, sepse Feriti konkurron për atë shtet, por si shqiptar. Mrekullia ndodhi. Muzika dhe fotografitë e festa, janë kuq e zi. Mbrëmja duket sikur nuk ka fund, ndërsa botuesi i gazetës "Rruga e Arbërit", zoti Musa Riçku, kërkon që gazeta të shtyhet për botim, sepse nuk do të kishte kuptim pa këtë shkrim dhe lajm fantastik.

DIBRANI KAMPION I GJERMANISË NË BOKS

jo protagonistin në ring, që duket mjaft i qetë dhe i saktë. Menaxhimi i dy raundeve të para, është mjaft i mirë prej Feritit, që ka një siguri absolute dhe goditje të forta e të sakta. Edhe kundërshtari është kurajoz dhe godet, por Feriti mbrohet mirë, sidomos në pjesën ballore ku ka të mbartur plagën e tij të dëmtimit. Në raundin e tretë, ai e dëmton sërish Feritin në një goditje jashtë rregullores dhe tashmë i imponuar edhe nga kundërshtia e publikut, gjyqtari jep faull për gjermanin. Feriti nuk din të ndalet, por të bëjë vetëm përpara edhe pse gjaku në vetulla ka nisur t'i rrjedh. Veçmas në raundin e tretë, forca e goditjeve të tij është e ashpër dhe nuk toleron. Kundërshtari ka shenja hutime dhe disekuilibri. Beteja vazhdon, sepse ai nuk dorëzohet dhe do duhej raundi i katërt, për të ndarë shapin nga sheqeri. Goditjet e tij tashmë janë papushim dhe të pamëshirshme. Në një cep të ringut e ka ndaluar si para pushkatimit dhe e godet dhjetëra herë me forcë. Vjen një moment, që gjermani shtrihet në tapet. Gjyqtari numëron deri më 8 dhe një nokaut i bukur e ka mbyllur ndeshjen. Kaq mjafton, që Ferit Keta, të shpallet kampion Gjermanie në boks në peshën super e mesme dhe t'ia dalë kësaj beteje sportive që i dha shumë krenari atij, vëllezërve Keta, shqiptarëve të pranishëm në sallë dhe gjithë atyre që e ndoqën përmes ekranit. Brezi i artë i fituesit i vendoset në trup nga presidenti i federatës europiane të boksit dhe ikona e boksit Europian, Luan Krasniqi, ndërsa Ismail Keta, ka folur gjermanisht dhe shqip, duke falënderuar Feritin për ndeshjen e guximshme dhe të bukur që bëri dhe të gjithë shqiptarët që e mbështetën. Gjermaninë në gjoks, Shqipërinë në zemër, ka thënë kampioni, sepse Gjermania na krijoi mundësinë për t'u bërë sportist dhe për të treguar vlerat tona, ndërsa Shqipëria është atdheu ynë dhe ndjehemi krenarë prej nga vijmë. Gazetarët kanë nisur intervistat dhe Feriti ka folur gjermanisht dhe shqip, ku shpreh mirënjohjen e tij për këtë mbështetje spektakolare që i dhanë shqiptarët. Tashmë i gjithë ringu është për shqiptarët që valëvisin flamurin kuq e zi, por edhe atë gjerman, sepse Feriti konkurron për atë shtet, por si shqiptar. Mrekullia ndodhi. Muzika dhe fotografitë e festa, janë kuq e zi. Mbrëmja duket sikur nuk ka fund, ndërsa botuesi i gazetës "Rruga e Arbërit", zoti Musa Riçku, kërkon që gazeta të shtyhet për botim, sepse nuk do të kishte kuptim pa këtë shkrim dhe lajm fantastik. Vërtet janë emocione që vështirë t'i gjesh ndokund tjetër. Shumë dibranë dhe bulqizakë, kishin pushtuar tashmë ringun. Mes tyre edhe konsulli i shqiptar në Mynih Artens Hanku, që përgëzon kampionin Keta. Qeleshja në kokë, flamuri dhe përqafimet e pafund të njerëzve i shkojnë shumë djaloshit të guximshëm, që vërtet na bëri krenarë. Tashmë një atmosferë e ndezur kuq e zi ka pushtuar atë arenë boksi. Duket një mbrëmje që flet shqip. Edhe pse ka kaluar ora 24 e mbrëmjes, askush nuk del nga salla…. E pabesueshme, por e vërtetë. Ferit Keta bëri mrekullinë e radhës. Pas titullit kampion Europë në kikboks, në korrik të këtij viti, vjen edhe një shkallë tjetër e lartë, tashmë në boksin profesionist në peshën super të mesme. Ai guxoi dhe fitoi, na nderoi të gjithëve. Më pas një tjetër festë është transferuar në një tjetër lokal shqiptarësh në Mynih… Orët e gjumit kanë qenë të pakta, sepse ora e udhëtimit të kthimit po afrohej. Mëngjesin e bukur të së dielës, u rinisëm andej nga kishim ardhur, drejt Tiranës dhe Shqipërisë, tashmë duke marrë me vete, peshën emocionale të një titulli, të një krenarie dhe historie të re. Ferit Keta, na bëri krenarë në zemër të Mynihut, duke fituar me gjak dhe dinjitet, një titull kampion, të një shteti prej 80 milionë banorësh. Dhe kjo nuk është pak….

Alliu, një sportist cilësor që në kikboks po tregon rritje dhe po ngrihet dita- ditës. Ai fitoi sërish, duke dhënë maksimumin e tij si një boksier me të ardhme. Tjetri është boksieri Roxhers Muslia, një djalë inteligjent, që dhuroi spektakël me ndeshjen e tij edhe pse në promovimin e parë në një publik të huaj. Stili, forca, teknika e lartë, ishin tri elemente që bënë diferencën te ky sportist I ri, por që premton shumë për të ardhmen. Të dy këta sportistë, janë produkt I kësaj shkolle, me trajner kampionin Ferit Keta.

ARDHJA E KAMPIONIT NË RINAS DHE MUNGESA E RESPEKTIT NDAJ TIJ…

Ditën që kampioni i ri i Gjermanisë në boks Ferit Keta arriti në Rinas, një grup i RTSH-së kish dalë ta priste. Askush tjetër. Asnjë zyrtar, asnjë gazetar dhe asnjë përfaqësues shoqate, apo institucioni. A thua që ky njeri kish bërë një turp dhe jo një gjest krenarie për t'u mburrur me të. Në fakt, as vetë Feriti dhe vëllezërit Këta nuk i dëshirojnë pritjet pompoze, sepse ata janë njerëz të thjeshtë, pa bujë dhe pa spaleta. Janë njerëz që nuk kanë ecur me paterica në jetë, por me punë, zemër, gjak dhe dinjitet. Ata kurrë s'kanë parë nga përfitimet, por nga motivi, për t'i dhënë Shqipërisë më të mirën e mundshme.

TRIUMFI I NJË KAMPIONI DHE HESHTJA E PAJUSTIFIKUESHME E MEDIAVE

Suksesi i Ferit Ketës i kalon kufijtë e parashikimit, por në mënyrën se si u përcoll në mediat shqiptare, vërtet vlen shumë për të dëshiruar. Asnjë faqe gazete, asnjë televizion përveç RTSH-së dhe Super Sport, nuk bëri qoftë një rresht në faqe të parë. Nëse Feriti largqoftë do të bënte një veprim të keq, me siguri të gjithë do të nxitonin për ta bërë madje edhe me foto si kryelajm. E pabesueshme por e vërtetë. Vlerat duket se s'kanë vlerë për disa media, ndërsa antivlerat po. Në Gjermani shkruhet për një shqiptar, ndërsa në Shqipëri heshtet për suksesin e madh dhe titullin e një shqiptari. Gjithsesi njerëzit e thjeshtë dhe ata që e duan këtë vend, folën e shkruan në rrjetet sociale. Ferit Keta, ti je kampion dhe krenari, ashtu si Ismaili dhe Gjetani, tre vëllezër, tashmë të kthyer në model për shqiptarët… Kush ka veshë e dëgjon, kush ka sy e shikon, të tjerët do ta marrin vesh më vonë…

PROF.DR. MEHMET SPAHIU, ISH DEKAN NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE

Jo rastësisht këta djem arritën këtë sukses. Unë i kam njohur prej vitesh falë njohjes që krijova përmes gazetarit dhe mikut të përbashkët Dëfrim Methasanit dhe që nga ajo ditë I kam ndjekur rregullisht. Ata falë punës kanë ardhur deri këtu, falë modestisë dhe disiplinës në sport. Ismaili mbaroi edhe studimet në universitetin e sporteve ku unë kam qenë dekan dhe u kthye edhe aty në model për t'u ndjekur nga të gjithë studentët. Sa për ndeshjen, më la pa fjalë. Një kombinim perfekt I forcës me zgjuarsinë. Të dyja këto I dhanë fitoren e shkëlqyer Feritit, një boksier model dhe me shumë të ardhme.

MUSA RIÇKU, BOTUES DHE BIZNESMEN

Është hera e dytë që vij në Mynih për të ndjekur kampionin Ferit Keta me ftesë të vëllait të madh të tij dhe mikut tim Ismail Keta. Kam parë dinjitetin, harmoninë, fisnikërinë dhe thjeshtësinë te këta vëllezër. Edhe në ndeshjen tjetër për kampion Europe, Feriti tregoi maksimumin e tij. Ashtu bëri edhe këtë herë, duke sfiduar kundërshtarin me epërsi dhe nokaut, sepse ndryshe s'do t'ia jepnin fitoren gjyqtarët. Jam me emocione dhe sytë me lot për këtë triumf. Këta djem të bëjnë krenarë, si dibranë dhe si shqiptarë. Kur të kthehen në Tiranë, do të bëjmë një organizim, për të respektuar djersën dhe gjakun e tyre, në shërbim të vlerave kombëtare.

ÇFARË THA FERIT KETA POST NDESHJES

Jam i lumtur që i bëra krenarë të gjithë shqiptarët. Boksova me zemër dhe nuk mendova kurrë të dorëzohesha. Edhe pse u çava në vetull dhe më shkonte gjak, asnjëherë s'e mendova kthimin mbrapsht. Kur shikoja atë publik të zjarrtë që më përkrahte dhe mijëra të tjerë që më ndiqnin nga ekrani, më rritej përgjegjësia për të fituar këtë duel. Kundërshtari ishte shumë egoist dhe provokues, por unë nuk duhej të bija në kthetrat e tij. Në raundin e katërt vendosa që duhet ta rrëzoja nokaut, se ndryshe kuptova që gjyqtaret nuk do ma jepnin mua me pikë fitoren. Atëherë vendosa vetëm të sulmojë deri sa e rrëzova në ring. Këtë fitore e prisja, sepse isha përgatitur prej kohësh më vëllain tim, Ismailin dhe duhet ta ndëroja edhe atë. Ia dolëm më në fund dhe tashmë jam i lehtësuar. Por misioni im vazhdon, sepse kam kaluar një pengesë, por rruga është e gjatë. Kam hyrë në këtë rrugë të fitoj jo vetëm një ndeshje, por shumë beteja dhe shumë tituj. Bashkë me vëllezërit e mi, Ismailin dhe Gjetanin, do t'ia dalim, duke pasur krah si zakonisht publikun shqiptar.

Rruga e Arbërit nr. 138 .139.

botime te reja

Ndryshe nga shumica e profesioneve të tjera të cilat përfitohen përmes edukimit, shkollimit, poezia më shumë konsiderohet si një mision (disa e konsiderojnë hyjnor), se sa një profesion në tregun e madh të punës.

Madje, janë gjithnjë e më të rrallë ata që e sigurojnë jetesën me këtë mjeshtëri. Shkurt, poet lind; nuk bëhesh dot. Poezia e Islam Çengës duket se nuk buron nga leximet, egoja apo mania që ka çdo njeri t'u dukur publikisht; ajo nuk është një poezi e porositur, si është bërë e modës edhe në art. Poezia e tij lind sepse i vjen ora për të lindur, pasi është ngjizur diku a dikur përmes një kontakti direkt, jo përmes të tretëve. Ajo buron nga jeta, jo nga eteri, buron nga dhimbja dhe lind përmes dhimbjes, si dramat që lindin nga humbja, dhimbja, dilemat apo mungesat. Prandaj, poetët e vërtetë janë kaq të rrallë.

Naim Zoto

* * *

Poezi të mrekullueshme, plot mjeshtri, gjetje dhe filozofi. Plot jetë e realizëm. Në çdo varg kam gjetur edhe shpirtin tim. Kjo është mjeshtëria e Islam Çengës, që ka skalitur me shumë kujdes e ka depërtuar në tempullin e shpirtit të njerëzve, që na e jep si dhuratën më të bukur, me shumë klas, elegancë e shumë talent. Veçoj perla të vërteta në këtë libër, që duhet t'ju kthehem herë pas here. Më ka shijuar jashtë mase dhe të them një bravo të madhe dhe një falënderim pa kufi për këtë kolonë të pathyeshme të shpirtit tënd, që është tashmë dhe e imja e do të jetë e të gjithëve pas dritës së botimit.

Ahmet Prençi

* * *

Përmbledhja e fundit, sidomos cikli "Vdekatari", ishte, për mendimin tim, një kulminacion artistik i gjithë krijimtarisë tënde të deritanishme poetike. E thashë edhe më lartë, që njeriu mund të shkruajë gjithë jetën, por ndodh që krijon vetëm një herë. Sidomos ata që janë me fat! Por, jo vetëm me fat. Sa shumë poetë janë harruar, pavarësisht maleve me metafora, rima e figura stilistike që kanë krijuar! Dhe pse? Sepse nuk kanë krijuar dot rrugën që na shpie tek mendimi, shtegun që na duhet për të shkuar tek mesazhi…

Ti, miku im, këtë herë ke shkruar me gjakun tënd! Në çdo varg, në çdo figurë, metaforë, nëpër shtigjet e strofave, mbi çatitë e tyre, kudo nëpër këtë ishull të bukur që ke krijuar, gjendet shpirti yt, qeliza e fundit, shtrydhur gjer në palcë.

Arben Çejku

* * *

Poezia e Islam Çengës është sa e vërtetë, tokësore, me rrënjë të ngulura thellë në vendlindjen e tij, aq edhe fluturake e qiellore! Herë-herë ajo vjen krejt e prekshme, duke risjellë me një frymë nostalgjie përjetime fëmijërore, nga vende dhe njerëz, që kanë lënë gjurmë në shpirtin e poetit. Herë të tjera vargjet prekin qiellin, me ndjesi e drithërima shpirtërore, të cilat vijnë në formë ëndërrimesh e dëshirash, që kërkojnë të jetësohen.

Klejda Plangarica



ISLAM ÇENGA
Dy pëllëmbë qiell
Poezi

Redaktor: Naim Zoto
Botimet M&B

ISBN 978-9928-4458-8-9

Faqe: 232

Çmimi: 700 lekë

Poezí

NJERËZIT E QYTETIT TIM

Ata janë njerëzit e qytetit tim,
atij qyteti të mbetur pa lule e pa stola në park,
qytetit që mban në hejbe agun dhe muzgun
siç mban lumi dy brigje
e toka gjethin e trungun.

I ka dyert të hapura pash më pash qyteti im
të hapura janë dritaret kanatë më kanatë
le të jetë janar apo gusht,
le të jetë e hënë apo e shtunë.

Njerëzit e qytetit tim janë paqësorë,
dinë të këndojnë,
të luten,
të shpresojnë,
të qajnë,
të dehen, të dashurojnë apo të luajnë shah,
të të shohin në sy dhe të thonë vëlla…

Dhe fill pas njeriut janë blirët, mështeknat dhe saksitë
janë pëllumbat, guguçet, dallëndyshet, pëllumbat,
sorrat, milingonat e bletët, macet e qentë,
grerëzat, mëllenjat
dhe oxhaqet që shkundin dimrin e sertë
si maramë e zezë djegur nga rrëfenjat.
Dhe udhët që mbyllen
si gështenja në degë shkarpash
me një potere grash
me ofshama plakash!

Por dhe dimri dhe stinët e tjera
si gështenjat në degë
si e kollura tek pleqtë
dhe marama e zezë
me ditët që ikin e ato që vijnë
në qytetin tim
janë pas njeriut…

Kur pragun shkel, qyteti im
më bëhet sy, më bëhet frymë,
fëmijë më bëhet
dhe lojë… dhe gunë.

Dhe nuk më lë të plakem asnjë ditë,
asnjë thinjë të më shtohet në gunë,
le të jetë janar apo gusht,
le të jetë e hënë apo e shtunë.

KARTOLINË NËNËS PËR VITIN E RI

Nënë, për Vitin e Ri nuk mund të vij këtë herë,
Babagjyshi s'më gënjen dot për një det me lumturi;
Më ndaj mënjanë pak qumështor, e mira ime,
Më ruaj pak bakllava, si hoje blete, në një sini.

Në akullin e xhamit kanë ngrirë luledelet,
Mëllenjat trokasin në të ngrohtë të hyjnë;
Dielli krejt përtesë po zbret drejt perëndimit,
Hëna me kosore pret bredhat në një brinjë.

Beko urimin tim në ndërrimin e viteve
Për njerëzit, për udhët, për zogjtë e qytetit tim;
Pa mua këtë herë do të thellohet një rrudhë,
Pa mua, për dreq, të shtohet një thinjë…

Sapo të ikë Babagjyshi do të vij, e shtrenjtë,
Pa ndalur frymën, as fishkëllimën e gjatë.
Bashkë do t'i heqim me dhjetëra rrudha ballit,
Qindra thinja koti, bredhit tënd të bardhë!

Nënë!
Këtë herë nuk mund të vij për Vitin e Ri,
Jam i ngopur gjer në lukth me Babagjyshët…



VDEKATARI

S'përmbyset Bota pa mua Vdekatarin,
e shumta një divan bosh lë në kuzhinë
një lugë, një pjatë, një filxhan kafeje
dhe një gotë të ciflosur për rakinë…

Pastaj kujtime plot, si bari në livadhe,
që mpiksen si kërmijtë në vjeshtë.
Pastaj… e pastaj si lugat i Caralecit,
do të rilind për ty në një vjershë…

***

Tik-tak ora,
tak-tak dera.
Fiu-fiu krah ere si turtuj në violinë,
erdhën për të marrë Vdekatarin
pa libra e stilo, pa dritaret e shtëpinë.

Mos e thyej orën,
mos, gozhda derës!
Si Vdekatar qofsha i fundit,
në udhë me qyqet e erës!

intervistë

Bisedë me shkrimtarin Agron Tufa, mbi letërsinë dhe jo vetëm...

Ka maja, por nuk po ka alpinistë që të ngjiten në këto maja

Ai është fare i pashtirur në të gjitha përgjigjet e tij dhe me një kurajë të spikatur intelektuale për të mos iu spërdredhur së vërtetës.
Thotë se e lëshon librin që shkruan si një shishkë në oqean dhe më pas nuk e ka luksin të mendojë për të, ndërsa sjell një shembull plot humor të trishtë nga përvoja e tij me studentët.

Bisedoi: **Arlinda GUMA**

Kur Sartre fitoi çmimin Nobel, ai e refuzoi, duke i shkruar edhe një letër Akademisë Suedeze, e cila u botua në "Le Figaro", ku shpjegonte arsyet e refuzimit. Një nga ato ishte bindja e tij se shkrimtari duhet të refuzojë të kthehet në një institucion dhe se të gjitha nderet që mund t'i bëhen, të cilat e vënë lexuesin nën presion, nuk ishin të dëshirueshme për të. (Sartre, edhe më parë kishte refuzuar anëtarësinë në Legjionin e Nderit, edhe pse e simpatizonte qeverinë që ishte në fuqi ato kohë.) Si është raporti juaj me çmimet? Shpesh dëgjoj thagma të tilla se si disa shkrimtarë shqiptarë kapin për xhakete njerëz nëpër juri për të marrë çmime. Ç'është kjo dëshirë e sëmurë për t'u konfirmuar me çmime të gënjeshtërta?

A. T: Ju i referoheni letrës së Sartrit, të cilën ai ua lexoi në Paris gazetarëve suedezë me 23 nëntor 1964, ditë kur ai publikisht refuzoi çmimin e Akademisë në Nobelit. Nëse J.P. Sartre nuk do të kishte marrë mundin ta shpjegonte publikisht me letër publike refuzimin e tij, mendoj se ky gjest do të mbetej unikal në historinë e çmimeve letrare, falë edhe një misticizmit që do të sillte mosshpjegimi. Por unë ndaj një mendim tjetër për këtë gjest të Sartrit dhe e klasifikoj atë si një apoteozë të hipokrizisë dhe spekulimit, gjykuar nga ato arsye që parashtron ai. Po e "dekonstruktoj" logjikën e letrës së Sartrit në disa apori logjike ku mbështetet ai. Sartri i ndan në tre kategori arsyet e refuzimit të Nobelit, që sipas tij janë: a) arsye personale, b) arsye objektive, c) liria dhe paratë.

Tek arsyet personale Sartri numëron këto pohime të rëndësishme: – unë gjithmonë i kam refuzuar shenjat zyrtare të dallimit, përfshij Urdhrin e Legjionit të Nderit (por bie në kontradiktë me pranimin e çmimit letrar "Manifesti 121", që iu dha, ajme, më 1945, fill pas luftës së Dytë). Pse s'e refuzoi dhe këtë? Parimi, po u shkel njëherë, nuk quhet më parim. – "shkrimtari që ka zënë një pozicion të caktuar në sferën politike sociale dhe kulturore, duhet të veprojë vetëm me anë të atyre mjeteve, që i përkasin atij, pra me anë të fjalës së shtypur". Përndryshe, ushtron presion mbi lexuesin në sajë të emrit që fiton, ngase nuk është më, thjesht, "J.P. Sartre", por "J.P. Sartre, laureat i çmimit Nobel". Kështu, – thotë Sartri, – simpatitë e mia për partizanët venezuelianë më kanë të bëjnë vetëm me mua. Mirëpo, nëse "J.P Sartre, laureat i çmimit Nobel" del në mbrojtje të rezitencës venezueliane, me këtë gjest ai bashkë me veten e vet përfshin/kompromenton edhe institutin e çmimit Nobel. Së këndejmi, Shkrimtari nuk duhet ta katandisë veten në institut.

Tek "arsye objektive" Sartri shfaqet dhe më i troçtë: – Simpatitë e mia priren pashmangshëm drejt socializmit dhe ndaj të ashtuquajtur blloku lindor, por unë jam rritur dhe edukuar në një familje borgjeze.

– Pa marrë parasysh të gjitha simpatitë e mia për socializmin, në të njëjtën shkallë nuk do të kisha pranuar të marr, për shembull, çmimin Lenin, nëse ndokush do të ma kishte ofruar. (Sigurisht, çmimi "Lenin" ishte nobeli sovjet për shkrimtarët socrealistë në BRSS dhe Satri e dinte mirë, që ky çmim nuk u jepej të huajve. Rrjedhimisht Sartrit i duhej kujtuar e vërteta e idiomës sonë popullore: "Kur s'ke pula, pse bën iishsh?" Duke e paragjykuar Nobelin "të destinuar për shkrimtarët e Perëndimit apo për "rebelët" e Lindjes, Sartri sjell shembuj qortues, se pse nuk ia dhanë Nobelin Nerudës, një prej poetëve të mëdhenj të Amerikës Latine dhe "pse nuk është diskutuar seriozisht kandidatura e Aragonit". Në të dy këto shembuj Sartri paragjykon dhe nxitohet nisur nga pozicione militante dhe klasore (jo s'e nuk ka vend për zhgënjime "drejtësia" e Nobelit). Por mbesim te pozitat e këndvështrimit. Siç dihet, Nobeli u jepet të gjallëve. Edhe Neruda e mori Nobelin në vitin 1971. Sa për Aragonin, përjashto një pjesë të vogël të lirikave të tij të mrekullueshme, veçanërisht në "Sytë e Elsës", ai përgjithësisht, në gjykimin tim, mbetet një poet i një klaviature më të vobegët, krahasuar me arritjet më të mira të poezisë bashkëkohanike me Sartrin, militantizmit të tij si anëtar i Partisë Komuniste franceze. Atëherë i duhej thënë Sartrit, fjala vjen: pse Aragoni e jo Ezra Poundi? Por hutimi më i madh që më shkakton Sartri është pasazhi kur gjykon kështu: Të shkakton keqardhje ai fakt, që çmimi Nobel iu dha Pasternakut (Boris), dhe jo Shollohovit (Mihaill) dhe se e vetmja vepër e merituar e tij (Pasternakut), qenkësh një libër i botuar jashtë kufijve të tokës amtare dhe i ndaluar të botohet në vendin e tij. Është një gafë që nuk e pret nga një personalitet dhe njohës i letërsisë si Sartri. Fjala është për romanin "Doktor Zhivago" të Pasternakut, thelbi i të cilit është satanizmi që solli revolucioni bolshevik i tetorit 1917 në jetën shoqërore të popullit rus, tragjedia intelektuale, vëllavrasja, etj. Ishte libri i parë që përmbyste vulgatën e kuqe e të shenjtë Revolucionit, që deri atëherë qe paraqitur me mitologjema të tilla si Riardhja e Krishtit, e që Pasternaku na kallëzon te ai surratin (me quka) të Satanait. Të thuash që Sartri nuk e ka njohur krijimtarinë poetike dhe novelat e Pasternakut, tashmë 70 vjeçar? Magun e lirikës filozofike e metafizike ruse? Kubofuturistin dhe futuristin e hershëm të avanguardës ruse? E pamundur! Një haset tjetër e ha Sartrin, që pranëve si të barabartë me Pasternakun (e madje me më superioritet) një shkrimtar trivial si M. Shollohovi, apogje i realizmit socialist sovjet (për më tepër, që edhe atij iu dha Nobeli më 1965), dhe, siç gjerësisht u mor vesh, pas vitit 1990, me një vepër të vjedhur ("Tihij Don/ Doni i qetë). Në këtë rast mendoj se me snobizmin borgjez, Sartrin, ka ngjarë një shpërndërrim psikoanalitik e psikoneurotik i njohur me togfjalëshin "neuroza e të konvertuarit", sipas të cilit, ai që konvertohet, thellon deri në absurditet sindromën e të qenit "më qen se qeni" (pa kontekst fyes), sipas paradoksit – antisemitët më të mëdhenj – janë hebrenjtë e konvertuar.

Sartrin e djeg squfuri i antagonizmit klasor në letërsi – kampi komunist i lindjes/ kampi jokomunist i perëndimit. Binar, dikotomi: bardhë e zi.

Më së fundmi, tek arsyet sociale – "Liria dhe paratë", pasi na shpjegon, se shumën e madhe të parave të Nobelit ai nuk mund ta investonte në luftën kundër "aparteidit" (mëkat, se do të kishte qenë më se i mirëkuptuar dhe, sigurisht, më i dobishëm, si shkrimtar politikisht i angazhuar), Sartrin prek thelbin e gjestit të tij, duke e shprehur kështu: "...nuk mund të kërkosh, që për 250 mijë korona unë të heq dorë nga parimet, që janë jo vetëm parimet e mia personale, por dhe të atyre shokëve që i bashkëndajnë me mua".

Shkurt, në këndvështrimin tim, refuzimi i një çmimi klasifikohet si gjest i dobishëm që ngre një pikëpyetje të madhe mbi thelbin e kompromentimit moral të institucionit që e jep, gjithnjë nëse refuzimi i çmimit paraqet reaksionin e refuzuesit për mosrespektimin e "shenjtnisë së shenjtnive" – në këtë rast – shkallën e vlerave letraro-estetike. Por kur refuzimi, si në rastin e Sartit, ka prapavijë të qartë politike, ideologjike e klasore, atëherë gjesti i refuzimit mund të kundrohet vetëm si një kontribut për kauzën që mbronte e përfaqësonte. Ky gjest është paramenduar më parë me efektin që do të shkaktonte: teptisjen e lavdisë! Dhe ashtu ndodhi. Po nuk do flasim këtu për një "sociologji të lavdisë". Sartri ishte komod në këtë gjest: ai nuk kishte nevojë për para. Atëherë, pse nuk shkoi pra Sartri ta kalonte jetën midis vëllazërisë së shkrimtarëve sovjetikë, në BRSS? Në "Mekën" e tij? Kur ia propozuan këtë Bertold Brehtit, sivëlla ideali me Sartrin, ai tha: "Unë jam shkrimtar, nuk jam budalla". Pse nuk e refuzuan Nobelin Alber Kamy apo Andre Malro? I pari edhe shkrimtar ku e ku më elegant se Sartri, i angazhuar, por thellësisht etik e i pakompromentuar me demagogjinë ndaj turmave.

Desha të sqaroj diçka në gjestin e Sartrit, që është e pandarë nga botëkuptimi i tij i angazhuar. Pas famës letrare të novelave, disa dramave dhe romanit "Neveria", në mesin e viteve 1940 duhet të mbajmë parasysh faktin, që Sartri nis t'i falet një altari tjetër (jo më letërsisë) – altarit të komunizmit.

(vijon në faqen 20)

Ka maja, por **nuk po ka alpinistë** që **të ngjiten** në këto maja

(vijon nga faqja 19)

Siç dihet, kjo ideologji ka fare pak të bëjë me lirinë individuale: dizajnimi i vetes zëvendësohet me imponimin e roleve dhe ekzistencën në kornizat e luftës klasore. Në revistën Les Temps Modernes, të themeluar më 1945, Sartri thuajse heq dorë nga çdo nocion i krijuesit të pavarur. Ai propozon, që shkrimtari nuk ka më zgjedhje tjetër, përpos pjesëmarrjes në batalionit politike të bashkëkohësisë. "Shkrimtari jeton në kohën e tij. Çdo fjalë e tij ka jehonë, sikundërse dhe heshtje", – paralajmëron Sartri.

Me tej në bëhemi dëshmitarë të një spektakli të çuditshëm dhe skandaloz: tribuni i lirisë shndërrohet në apologjet të llojeve më të këqija të shtypjes. Tekst kyç i kësaj periudhe shërben eseja "Portreti i një aventuristi", i botuar në cilësinë e parathënies më 1950 në librin për shkrimtarë, të njohur si "njerëz të veprimit", si T.E. Lourens dhe Andre Marlo. Tanimë pikëpamjet e Sartrit anojnë nga të ashtuquajturit "luftëtarë" – komunistët aktivë, anëtarët e Partisë. "Mos e kërkoni egon në veten tuaj – atë jua mundëson partia, – shkruan ai, kështu që, imperativi sartrian për luftëtarin, thotë: të vlerësosh fort shtypjen e individualitetit tënd dhe ta shpërngulësh atë në hapësirën e luftës së klasave. "Ai nuk do të jetë vetmitar, përderisa do ta zbulojë veten te të tjerët. Në qenien e tij nuk duhet të ketë as thellësi, as sekrete". Në finale të këtij himni pafrymësie/pashpirtësie Sartri pa dashje dorëzohet: "Megjithatë shoqëria socialiste, në të ardhmen e të cilës "lourensët" do të jenë të pamundur, do të më shkatërrojë mua me sterilitetin e saj".

Këto kundërthënie ndërmjet kërkesave të revolucionit dhe kërkesave të njeriut të lirë vazhduan t'i mprihnin pikëpamjet politike të Sartrit. Pas hyrjes pushtuese të trupave sovjete në Hungari më 1956 Sartri shkruan artikullin "Fantazma e Stalinit", ku i dënon krimet e Stalinit, por në të njëjtën kohë përpiqet t'i justifikojë ato si të pashmangshme në procesin e lindjes së socializmit ("unë i kam ditur dhe më parë krimet e Stalinit, por nuk kam folur, nga droja se mos dëmtoj kauzën"). Në artikull thuhet troç: "A mund t'ia japim emrin socializëm kësaj monstre të përgjakshme, e cila po ha vetveten? Me sinqeritet po e them, po… Ne jemi të shtrënguar të kemi ose këtë, ose asgjë".

Nga sa parashtrova më sipër, edhe gjesti sartrian i refuzimit nuk duhet marrë i shkëputur nga konteksti i përgjithshëm tendencioz politiko-ideologjik. Është gjest i anturazhit të përgjithshëm të një demagogu fodull, snobi parisien, nihilisti tekanjoz, që e sheh tragjedinë e miliona njerëzve në llagerët e Gulakëve e Kolimave siberiane nga kafenetë e rehatshme të Parisit.

Edhe pa refuzimin e Sartrit gjithkush i njihte dhe i njeh lajthitjet me ose padashje të Nobelit, tendencat, politizimet e maskuara majtas-djathtas, saqë janë bërë e po bëhen qesharake vendimet e Akademisë. Po mjaftohem vetëm me dy lajthitje ekstreme të këtyre 20 viteve të fundit: nobelistët Dario Fo (1997) dhe Bob Dylan (2016). Isha në Nju Jork nëntorin e shkuar dhe, bashkë me një mik, shkrimtar shqiptar, hymë në një librari të madhe në Manhatan. Pas disa kërkimesh miku im, që mbante në duar një botim superluksoz, kryevepër dizajni, më thotë: "Agron, afrohu të shfletojmë pak poetin e sapokurorëzuar të Nobelit". U afrova me kureshtje. Miku im shfletonte fletët e shtrenjta të atij formati të madh si album dhe gjithkund, gjithkund, deri në fund, vetëm… pentagrame! Ç'duhet thënë për Nobelin që lë pa kurorëzuar vigaj të tillë si Tolstoi, Çehovi, Xhojsi, Prusti, Kafka, Kalvino, Borhesi?

Çmimet, të gjitha, edhe Nobeli, nuk janë "gjyqi i fundit për një shkrimtar. Por çmimet, jashtë vlerës së mjerë e të (pa)përfillshme të parasë, kanë një rol të madh, se orientojnë leximin, nëse ai çmimi jepet ndershmërisht. Nga ana tjetër në izolacionin e shumëfishtë të letërsisë shqipe, çmimet janë një shpërblim kuraje për rishtarët, që paralajmërojnë formacione të reja stilistike, estetika të reja, konceptime e diksione origjinale. Në gjithë kaosin tonë letrar izolacionist ku nuk ekzistojnë infrastruktura (drenazhuese) periodikësh, fletoresh letrare e revistash, çmimet janë të vetmet që mund të na bëjnë herëdokur me dije, se çfarë risish ndodh në letrat tona. Por si në çdo gjë tjetër, edhe në gjykimin e vlerave letrare Perëndesha e Drejtësisë, Tetida, që paraqitet në mite me sy të lidhur dhe me pjatat e peshores në balancë, tek ne del vetëm me njërin sy të lidhur. Si piratët… Këshille ndrikullash e tarafe bëjnë ligjin në varësi nga fryn era.

Ç'raport kam unë me çmimet? Me duket se thashë mjaftueshëm. Për 25 vjet ekzistencë në kontekstin e letërsisë shqipe me një bilan prej 6 vëllimesh poetike, 5 romanesh, disa librash të tjerë me miniatura, ese, përkthime, studime, gjithsej 20 libra origjinalë jam fitues i 2 çmimeve. Njëherë për romanin "Fabula rasa" më 2004 dhe njëherë tjetër çmim karriere më 2009. Dy herë kam qenë dhe anëtar jurie (2002; 2011). E kam fjalën për Çmimin Kombëtar që tradicionalisht e ka dhënë Ministria e Kulturës. Nuk po llogaris çmime alternative. Por më shumë (një dyzinë) kam marrë jashtë Shqipërisë, në Konkurse e Festivale ndërkombëtare. Çfarë do të thotë për mua një çmim? Absolutisht asgjë thelbësore. Sigurisht, nëse nga kjo ka ndonjë shpërblim në para, nuk e kam pasë asnjëherë kuazidilemën e Sartrit: e kam shijuar dhe e kam harruar të nesërmen. Shkrimtar nuk të bëjnë as universitetet e as çmimet. Thjesht, çmimi i dhënë me meritë orienton vëmendjen e lexuesit elitar. Nëse shenjohesh njëherë (ndershmërisht), mjafton: je "memorizuar". Këtë duhet të përmbushë çmimi, si borxh i mprehtë moral për të shenjuar ato sivëllezër/simotra, që e kanë lëshuar zërin e tyre dhe presin t'u kthehet jehona. Po të ishte për mua, do ta kufizoja deri në 45 vjeç moshën e atyre shkrimtarëve të shenjuar me çmime. E nëse ti je një zdap i madh, që nuk ke rënë në sy (gjithnjë, nëse ka drejtësi në gjykim dhe jo Tetdidë me njërin sy të lidhur), atëherë vazhdo, kërko sukses tjetër, d.m.th, vazhdo të krijosh lexuesin tënd.

Është krijuar tashmë një komplek parehatie me çmimet, që, nëse ta japin, ndjehesh në një faj, inferior, a thua se ke ngrënë tinëz mollën e fundit të mbijetesës, duke i lënë motrat e vëllezërit pabesish në zgrip të vdekjes. Çmimi është shenjë, shenjë e një shenje tjetër "shenjë e shenjës", sikundër thuhet në semiotikë. Ata që luajnë me çmimet e ngarkojnë shpirtin rëndë në mëkat. Është si të bësh hile e dallavere me mjaltin e bletëve: të zë mallkimi, nuk të ecën. Prandaj shpesh duhen kur shpallet dikush fitues, duhet të marrim në hesap dhe faktin, se përballë kujt fitoi? Prapëseprapë edhe për kaq (kureshtja, se cilët janë të nominuarit jofitues), çmimet e përligjin të drejtën. Po sikur të mos kishte fare-fare? A prishej punë? Në dukje jo: gjithkush që është në varësi totale nga Fjala, si pijetari nga pija, a si narkomani nga substancat, do vazhdojë të shkruajë. Asgjë nuk e ndal. Çmimet duhen më shumë për lexuesin, orientimin e tij, se sa për vlerën nominale të një shkrimtari.

Fakti se pse na e shpif kjo traditë tek ne, ka të bëjë me sindromën psikopatologjike të egove dhe metodave xhambaze të njerëzve të maskuar si shkrimtarë. Ata duhet të jenë kudo, dhe pamjaftueshmërinë e talentit ata janë të bindur se e sublimojnë me vullnet, energji + lëvizje + plus intrigë. Me ndërhyrje. Arrogancë. Mbaj mend kur një sivëlla kainian i penës, çuditërisht me njëfarë pushteti për sytë e tjerëve, më vërtitej gjithkund kafeve javës së fundit të Konkursit ku isha anëtar jurie. Vazhdimisht gjente rastin të ma thoshte si me çapkënllëk, midis të tjerësh, në tavolinë: "Ej, shoku, kij mendjen… ki kujdes… kam librin unë aty!". Për të satën herë kështu, se ia kishin mbushur mendjen e mbase i kishin dhënë dhe shpresa, derisa m'u shpif e ia ktheva me gisht në fytyrë: "Jo unë, po ti, ti të kesh kujdes! Dhe shumë biles! Se jo unë, por je ti që ke librin aty, dhe jo të kesh kujdes, por të dridhesh e të përpëlitesh".

– *Ju jeni duke përgatitur një kolanë botimesh mbi krimet e diktaturës. Besoni se do arrini ta kryeni këtë mision përpara se të ndodhë ndonjë hata si ajo me Ministrinë e Integrimit që pushoi së ekzistuari? Mendoni se shoqëria shqiptare nuk ka ndjenjë empatie ndaj njerëzve që kanë vuajtur nëpër burgjet e diktaturës? A kanë qenë vërtet empatike qeveritë me ish-të përndjekurit politikë, apo empatia është thjesht një maskë që ata e vendosin në fytyrë, vetëm atëherë kur u duhet të impresionojnë ndonjë ndërkombëtar?*

A.T: Me botimet e fundit që po finalizon këto ditë Instituti i Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit (ISKK), të cilin e drejtoj prej 5-6

vitesh, bëhen 70 tituj monografish studimore, librash memuaristikë, albumesh, vëllimesh me biseda e dëshmi të të mbijetuarve nga burgjet dhe kampet e internimit, akte gjyqësore politike etj. Librat afrohen si dhuratë për bibliotekat publike të qyteteve dhe universiteteve, për studiues e studentë të interesuar që punojnë me temën e krimeve të komunizmit. A jam i sigurtë se do të vazhdojë ky institut? Aspak. Si për çdo gjë tjetër që në vendin tonë nuk krijon dot vijimësi… Projektet shtetërore rilindase, që në fillim, të afishuara madje në Platformë, kanë qenë për "fshirjen", zhdukjen, "transformimin" e tij. Por këto gjëra bëhen në një stil perfid, duke u paraprirë në një terren e një klimë jozyrtare, acaruese në ambiente të ndryshme ("akoma e keni lënë atë qelbësirë atje?!"; "Ju lumtë! E dini ç'bën ai? Nxjerr në ato libra, se si baballarët e gjyshërit tanë kanë qenë kriminelë! Ju lumtë! Lëreni… !"). E kur këto i dëgjon të regjistruar live, me zë e figurë nga kafja e kuvendit, më thoni, si do të ndjeheshit? Unë për vete krenohem: puna jonë paska se kë shqetëson…

Shoqëria shqiptare duhet informuar, së pari, që të ndjejë empati për fatet tragjike të çerekut të popullatës së saj, të prekur drejtpërdrejt në diktaturë. Një kujtesë e tillë kolektive funksionon ende si apokrif, e papërfshirë në memorien tonë institucionale dhe edukative, për më tepër ajo relativizohet, minimizohet, deligjitimohet, degdiset në margjinë e më në fund, sulmohet e denigrohet. Nuk po humbas kohë të flas për sjelljen dhe qasjen politike e shtetërore: hipokrizia e ka konsumuar veten, është mpiksur tashmë. Politika e ka parë dhe ende e sheh ende si një basen ideal votash këtë shtresë të madhe e të traumatizuar. Pasi ia merr votat, nuk e përfaqëson në asnjë instancë pushteti e qeverisjeje. Cinizëm. Ligësi. Mungesë katastrofike bashkëpërvujtnie.

Kjo shtrese e të deklasuarve ka kohë që përdoret për agjendat turistike ndërkombëtare në cilësinë e adrenalinës, duke servirur e afishuar horroristikën surreale të fateve të tyre. E mbani mend vizitën e Papë Françeskut? Bulevardi kryesor qe mbushur me portretet e martirëve, kryesisht të besimit katolik. Të nesërmen i hoqën portretet e varura të martirëve dhe i degdisën në një depo. Kaq ishte… Po të pyesësh, për shembull, çfarë ka bërë shteti e qeveritë për ta e familjet e tyre, për të drejtat dhe rehabilitimin e tyre (rehabilitimin e imazhit të tyre në shoqëri), s'ke pse kërkon përgjigje: asgjë s'është bërë! Përkundrazi qeveritë postkomuniste kanë inkurajuar me sa kanë mundur vrasësit e tyre të bëjnë një karrierë marramendëse në piramidën shtetërore, çka përbën edhe fyerjen më të madhe për ta. Kjo shtresë edhe sot mbetet ashtu siç ka qenë: e de-klasuar.

-Ju keni studiuar dhe më pas punuar si profesor në Moskë. Ç'ju bëri të ktheheshit në Shqipëri? Nuk ishte dhe aq poetike, e sfungjertë, idilike, siç përshkruhet rëndom në letërsi, dëbora e Moskës? Po vajzat e saj? Miti i tyre u ezaurua prej shkrimtarëve të tjerë? Mendoni se vajzat ruse rrinë më mirë si personazhe nëpër faqe romanesh, se sa si krijesa të së përditshmes?

A.T: Në Shqipëri më bëri të kthehem, siç më dukej mua atëherë, mungesa e kuptimit. Isha profesor i gjuhës dhe letërsisë shqipe prej 6 vitesh në katedren e Europës Juglindore në Institutin e Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Moskës, me një traditë dyshekullore dhe prestigj të madh. Dhe rrogë të mirë. Por asokohe mendoja se energjitë e dijet e fituara duhet t'ia kushtoj atdheut tim, se ndoshta do të jem i dobishëm në vendin tim. A mendoj ende kështu? Me gjithë mërzinë e majme që na afron përditshmëria jonë, them se kam vepruar drejt. Gjithmonë ka një zë fati që të therret dhe ti e ndjek… nuk i shmangesh dot. E prapë, nuk është atdheu që na mërzit. Madje nuk duhet rënë në kurth, që kafshët politike të na e shpifin atdheun. Mitrush Kuteli u drejtohet fëmijëve në letrën e tij të lamtumirës: "Duajeni Shqipërinë, edhe kur ajo ju shkakton dhimbje të mëdha". Kjo e vërtetë na bën të gjithëve fëmijë të kësaj porosie të Kutelit.

Sigurisht, periudha ime moskovite ka qenë një kohë e pahalle, si i thonë "ku rafsha, mos u vrafsha". Dhe e kam shijuar të plotë e të pacënuar,

intervistë



Letërsia jonë vuan shumë si sistem funksionimi.

Letërsia shqipe ka nevojë për një pritje bujare, mirëseardhje dhe sidomos komunikim mesvedi me lexuesin. Ka nevojë për një atmosferë më miqësore, njohje e pranim të ndërsjelltë vlerash, kushtim vemendjeje. Ka nevojë për një klimë tonën, familjare, të vatrës. Por, ajme!As shkrimtarët nuk e njohin-njëri-tjetrin... dhe rritet kështu paragjykimi, fodullëku, fobia.

me fanatizmat dhe pasionet e mia të leximeve, udhëtimeve, pjesëmarrjes në klube e grupime letrare. Sa për borën e rregullt gjashtëmujore, jashtë aspektit romantik, ndjehesha shumë i familjarizuar. Bora ka qenë gjithmonë stihia ime. Jam njeriu i borës. I lindur e i rritur në Dimër, kam parë dëborëra mitologjike. Këtë element e ndeshni dendur kudo në krijimtarinë time. Moska vetëm se e i dha një ripërmasim të hapësirës së pamatë. Nuk di ç'të them për vajzat moskovite. Me mua nuk përkoi reminishenca e leximeve dhe poetizimeve të shkrimtarëve shqiptarë. Kam përshtypjen se ai mit i poetizuar i moskoviteve, është një dukuri e rendit psikoanalitik, e cila e ka origjinën tek mungesat dhe defiçencat në komunikimin e lirshëm me femrat në përgjithësi. Për mendimin tim asgjë të veçantë nuk kanë moskovitet nga femrat e tjera. E meqë shkoi kështu puna, lavdet më të mëdha do t'i kurseja për femrat shqiptare. Në çdo pikëpamje. Dhe jo për ndonjë ndjenjë patriotizmi, më kuptoni drejt... Vajzat ruse rrinë më mirë si personazhe në letërsinë e tyre të mrekullueshme klasike e moderne, por kjo është punë e shkrimtarëve dhe e shpirtit të tyre poetik.

– Me syrin e një të djathti... Ç'mendim keni për rritjen e të djathtës ekstreme në Europë

A.T: E thatë vetë cilësorin "ekstreme". Aristoteli ia ka caktuar njeriut vendin në filozofinë e vet si qenie "mesit", pra, "mesit të artë", rrjedhimisht dhe shoqërive e sistemeve shoqërore. Mendoj se si në çdo teprim me ndjenjën e masës, rezultatet janë të vajtueshme. Në pushtetet politike e ideologjike këto "ekstreme" paralajmërojnë gjithmonë katastrofa, të ngjashme me totalitarizmat e shekullit që shkoi. Problemi është se ekstremi nuk luftohet me ekstrem (ekstremi i djathtë naziskin, nuk luftohet me ekstremin e majtë stalinist). Unë njëmend e konsideroj veten botëkuptimisht të djathtë, e kjo ka ardhur jo menjëherë, por me një ndërgjegjësim të ngadalshëm, duke përqasur përvoja personale e kolektive, sensibilitete të ngritura mbi këto përvoja, lexime të gjata e të imtësishme, derisa janë kthjelluar ujërat e identitetit personal botëkuptimor me boshtin e vlerave që përfaqëson e djathta që nga antikiteti deri sot. Veç nuk duhet të harrojmë, se e djathta dhe e majta, duke u ushtruar si pushtete politike e duke korrur fryte të helmëta përvojash historike nga ekstremitetet e veta (diktaturat totalitare), kanë shkëmbyer mjaft nga elementët e njëra-tjetrës, sa sot në mund të veçojmë jo më shume se 4-5 elementë dallues midis tyre. Flas për të djathtën e të majtën e kuptimit euroamerikan që njohim, jo për truallin e shqipeve ku këto dy politologjema bëjnë vetëvrasje. Këtu kemi hipokrizi dhe kapërcim të ndërsjelltë ylberësh politikë (filozofisë botëkuptimore as që ia ka kush takatin), thjesht për laçkë e plaçkë. E me gjetë sot një të djathtë, ashtu si e gjykoj unë, botëkuptimisht, duhet ta kërkosh anekënd me fenerin e Diogjenit. Sepse, përkundër teorisë, kemi të majtën që sillest praktikisht në pushtet si e djathtë dhe anasjelltas. E keqja nuk qëndron tek roli që duhet të luajnë në jetën politike e shoqërore e djathta dhe majta: ato janë asete të një rëndësie vendimtare për qeverisjen e një shoqërie me kriticizmin dhe oponencën respektive. Pra, e majta dhe e djathta duhet të jenë si duart, ku e djathta lan të majtën dhe të dyja së bashku – fytyrën. Veçse tek ne po ndodh sistematikisht, që ato nuk lajnë fytyrën, por diçka shumë më prozaike...

-Cili është mendimi juaj për letërsinë e sotme shqipe? Ndoshta është një përshtypje imja e gabuar (uroj shumë të jetë kështu), por mua më duket sikur ka një pakt të heshtur që të mos flitet për disa shkrimtarë. Kam lexuar shkrimtarë të rinj që më kanë impresionuar dhe ata nuk përmenden askund...

A.T: Letërsia shqipe ka nevojë për një pritje bujare, mirëseardhje dhe sidomos komunikim mesvedi me lexuesin. Ka nevojë për një atmosferë më miqësore, njohje e pranim të ndërsjelltë vlerash, kushtim vemendjeje. Ka nevojë për një klimë tonën, familjare, të vatrës. Por, ajme!As shkrimtarët nuk e njohin-njëri-tjetrin... dhe rritet kështu paragjykimi, fodullëku, fobia. Gjithë këtyre viteve e shoh të ndodhë kjo gjë e shëmtuar. Po mëson edhe letërsia huqet më të këqija të politikës. E di, që disa emra duhet të sundojnë peizazhin informativ letrar me përmendjet, përsëritjet, reklamën etj., dhe disa të tjerë janë dënuar qysh në krye të herës të mbeten në hije. Kjo ndodh sepse kështu vendosin koniukturat që zotërojnë "kanalin" e komunikimit, sepse me kohë janë krijuar kasta, tarafe e establishmente të vjetra e të reja, një lloj harte principatash letrare, sikundërse dhe guerrilje të mirëfillta.

Por në thelb letërsia shqipe, për fat, është një letërsi e mrekullueshme, sidomos pas viteve 1990 e këtej. Qypat e mediave, që u ka mbetur ora e leximit diku midis viteve 70-80 shpesh pyesin: "A shkruhet letërsi e madhe sot? Pse nuk ka maja, si në vitet '60?". U jam përgjigjur, që letërsia është një realitet shumë më demokratik, sa ç'e reduktoni ju në hartë fizike. Megjithatë, ka dhe maja, por nuk po ka alpinistë që të ngjiten në këto maja".

Në letërsinë e re shqipe shkruhet normalisht poezi e mirë, shumë e mirë, pa asnjë kompleks përballë kulturave më në zë të botës. Shkruhet prozë autentike, si pjesës e përvojës së lëkurës sonë. Nuk ka më tabu, befasitë e penave të reja e shthurin tendencën për hierarki e kalcifikim hierarkish. Si tipologji shkrimtari i viteve postnëntëdhjetë është një qenie plot uri kulturore: ai është prozator, poet, përkthyes, piktor, studiues e kritik, pra një qenie solide me rrënjë të thella në kulturë të lartë. Ndoshta dhe për këtë oshënari e higjenë serioziteti të klaviaturës artistike ai nuk honepset prej adeptëve e ustallarëve multimedialë.

Letërsia jonë vuan shumë si sistem funksionimi. Ajo nuk funksionon. Nuk ka gazeta letrare, revista, fletore, periodikë të qëndrueshëm e prestigjioze, ku mund të përthyheshin tendencat, trendet, stilet, risitë, emrat që hyjnë e ata që konfirmohen. Prandaj dhe peizazhi është i paqartë dhe është zor të të dëgjohet zëri në këtë shkretëtirë. Ato pak kanale kulturore që janë, shpesh merren me hosana të vjetra.

-Në këto pak vite që unë kam patur kontakt të drejtpërdrejtë me botën e letrave shqipe, kam bërë një kostatim mjaft të hidhur-Disa shkrimtarë shqiptarë kanë një megallomani të frikshme. (Shpresoj shumë që ata të mos dalin në protesta pas kësaj, apo të më djegin librat në shesh... Sidoqoftë më duhet të them se një roman i imi i ka fletë shumë të holla, nuk do të ndizej një zjarr i denjë...) Si i ruheni ju megallomanisë? Çfarë autoimuni përdorni për ta luftuar (Unë për shembull praktikoj shumë autoironinë...)

– A.T: Ku ma gjen të ta bënin atë shërbim... Djegia do të ishte një aksion shumë i vlefshëm për një vëmendje epidemike. Vdekja për një libër nuk vjen as prej vlerësimeve maksimaliste, as prej përndjekjeve naziskine, si djegia. Ndëshkimi më i madh për një libër është indiferenca. Megallomania ndër ne është normë gratis, por, besoj, nuk hipnotizon kënd: ajo thjesht rrëfen vetveten, krizën e shëndetit mendor. Unë jam i pambrojtur dhe si i tillë, ironia (autoironia) është nëna e pafuqisë. Pra, kur s'e ndryshon dot gjendjen, bën ironi/autoironi. Dhe kjo është edhe më e dhimbshme. Gjëja më e mirë është karantina letrare. Mbyllu, shkruaj, boto, e mos komuniko, derisa të kesh krijuar, vetevetishëm, natyrshëm, miqësitë e tua, jodoemos letrare, rrethin ku ndjehesh më mirë. Por unë prej vitesh nuk e kam as këtë luks. Mezi gjej fare pak kohë të shkurtër të shkruaj, jo më të mendoj më gjerë. Thjesht, Arlinda, e lëshoj librin që shkruaj si një shishkë në oqean.

-Prej krijimtarisë suaj kam kuptuar se ju punoni shumë me fjalën. Ato janë gjithmonë në vendin e tyre. Fjalë të vjetra dhe të reja, në harmoni, pa sforcime. Vërtet ju vjen natyrshëm e gjithë kjo? Apo kur flisni me njerëz të moshuar hapni një bllok dhe i shënoni atje fjalët e rralla?

A.T: Oh, jooo. Është thjesht ndjeshmëri e edukuar gjatë e veshit dhe e leximeve, ndjeshmëria dhe varësia ndaj fjalëve. Por, kryesisht, puna me fjalën pa "njolla dhune" në trup të saj, është dhanti e poezisë. Dhe poezia është një shkollë askezë (dhe ekzegeze) për fjalën. Aty fjala kundrohet si sondë që heton deri në shekullin e saj të gurtë. Ose fjala si gajde shumëgrykëshe që çliron frymën e të gjitha shekujve. Nuk jam tip që mban shënime për asgjë, aq më tepër për fjalët. Nuk jam tip i "gërshërës dhe mastiçit", pra, kolazhist.

-Më thoni gjënë me aluçinante që keni dëgjuar nga ndonjë student, e cila flet shumë për mangësitë e sistemit tonë arsimor...

A.T: Ishte njëri, që në një provim mbi veprën e Kafkës shkruajti tekstualisht kështu: "Frans Kafka kishte marrëdhënie mysbet me babin e vet. Se Kafka kishte komplekse. Nuk i duronte femrat. Por këto komplekse ia kishte ngjitur i ati. Se si, njëherë, Kafka e pa të atin lakuriq. Dhe iu shpif bota. Dhe iu shpif çdo gjë. Mbeti me komplekse". E citova të plotë se e kam pasë fotografuar këtë përgjigje, e cila vjen si nga një i sëmurë në koma.

-Gjithmonë kam menduar se humorit, ironisë, apo akoma më tepër autoironisë, nuk i është dhënë rëndësia e duhur në letrat shqipe. Duket sikur veprat letrare që përshkohen nga humori, për studiuesit nuk konsiderohen serioze. Sa rëndësi i jepni humorit në krijimtarinë tuaj?

– A.T: Unë jam rritur që i vogël nën hijen e leximeve të vazhdueshme të "Don Kishotit", Jerom K. Jerom "Tre veta në një barkë, pa llogaritur qenin", adhuroja Hashekun, Gogolin, Dodenë, O'Henri-n dhe Tuenin, etj. Sigurisht, ju keni gjuajtur saktë një gjendje: letërsia shqipe (ashtu si dhe filmi) nuk kanë humor. Në filmat e Kinostudios, duket sikur qeshja behet me komandë partiake. Unë mendoj, se në letërsinë tonë rëndon trashëgimia e ngrysur socrealiste me frymën e saj të dogmës. Ka pasur humor Çajupi, Fishta, Konica, Cipo, Asllani, rrëfimet e Kutelit etj... Po humori i socrealist? E keni vënë re që komunistët (ortodoksalë) ashtu sikundërse dhe fundamentalistët (e çdo kahu) karakterizohen nga mungesa katastrofike e çdo nuance humori? Pra është çështje e rrastë botëkuptimi. Ku kanë nge këto koka të zënë deri te humori? Mungesa e humorit është prolog i mënxyrave...

-Në kohën e prindërve tanë, dukej se për të mbajtur gjallë një marrëdhënie në çift, kishte shumë sakrifica dhe zero egoizëm. Në kohët tona, ka zero sakrifica dhe shumë, por vërtet, shumë egoizëm. Ju keni një familje simpatike, ku dallohet që nga larg harmonia që keni me bashkëshorten tuaj Elvanën. A sakrifikoni shumë për ta bërë të ecë një marrëdhënie të tillë? Apo ajo, thjesht ecën vetë...

A.T: Di të them vetëm kaq: unë nuk e di ku filloj unë dhe ku vazhdon Elvana. Dhe anasjelltas. Gjithçka përftohet vetvetiu. Pa ndonjë plan. Dikush duhet të mbajë ndezur lart e fuqishëm pishtarin e humorit, ironisë, autosarkazmës. Lavdi Zotit trishtimet, gjendjet e stresit e ankthit edhe pse janë të shpeshta, nuk zgjatin më shumë se një shi pranvere... Sakrifica bëhet pa u ndier, nga dashuria dhe domosdoja, pa radhë, pa kërkesë. Ne duhet t'u japim shembull 5 fëmijëve, se si mundet çdo egoizëm. Sepse, siç e kemi ndjerë ne vetë me prindërit tanë, ashtu ka mbetur e pandryshuar: prindi është i pakonkurrueshëm. Ai të mund me vetësakrifikimin e tij. Shpresojmë të përcillet kjo tek fëmijët tanë.

-Më jepni një detaj prej Tiranës të cilin mund ta shndërroni në një poezi. Mund ta shkruani tani atë poezi?

A.T: Ah, sikur të kishte... Por, ka në fakt, ka... Veçse nuk është faji im, nëse natyra e vargjeve të tilla do të dilte ala-Bodler. Ja një strofë:

... Dhe Lanë e llurbët çan përmes
Qytetin kredhur – kutërbim;
Mjafton ky qiell, ky mëngjes,
T'ju shkurajojë gjer në amshim.
Ju falënderoj për bisedën!
A.T: Ishte kënaqësi e lartë!

Marrë nga www.konica.al

Rruga e Arbërit nr. 138 .139.

Shtek më shtek e skutë më skutë

Rrëfime dhe këngë Dibre. Anekdota, gojëdhëna, tregime të shkurtra.

Nj botim në format xhepi, i përshtatshëm për t'u lexuar kudo ku ndodheni.
Një libër që të rrëmben me magjinë e të folurë së Dibres, plot nënkuptime e alegori;
krejt origjinale të mbledhura nga Munir Shehu.

MUNIR SHEHU
Përgatiti për botim:
Mirdash Shehu

Botimet M&B
ISBN: 978-9928-4458-2-7
Faqe: 208
Çmimi: 700 lekë

botim i ri

Unë ta mora vocin

Dali Noka në Grykë Nokaj nuk kishte djalë, por vetëm një cucë. Ai deshi të zgjidhte një dhëndër që të jetë i mençëm e i shkathët dhe ta ketë si djalin e vet.

Dan Bushi në Renxë nuk ishte shtëpi e parë si Dali Noka, por djalit të tij nuk i gjendej shoku. Mbasi i kishte dëgjuar muhabetet e Dali Nokës për punë të fejesës së vajzës, ai provoi me lypë cucën për të birin. Dali Noka ia dha. Në përviçe, duke dashur të tregojë diçka të jashtëzakonshme, Dan Bushi i tha Dali Nokës:

- Or Dali, ta mora cucën!

- Jo, or Dan! Unë ta mora vocin!

***

Të bani si baj unë

Gjurasit kanë qenë të fundit që u kthyen në fe. Doemos, n'at vjet, këta nuk dijshin as edhe nji elif arapçe, me sa dinë sot! Prandaj hoxha u kishte thanë:

- Në xhami të bani si baj unë!

Eh, mirë! Hoxha ulu edhe ata ulu, hoxha ngreu edhe ata ngreu. Kur po dilshin prej xhamie, hoxha nga pakujdesia, tue qenë shumë i gjatë, e përplasi kokën fort për direkut të sipërm të derës. Të gjithë gjurasit edhe ata ma të shkurtët, nuk delshin jashtë për pa e përplasë ballin fort mbas direkut të derës.



roman

Funeral i të gjallëve apo jetë e të vdekurve?
- Një histori e pakohë dashurie, ku si në një lojë pasqyrash vdekja shfaqet si imazhi më i gjallë i jetës.

Nga prologu i librit:

Ky është një roman i ri i imi, personazhet enigmatikë të të cilit kanë rastisur po aq dembelë sa edhe autori. Të paktën, deri tani, më shumë mendojnë sesa flasin. Do më duhet të rri në cep të skenës, nganjëherë të hyj e të dal mes tyre, t'u zë vendin në kolltukun e preferuar, t'ua ndërpres në mes kuvendimet pasionante apo t'ua ndez me dru të lagur oxhakun rreth të cilit ulen kur unë nuk e kam mendjen te ata, por te botuesi im, akoma imagjinar. Në ndonjë rast do më duhet të hyj edhe në dhomën e tyre të gjumit me një qiri në dorë dhe me njëqind mendime të padenja në kokë.

Gjithçka nisi një ditë prilli kur njoha Evën, një piktore e sapodivorcuar. I shoqi ishte bindur që ajo e tradhtonte me dy karakteret e përhershëm të pikturave të saj dhe trupi gjykues, pasi kishte shqyrtuar imtësisht krijimtarinë e piktores, i kishte dhënë të drejtë. Një çift të cilit Eva i kishte kushtuar tërë jetën e saj të artit. Karakteret kishin filluar të plakeshin bashkë me Evën. Në vizatimet e para ata ishin aq të rinj dhe në të fundit flokët e tij ishin rralluar dhe balli rrudhosur, ndërsa gjysma femërore e çiftit kishte humbur ndriçimin e syve. Ngjyrat sa vinin e zbeheshin dhe kish qenë ky momenti kur Eva kishte humbur komunikimin me ta. Telajua nuk u përgjigjej më pyetjeve që ajo i bënte. Sa më shumë detaje shtonte në portretet e tyre, aq më shumë ata refuzonin t'i flisnin. Dhe, natyrisht, për një artist kjo është e tmerrshme.

Kështu, pasi kishim bërë dashuri për herë të parë me Evën, i premtova vetes se duhej me domosdo ta nxirrja atë grua të bukur nga dëshpërimi që i kishte falur heshtja e dy karaktereve të paemër të pikturave të saj.

I bajatepsur nga përditshmëria dhe i bajalldisur nga njerëzit e lëshova veten në krahët e një ideje që feksi pa shumë bujë brenda meje. Vendosa t'ia vjedh Evës dy karakteret e pikturave të saj dhe t'i shndërroj në personazhe të romanit tim për të zhbiruar më thellë drejt asaj që Eva, edhe pse krijuese e tyre, nuk dinte për ta. Letërsia, ndryshe nga piktura, të jep mundësi të bësh çfarë të duash me personazhet e tu dhe t'ua ndryshosh fatet e destinin sa herë të duash, disa herë edhe kundër dëshirës së tyre.

Evës iu duk shpresëdhënëse ideja.

Fillimisht m'u desh t'iu gjeja një emër personazheve të mi të rinj, aq të vjetër për Evën. Vendosa t'i quaj Maria dhe Martin. Por nuk mund t'i lija vetëm. Druaja që mund të bija në grackën e heshtjes së tyre edhe unë. Unë nuk do e lë Marien time të shkojë vetë drejt shinave si Ana e Tolstoit. Të paktën, jo përpara se të më ketë dhënë të gjitha shpjegimet që në telajo ia ka refuzuar Evës për shumë vite me radhë. Kurse me Martinin gjërat janë më të thjeshta. Personazhet meshkuj zakonisht janë të bindur dhe shumë rrallë shfaqin tendencën për t'i ikur nga kontrolli autorit. Më duhej edhe një personazh i tretë, i cili jo vetëm do të thyejë heshtjen e çiftit, por do më shërbejë mua edhe si informator. Hë për hë nuk di asgjë për këtë personazh që e kam pagëzuar Marko. Dhe, për të shmangur ndonjë ndërlikim të paparashikueshëm të ngjarjeve brenda dhe jashtë romanit, kam vendosur që Marko të hyjë në librin tim në trajtën e një të vdekuri. Nganjëherë njerëzit fillojnë të jetojnë pikërisht kur nuk janë më. Ndoshta edhe Marko.

Paskëtaj Eva do të çlirohet nga heshtja vrastare e karaktereve të saj dhe, me pak durim më shumë, mund të bëhet krejtësisht e imja.

Artan Gjyzel Hasani

FUNERAL - *Roman*
Artan Gjyzel Hasani
Botimet M&B/ ISBN:978-9928-4458-6-5
Kopertina: Zaim Elezi
Faqe: 116/ Çmimi: 500 lekë

Romani i ri i Artan Gjyzel Hasanit prezantohen për herë të parë në Panairin e Librit në Tiranë, që do të mbahet në Pallatin e Kongreseve në Tiranë nga data 15-19 nëntor 2017. Librin mund ta gjeni në rrjetin e librarrive Adrion në Tiranë, pranë librarisë së botimeve M&B pranë Selvisë, në agjencitë e shpërndarjes Dita dhe Reklama në Tiranë, si dhe në disa librari në rrethe

Rruga e Arbërit nr. 138 .139.

botime



Shaban Sinani
Pyetje të tjera në albanologji: autorë dhe teza
Botues: *Naimi* - shtëpi botuese dhe studio letrare
www.botimenaimi.com
ISBN: 978-9928-234-10-0
328 faqe; 15.5 x 23.5 cm.
Çmimi: 1000 lekë

Josif Bageri i Rekës së Dibrës

Josif Bageri me të drejtë konsiderohet si themeluesi i letërsisë etnografike të Dibrës me rrethina. Gazeta që ai botoi është e para dhe e fundmja që u shkrua në këtë nëndialekt, mjaft konservativ, jo vetëm në anën fonetike, në leksik dhe në disa aspekte të eptimit, por mbi të gjitha për disa vlera antropogjuhësore dhe sidomos për studime arkeogjuhësore

Josif Bagerit i takon, giithashtu, merita e të parit shkrimtar dibran që e pajisi shqipen e vendlindjes, shqipen e Rekës së Dibrës, me ligjërimin e shkruar. Ky ishte një ndërrim rendi jo vetëm në pikëpamjen gjuhësore e kulturore, por dhe teknike.

Josif Bageri nuk është thjesht *poeti i Rekës,* siç përmendet ndonjëherë. Ai përbën një prej nyjave të forta ku ndërlidhen krijues të mëparshëm e të mëvonshëm shqiptarë, që krijuan në vendlindje apo atje ku i çoi udha e jetës, siç ndodhi me Migjenin. Ne nuk e shohim të rastit, për shembull, që çfarë kishte kërkuar në Sofje më 1911 Josif Bageri, pranimin e një meshtari shqiptar dhe liturgji në gjuhën amtare, do ta kërkonte në Kongresin e Beratit babai i Migjenit Gjoko Nikolić. Ashtu sikurse çmojmë si tipar përafrues prirjen e të dyve për të shekullarizuar veprën e tyre: Josif Bageri duke u kërkuar lexuesve të *Ushtimit të Krujës* pranimin e princit protestan Wilhelm Wied përtej dallimit fetar, kurse Migjeni duke u këshilluar të vetëve të mos besonin më tek *perënditë klasike,* tek *Zoti klasik*.

Kalila dhe Dimna në shqip nga Sulejman Tomçini

"Një nga librat më të famshëm që është shkruar ndonjëherë, është libri i njohur nga arabët si "Kalila dhe Dimna", një bestseller për pothuajse 2000 vite dhe një libër që ende lexohet me kënaqësi në gjithë botën. Ai është përkthyer të paktën 200 herë në 50 gjuhë të ndryshme."

Paul Lunde

Nga **Sulejman TOMÇINI**

Kalila dhe Dimna", në formën si paraqitet, del si vepër e një barhami indian, që ka jetuar, afërsisht, në kohën e fushatës indiane të Aleksandrit të Madh, filozofit Bajdaba. Në të, përveç 15 tregimeve-fabula, janë edhe parathëniet, siç është ajo e paraqitur nga Bahud Bin Sahvan, i mbiquajtur Ali Bin Shah al- Farisiu, ku jepen shkaqet se, përse e shkroi këtë vepër filozofi Bajdaba dhe përse ngjarjet dhe bisedat ua mveshi kafshëve dhe shpendëve etj. Kapitulli rreth dërgimit të mjekut dhe dijetarit pers Barzavi në Indi në kërkim të kësaj vepre dhe të veprave të tjera të kulturës, shkencës dhe mençurisë indiane, nga ana e mbretit Anu Shurvan të Persisë; parathënia e Abdullah Ibn Al-Mukafas, si dhe kapitulli jetëshkrimor mbi Barzavin, i përgatitur nga ministri i mbretit Anu Shurvan, Buzur Xhamihra Bin Al-Bahtakan, mund të mos i bashkëngjiteshin këtij botimi, por heqja e tyre nuk do ta jepte të plotë atë, për më tepër që vetë këta kapituj janë perla të vërteta artistike dhe etiko-morale dhe e ndihmojnë lexuesin të futet më mirë në vorbullën e kohës kur është shkruar kjo vepër.

Ka pikëpamje të ndryshme për autenticitetin e veprës, por të gjithë bashkohen në mendimin se pesë prej fabulave janë origjinale, të marra nga njëri prej librave më në zë të klasikes indiane "Pançatranta", që në shqip përkthehet "Pesë rastet e mençurisë". Këto janë fabulat: "Luani dhe Demi", ku dy çakej me emrat Kalila dhe Dimna, që janë dy personazhet kryesorë të saj, i kanë dhënë emrin veprës; "Pëllumbesha e egër", "Bufët dhe korbat", "Majmuni dhe breshku" dhe i pesti "Asketi dhe Nuselala". Por theksohet se edhe fabulat e tjera janë autentike indiane, pavarësisht se asnjëra prej tyre nuk i ka shpëtuar ndonjë shtese apo ndryshimi. Fabulat janë ndërtuar në formë tregimi, që shumë herë ndërpritet nga futja në të e tregimeve të tjera ndërmjetëse, që, pavarësisht se e largojnë paksa lexuesin nga boshti qendror, janë në funksion të idesë qendrore dhe në një farë mënyre shërbejnë për të mbështetur këtë ide.

Europianët janë njohur me këtë vepër për herë të parë aty nga viti 1251, të përkthyer spanjisht nga versioni arab. Më vonë, italiani Baldo bëri një përpunim të ri të saj me titull: "Novus Aesopus" (Ezopi i Ri), që shërbeu si bazë për përkthimin në latinisht. Megjithatë, versioni, të cilit iu referuan për një farë kohe përkthyesit e ndryshëm europianë, ishte ai i përkthyer nga hebraishtja në latinisht nga Xhovani Da Kapua, midis viteve 1263 – 1278. Më vonë janë bërë një sërë përkthimesh e botimesh të tjera direkt nga gjuhët e orientit, duke influencuar jo pak në letërsinë europiane, sidomos te fabulistë të tillë të famshëm si La Fonteni.

Me përkthimin në shqip të kësaj vepre dhe botimin e saj bëhet një hap tjetër në drejtim të njohjes së lexuesit shqiptar me perlat e letërsisë klasike indiane dhe, në përgjithësi, orientale.

Librin mund ta gjeni në Panairin e Librit në Tiranë, që do të mbahet në Pallatin e Kongreseve në Tiranë nga data 15-19 nëntor 2017. Librin mund ta gjeni në rrjetin e librarrive Adrion në Tiranë, pranë librarisë së botimeve M&B pranë Selvisë, në agjencitë e shpërndarjes Dita dhe Reklama në Tiranë.

cyan magenta yelloë black

libër i ri

Ç'është filozofia popullore?



MARTINI, XHAFER
FILOZOFIA POPULLORE

Botimet M&B, 2017
ISBN 978-9928-4458-3-4
Faqe 256
Çmimi: 1000 lekë

Me fjalën filozofi popullore në këndin tonë të shikimit duhet kuptuar mënyra se si i shikon populli dukuritë e jetës, si i kupton dhe interpreton ato, si i karakterizon, si i vë në shërbim të tij, çfarë qëndrimi mban ndaj tyre, çfarë përgjigjesh u jep pyetjeve që e mundojnë, si ndikojnë këto përgjigje në sjelljen dhe qëndrimin e njeriut, çfarë mësimesh të vlefshme nxjerr e të tjera. Një nga qëllimet e kësaj filozofie ka qenë arritja "e mundësive konkrete të njeriut për të bërë disa hapa përpara në shpjegimin, përcaktimin dhe vënien nën kontroll të botës" [1] Nga shumë dukuri filozofike të marrim njërën prej tyre-Shpresën. Mishërimi i filozofisë popullore në këtë dukuri do të dilte në dhënien e përgjigjeve të këtyre pyetjeve: Ç'është shpresa? A ekziston shpresa? Çfarë vlere ka shpresa? A duhet të jetojë njeriu me shpresë? Pikëpamja filozofike e popullit për këtë dukuri mishërohet në format e ndryshme të krijimtarisë së tij: në fjalë të urta, në përralla, gojëdhëna, mite, legjenda, tregime, alegori, poezi popullore, në gjithçka të tijën. Filozofia e popullit të mëson si ta jetosh jetën. Ajo është përvojë jetësore. Filozofët popullorë kanë besim që me mësimet dhe idetë e tyre, me thëniet, qëndrimet dhe veprimet kanë ndikuar mbi popullin për mirë, e kanë drejtuar atë në rrugën që duhej ndjekur për të bërë një jetë të denjë e të virtytshme. Ajo është zhvilluar në mesin e popullit, në gjirin e tij dhe jo në katedra universitare. Në të përfshihen ëndrrat dhe pasionet, dëshirat dhe vullneti, të gjitha përpjekjet që bën populli drejt progresit; në të janë të mishëruara edhe vuajtjet e fatkeqësitë, gëzimet e hareja.

Filozofia antike dhe moderne nga shekulli në shekull është pasuruar dhe përsosur. Filozofia antike është zhvilluar nëpërmjet shkollave filozofike ku lëvronin idetë dhe pikëpamjet e veta botëkuptimore shumë filozofë. Shkollat u hapën që themeluesit t'u përcillnin dishepujve mësimet e tyre. Në Greqinë e Lashtë nuk ekzistonte kurrëfarë universiteti, kjo qe "arsyeja që filozofët u ndjenë të shtrënguar të organizoheshin në shkolla që themeluan me forcat dhe përpjekjet vetjake". [2] Filozofia e sotme moderne karakterizohet nga bashkëpunimi midis filozofëve të ndryshëm, mbasi këta e kanë kuptuar dhe janë "shprehur haptas se asnjë filozof nuk mund të arrijë të trajtojë dhe të zgjidh krejt i vetëm të tërë çështjet thelbësore të filozofisë."

Filozofia e popullit ka lindur gjatë procesit të zhvillimi të jetës që nga stadi më i ulët i shoqërisë njerëzore deri në stadin e sotëm. Nuk jemi në gjendje ta përcaktojmë moshën e saj. Por një gjë është e sigurt: mendimi njerëzor ka pasë arritur në nivel aq të lartë sa ne edhe sot habitemi me pjekurinë e tij. Kjo do të thotë se rajoni ku jetuan të parët e shqiptarëve të sotëm ka qenë i zhvilluar. Pararendësit tanë më të hershëm (Pellazgët-Ilirët) kanë qenë më të zhvilluar se fqinjët. Më poshtë do të bëjmë krahasime.

Zhvillimi i kulturës greke në lashtësi tashmë nuk është një gjë që mohohet. Filozofia antike e pati zanafillën e saj në Miletet greke në Azinë e Vogël, me përfaqësuesit më të zëshëm: Talesi, Anaksimandri dhe Anaksimeni. Por tre më të mëdhenjtë e kësaj filozofie janë: Sokrati, Platoni dhe Aristoteli.

Dy prej tyre, Platoni dhe Aristoteli, kaluan shumë vjet, i pari - në Sirakuzë, i dyti- në Maqedoni, pranë oborreve mbretërore. Aristoteli u bë mësues për Aleksandrin e vogël që do të bëhej i famshëm. [3] Por të parët tanë kanë qenë para grekëve në këtë rajon. Pellazgët janë populllsia më e lashtë në kontinent. Studime interesante dhe me themel për lashtësinë dhe zhvillimin e Pellazgëve-Ilirëve-Shqiptarëve ka bërë Nermin Vlora Falaski me librin e saj të vëllimshëm: "Pellazgët, Ilirët, Etruskët, Shqiptarët". Shqipja, sipas saj, ishte gjuhë e përbashkët e pellazgëve, ilirëve dhe etruskëve të lashtë. Nëpërmjet shqipes mund të rindërtohet edhe historia e këtyre popujve. Ilirishtja ose shqipja, thotë kjo autore, nuk u helenizua edhe pse pati në përdorim shkrimin grek; nuk u romanizua, nuk u sllavizua, nuk u turqizua, shqiptarët ditën ta ruajnë kulturën dhe traditat e veta edhe nën pushtime të gjata. Kjo është arsyeja përse u ruajt gjuha në Iliri, përkatësisht në Shqipëri. "Mirëpo shtrohet pyetja si u përhap ilirishtja në Gadishullin Apenin?! Kësaj pyetjeje i përgjigjet Herodoti, i cili thotë: "Etruskët flisnin gjuhën e një populli të lashtë, që jetonte në krahinën e Mesdheut para ardhjes së grekëve" që do të thotë se etruskët ishin pellazgë, në të vërtetë ilirë, të cilët, para se të vendoseshin grekët në Gadishullin e Ballkanit (12 shekuj para erës sonë), jetonin në Jug të Ilirisë". [4] Nermin Vlora Falaski flet edhe për zhvillimin e madh të jashtëzakonshëm të këtyre popujve, për atë lloj qytetërimi që ka ekzistuar, por që tani ka humbur. "Dhuna dhe egërsia, - shkruan autorja,- i fshehin kulturat në shkurre të helmuara. Por, kultura është dritë që, edhe kur duket e fshehur, nuk asgjësohet dhe, shpejt ose vonë, del e vezullon në një trevë kulture të zhvilluar me fisnikëri të vërtetë. Në kulluesin e madh të kohës mbetet pjesa bërthamore e një kulture të fshehur me dhunë dhe kjo vjen dhe ndriçon përsëri në çastin e përshtatshëm. Nëse trashëgimia pellazge-etruske ishte zbërthyer nga romakët, ajo diti të lulëzonte përsëri në TOSKE të etruskëve, duke ndriçuar Botën rilindase me ato mendje madhështore..."[5] Prej këndej nxjerrim përfundimin se nuk është aspak për t'u çuditur me ato tekste të mrekullueshme me përmbajtje filozofike të popullit tonë që na vinë nga lashtësia, se, siç e pamë, jo vetëm jemi më të hershmit se të gjithë ata që jetojnë sot në Gadishullin Ballkanik, duke përfshirë edhe grekët, por edhe kemi lëshuar dritë më shumë.

Në filozofinë popullore përfshihen të gjitha format shpirtërore të shprehjes së mendimit të popullit, duke filluar me magjitë, mitet, paragjykimet dhe me forma të tjera të mendimit primitiv. Këtë "konglomerat" të filozofisë popullore e kanë vërejtur edhe filozofët modernë, një prej tyre është edhe Cohen, i cili, duke iu referuar lashtësisë, bën fjalë për "një lloj psikologjie primitive (që) karashtisej shpeshtas me epistemologjinë, kozmologjia përzihej me etnologjinë, teologjia me metafizikën, ekonomia apo antropologjia me filozofinë politike dhe kështu me radhë". [6]





1) William Jordan: "Koncepte të hershme filozofike", Logokron 2008, f. 16
2) Jordan: 2008:19
3) Jordan: 2008: 8
4) Nermin Vlora Falaski: "Pellazgët, Ilirët, Etruskët, Shqiptarët", shtëpia botuese "Faik Konica", Prishtinë 2014, f. 11
5) Falaski: 2014:11
6) Willian Jordan: 2008: 17



Mimoza Tola
Vogëlushja Kejt
Novelë për fëmijë

Botimet M&B
ISBN: 978-9928-4458-0-3
Redaktor: Viron Kona
Ilustrimet dhe kopertina:
Mariglen Gjestila
Faqe: 88 / Me ngjyra
Çmimi: 500 lekë

Vogëushja Kejt

"VOGËLUSHJA KEJT" është një libër i këndshëm për fëmijë, kryesisht të ciklit të ulët, por dhe për prindërit e tyre, ndaj (do të) lexohet me ëndje edhe prej tyre, ose si i themi ne "libër për të gjitha moshat". Autorja në këtë novelë dëshmon se e njeh mirë botën e pasur, të sinqertë e naive të fëmijëve, psikologjinë e tyre, problematikat në rritjen, edukimin, shkollimin dhe argëtimin e tyre specifik, në një ndërthurje organike me brezat e tjerë, gjyshërit, prindërit, edukatorët a mësuesit apo më të rriturit, ashtu siç është në realitet edhe vetë shoqëria. Autorja rrëfen këndshëm, me origjinalitet dhe ka një aftësi spikatëse individualizuese, qoftë edhe brenda një kapitulli (të emërtuar të gjitha), por që mund të qëndrojnë fare mirë edhe si tregime në vete, të mëvetësuara. Kohezionin narrativ e krijojnë më së pari: shkrimtarja, në dorë të të cilës ka rënë një ditar fëmije dhe vetë Kejt rreth të cilëve sillen një sërë ngjarjesh interesante e pikante, që e japin më të plotë botën fëmijërore, që siç rrëfen vetë vogëlushja Kejt në novelë "teta shkrimtarja i tregon sikur t'i kenë ndodhur secilit prej jush".

Megjithëse Dostojevski thoshte se s'ka më fantastike sesa realiteti, autorja Mimoza Tola, mjeshtërisht ka ditur të zgjedhë në mes të dhjetëra e qindra ngjarjeve të ndodhura apo dhe të fantazuara prej saj, ato më interesantet, më të bukurat, çka mund të themi se edhe pse, siç u tha më lart, novela është ndërtuar me tregimthe të mëvetësuara, ato e ruajnë unitetin novelistik të tyre, aq sa do të thosha, se duke parashikuar një sukses të merituar të këtij libri, autorja dashur pa dashur, si të thuash, ka nisur kështu një cikël a kolanë me këtë personazh Kejt.

Mimoza Tola, duke njohur mirë botën e fëmijëve, e di dhe përdor plot fantazi lojërat, fantazinë e tyre duke stigmatizuar prerjen qysh në loz të rrugëve të kollajshme ose të gënjeshtërta të fëmijëve dhe tregimthet apo fragmentet e novelës, shpesh herë përfundojnë moralizuese, ose didaskalike, çka e pranon ky zhanër dhe, përjashtuar ndonjë rast, ka qenë dhe është i pranishëm didaskalizmi.

Situatat në të cilat vihen personazhet fëmijë të veprojnë janë realiste, dialogë plot dinamizëm, të besueshme, të mençura, individualizuese dhe me humor të këndshëm fëmijëror.

Novela ka destinacionin e saj, çka e zumë në gojë në krye të herës. Do të thosha se titujt e tregimtheve apo të fragmenteve të novelës janë të gjetura, intriguese dhe disa herë të ngarkuara edhe me humor. Gjuha e novelës është e zgjedhur, e thjeshtë, e kuptueshme për lexuesit, duke dalë në konkluzionin se novela ka vlera te veçanta artistike, pedagogjike e estetike.

Botuesi

***

"Në letërsinë perëndimore për fëmijë dhe të rinj janë të shumta rastet e ardhjes së shkrimtarëve nga radhët e mësuesve, psikologëve dhe punonjësve socialë që punojnë nëpër shkolla me fëmijët dhe adoleshentët dhe ndeshen përditë me problemet e tyre. Shpesh ata kanë qenë të suksesshëm me librat e tyre.

Në letërsinë shqipe për fëmijë dhe të rinj rasti i shkrimtares Mimoza Tola është i tillë. Një njohëse e mirë e botës së fëmijëve, e sinqertë në ato që shkruan, tashmë një shkrimtare në periudhën e pjekurisë së vet letrare, Mimoza Tola vjen para lexuesve me librin e saj ""Vogëlushja Kejt", një përmbledhje tregimesh të shkurtra, e konceptuar si një mozaik me në qendër figurën e një vajze të zgjuar. Në libër spikat humori i këndshëm, ngjarjet e vërteta nga jeta e një vogëlusheje në shkollë dhe shtëpi, treguar me mjeshtëri dhe gjuhë të thjeshtë nga autorja. Talenti i Mimozës si shkrimtare qëndron në përthyerjen artistike që ajo u bën pikërisht ngjarjeve të jetës së përditshme, në dukje të zakonshme.

Do të doja t'i uroja Mimozës suksese të mëtejshme në krijimtarinë e saj në një kohë tepër të vështirë për letërsinë për fëmijë dhe të rinj në vendin tonë, kur nuk po hyjnë më në krijimtari shkrimtarë të rinj e të talentuar. Është detyrë patriotike e shkrimtarëve dhe mësuesve tanë të përkushtuar që ta mbajnë gjallë këtë letërsi, sepse atë që sjell letërsia kombëtare nuk mund ta bëjnë dot përkthimet.

Viktor Cenosinaj

Mimoza Tola
Udha jemi ne
Poezi për fëmijë

Botimet M&B
ISBN: 978-9928-4458-1-0
Redaktor: Viron Kona
Ilustrimet dhe kopertina:
Mariglen Gjestila / Faqe: 60
Çmimi: 400 lekë

Udha jemi ne

Nga **Viron KONA**

E prita me kënaqësi kërkesën për hartimin e një reçense për vëllimin "Udha jemi ne" të shkruar nga Mimoza Tola. Kjo lidhet edhe me faktin se i dua fëmijët, por edhe me respektin që ndjej për shkrimtarët që shkruajnë për fëmijë. Ndërkaq më nxiti dhe kureshtja për të parë trajtimin e tematikave të reja bashkëkohore, mënyrën artistike se si përcillen te lexuesi i vogël episodet, ndodhitë, ngjarjet që bëhen objekt i krijimit; cilat janë figurat letrare të përdorura; gjetjet artistike apo ngjyrimet e freskëta që, doemos i duhen një vëllimi për fëmijë, po aq sa i duhen ngjyrat një mozaiku...

Fëmijët ose lexojnë më të bukurën, ose nuk lexojnë fare. Nëse diçka nuk u pëlqen ata e marrin dhe e hedhin tej dhe vijojnë lojërat. Por, duke lexuar vëllimin që ka paraqitur para lexuesit shkrimtarja Mimoza Tola, dëshiroj të them se vjershat e saj poetike më tërhoqën, dallova në ato krijime një përkushtim ndaj kërkesave shpirtërore të fëmijëve të kohës së sotme, por konstatova dhe stil, shije dhe bukuri të paraqitjes së mesazheve. Janë krijime që me siguri do t`u pëlqejnë edhe lexuesve të vegjël, do t`i tërheqin ata, por dhe do t`u shërbejnë si argëtim artistik, ashtu dhe për edukimin e tyre nëpërmjet artit të poezisë.

Kur nis leximin e vëllimit, të duket se autorja të ka ftuar në kopshtin saj poetik dhe, me takt e mirësjellje të rrëfen njërën pas tjetrës vjershat poetike të cilat krijojnë emocion dhe ndjenja të bukura. Sapo shijon njërën, tjetra sikur të thërret ta shohësh edhe atë, të mos e anashkalosh, por t`i kushtosh vëmendjen e merituar. Ndërkaq, duhet të pohoj se poezitë e Mimoza Toles vijnë të freskëta, në to ka çiltërsi dhe origjinalitet. Natyrisht që fusha e letërsisë për fëmijë është shumë e gjerë dhe e larmishme, ata janë ëndërrimtarë të mëdhenj, interesat e tyre janë të shumta dhe të llojllojshme, kështu që edhe krijimtaria që u adresohet atyre, jo vetëm që duhet t`i trajtojë këto veçori dhe kërkesa të moshës, por duhet të gjejë edhe format apo këndshikimet më interesante dhe më tërheqëse, që lexuesi i vogël t`u afrohet dhe të përfshihet, të bëhet i interesuar për t`i njohur dhe shijuar.

Vëllimi hapet me poezinë "Besoj te babagjyshi", një emër shumë i dashur për fëmijët e të gjithë vendeve të botës. Sapo dëgjojnë për babagjyshin e vitit të ri, fytyrat u ngazëllejnë, kërcejnë e lodrojnë nga gëzimi rreth e qark bredhit të vitit të ri, teksa ëndrrat dhe dëshirat e jetës marrin udhë. Vjersha krijon njëherazi edhe një gjendje të veçantë shpirtërore, kur rrëfehet me vargje për njeriun, i cili për shkak të kushteve të mjerimit nuk ka pasur mundësi ta njohë plakun e vitit të ri dhe të përjetojë edhe ai si fëmijët e tjerë pritjen dhe kureshtjen për lodrat e dhuratat që do t`i sjellë babagjyshi. Vjersha lë mbresa te fëmijët, i mëson ata të shohin me realizëm dhe në mënyrë më të plotë mozaikun e jetës, që është edhe shkëlqimtar, por edhe gri: Ku është ky babagjysh?-më tha dikush,/ tek unë s'ka ardhur asnjëherë,/ e përmbi faqe loti lumë, /se fëmijëri nuk kishte ndjerë. Ndërkaq shfaqet me sens filozofik vjersha "Muri i Kinës", ku nëpërmjet një krahasimi, tregohet për "ndarjet" ndërmjet njerëzve. Autorja nënvizon artistikisht se, më shumë sesa muret prej guri, janë muret që vetë njerëzit ngrenë ndaj njëri-tjetrit ato që i ndajnë ata: Sot e shemb një mur,/tulla e gurë i rrëzon kollaj/sa vështirë është të shembësh mërinë,/ murëziu që njeriun ndan. Një peizazh poetik interesant është vjersha "Zërat e fëmijërisë", ku autorja sjell në përfytyrim fëmijërinë e saj përmes elementeve figurativë dhe emocioneve, që zgjojnë kujtime dhe mall për një kohë të shkuar dhe të bukur, mjaft të dashur për këdo: Fëmijëri, e ëmbël fjala/porsi bregut rrëshqet vala, /qesh e strukur në kujtime /lulëkuqe, fëmijëria ime. Teksa tërheqëse vjen vjersha "Biblioteka ime", ku merr krahë malli për librat dhe personazhet e tyre, të cilët janë bërë shokë dhe shoqe me heroinën e librit, ato e shoqërojnë atë kudo në jetë.

"Udha jemi ne", i shkruar nga Mimoza Tola, në tërësi një vëllim i arrirë, përcjell mesazhe të bukura, gjetje artistike origjinale, vargjet kanë tingëllim aktual dhe janë tërheqëse dhe të pëlqyeshme për fëmijët, lexohen dhe mbahen mend, veçanërisht idetë dhe mesazhet që herë-herë shkaktojnë entuziazëm, gëzim, kënaqësi e ngazëllim. Lexuesit e vegjël i dëshirojnë gjetjet artistike origjinale dhe mendoj se kjo dëshirë u plotësohet edhe me këtë vëllim mbresëlënës dhe të bukur, dhuruar nga autorja e talentuar Mimoza Tola.

Shkëputur nga parathënia e librit

botime

Që nga 2008 ky libër është botuar nga 4 botues të ndryshëm në Angli, Amerikë dhe Indi

ROUTLEDGE boton veprën e GËZIM ALPION

‘Takimet e Civilizimeve:

Nga Aleksandri i Madh tek Nënë Tereza’

Nga **Xhemail PECI***

Vepra e Dr Gëzim Alpion, sociolog në Universitetin e Birminghamit në Angli,‘Encounters with Civilizations: From Alexander the Great to Mother Teresa’, (‘Takimet e Civilizimeve: Nga Aleksandri i Madh tek Nënë Tereza’), u botua nga Routledge në Londër dhe New Yok më 29 shtator 2017. Ky libër e ka gjenezën në turneun e leksioneve që Alpion zhvilloi në Indi nëvitin 2005. Përveç autoriteteve fetare dhe akademike, leksionet e Alpion tërhoqën edhe vëmendjen e botuesve. Njëprej tyre shprehu dëshirën të botoj një vëllim me shkrime që reflektojnë interesat akademike të Alpion në lidhje me Ballkanin, Egjiptin, Britaninëe Madhe dhe Indinë.

Në 2008 Alpion dorëzoi për botimin librin ‘Encounters with Civilizations’, ku përfshihen 15 punime nga viti 1993, kur ai filloi të botoj si pasuniversitar në Kajro rreth civilizimit faraonik në gazetën ‘The Middle East Times’, deri në vitin 2007. Parathënia e librit është shkruar nga kolegu dhe miku i Nënë Terezës, studiuesi me origjinë kanadeze Profesor Gaston Roberge, autor i më se 20 librave, kryesisht për komunikimin masiv dhe kinematografinëindiane.

Në vitin 2009 ‘Encounters with Civilizations’ u botua në Amerikë nga Globic Press. Ndërsa në 2011 doli edicioni i dytë amerikan, këtë herë nga Transaction Publishers. Routledge është botuesi i katërt që e boton këtë vepër në më pak se një dekadë.

Që në fillim, libri tërhoqi vëmendjen e një numri ekspertësh të mediave dhe të disa sociologëve të shquar nga vende të ndryshme të cilët vlerësojnë aspekte të tematikës, njohurive, dhe stilit të Alpion.Në reçencën e tij në revistën shkencore ‘Continuum: Journal of Media & Cultural Studies’, që botohet nga Routledge, studiuesi australian Profesor Brian Shoesmith i Universitetit Edith Cowan thekson: ‘Si çdo sociolog i mirë, Alpion ndriçon thelbin e shoqërisë duke analizuar ata që janë lënë në skajet e saj. Alpion e pareqet të ‘huajin’ nga një këndvështrim që nuk është zymtë apo shkatërrues por pozitiv dhe sfidues’.

Studiuesja britanike Dr Claire Smetherhame Universitetit të Bristol-it, në reçencën

Libri tërhoqi vëmendjen e një numri ekspertësh të mediave dhe të disa sociologëve të shquar nga vende të ndryshme të cilët vlerësojnë aspekte të tematikës, njohurive, dhe stilit të Alpion. Në reçencën e tij në revistën shkencore ‘Continuum: Journal of Media & Cultural Studies’, theksohet: ‘Si çdo sociolog i mirë, Alpion ndriçon thelbin e shoqërisë duke analizuar ata që janë lënë në skajet e saj. Alpion e pareqet të ‘huajin’ nga një këndvështrim që nuk është i zymtë apo shkatërrues por pozitiv dhe sfidues’.



e saj, që u botua në revistën shkencore ‘Albanian Journal of Politics’ nëAmerikë, thekson se ky libër,i cili ‘të kujton shkrimet e Durkheim-it rreth të ‘huajve’ që vizitojnë vende të ndryshme…mbulon shekuj dhe kulturatë shkuara dhe bashkëkohore. Alpion na inkurajon të mendojmë në mënyrë reflektuese dhe kritike rreth besimeve, eksperiencave dhe botëkuptimeve tona, duke krijuar në proces mundësinë për ndryshim dhe për takime me ‘civilizime’ qëndryshojnë nga civilizimi ynë, me të cilët ndeshemi çdo ditë ose personalisht ose nëpërmjet mediave.’

Nicolas Pelham, ish editori i gazetës ‘The Middle East Times’, aktualisht korrespondent i gazetës britanike ‘The Economist’ në Jeruzalem, shkruan: ‘Alpion synon të bëj në letër atë që (bashkëkombësi i tij) Muhamet Aliu bëri në politikë (para 200 vjetësh): pra, të çliroj Egjiptin nga psikoza e kompleksit të inferioritetit nacional, t’i rikthej këtij vendi krenarinë kombëtare, dhe të ringjall Egjiptin për Egjiptianët. Në shkrimin e tij të titulluar ‘Kompleksi ndaj të huajve’ Alpion përshkruan esencën e pesë mijë viteve të identitetit Egjiptian me më shumë saktësi se një mijë shkrime gazetash të dërguara nga Kajro’.

P. K. Pabla nga Kolegji Cordia në Indi, në reçencën e saj në revistën shkencore ‘International Journal on Humanistic Ideology’, që botohet në Rumani, ndër të tjera thekson se Alpion ‘trajton disa tema kontroversale në këtë libër. Volumi thekson rëndësinë e mirëkuptimit ndër-kulturor dhe të bashkëekzistencës mes civilizimeve. Mesazhi i librit për njerëz nga civilizime të ndryshme është të mirëpresin të ‘huajin’ pa paragjykime.’

Studiuesja britanike Antonia Young e Universitetit të Bradford-it në shkrimin e saj për këtë vepër, që u botua në revistën shkencore ‘Central & Eastern European Review Journal’, thekson: ‘Alpion vështron në mënyrë shumë depërtuese metodat nëpërmjet të cilave shumë individë, por veçanërisht grupe fetare, politike dhe mediat, kanë keq-interpretuar jetën dhe veprën e NënëTerezës, përfshirë edhe Malcolm Muggeridge i cili e ‘zbuloi’atë në 1968’.

Ndërsa akademikja e Universitetit të Kalkutës Profesoresha Bonita Aleaz në shkrimin e saj, që u botua në Indi në gazetën ‘The Statesman’, nënvizon: ‘Dy tipare të rëndësishme nga pikëpamja e sjelljes dhe qëndrimeve e përshkojnë këtë vepër. Autori ka bërëç’është e mundur që të thurë manifestimet e këtyre tipareve në të gjitha vendet e ndryshme qëmbulon libri. Këta dy tipare jane ‘kompleksi i inferioritetit ndaj të huajve’, si dhe ‘izolimi social’. Aleaz e përfundon shkrimin me këto fjalë: ‘Libri përcjell mesazhe të rëndësishme për ata qëkërkojnë të ndërtojnë të ardhmen në vend të huaj’.

Akademiku i mirënjohur i Universitetit të Nottingham-it në Angli dhe Presidenti i Shoqatës Britanike të Sociogjisë, Profesor John Holmwood nënvizon: ‘Globalizimi ka nxjerrë në pah një përceptim më të ndjeshëm të ndërlidhjeve të kulturave në një kohë kur përceptimi tradicional dëshmon arrogancën që rezulton nga përceptimi i qendrës së privilegjuar. Dr Gëzim Alpion është një shoqërues ideal në udhëtimet ndër dhe

publicisti dhe shkrimtari i njohur amerikan Stephen Schwartzthekson se ‘libri ofron edhe më shumë prova se Profesor Gëzim Alpionështë një nga observuesit më inteligjentëdhe më të mprehtëikulturës shqiptare, si dhe i përfaqësuesessë saj më të famshme në kohët moderne, Nënë Terezës’.

përtej kulturave. Ai sjell një humanizëm sensitiv dhe këndvështrimin e një dijetari mendjemprehtënë trajtimin e një morie kulturashkomplekse në botën e përçarë.’

Studiuesi indian Profesori G. Gispert-Sauch, në shkrimin e tij, që u botua në revistën shkencore ‘Journal of Theological Reflection’, ndër të tjera thekson: ‘Një nga tezat kryesore të librit është se ekziston, veçanërisht në akademi, një diskriminim dhe padrejtësi organike ndaj vendeve që nuk përfshihen në Botën e Parë, dhe se Shqipëria dhe vende të tjera në Europën Lindore përjetojnë të njëjtin diskriminim, ashtu siç ndodh me vendet islamike në Azinë perëndimore dhe në kontinentin afrikan dhe atë aziatik. Kjo vepër dallohet për shumëtipare të vlefshme: ky është një libër i domosdoshëm për programe që përqëndrohen nëstudimin e avancuar të etikës së mediave, veçanërisht pjesa e tretë, që mbyllet me një apel ndaj gazetarëve perëndimorë, apel që në fakt do t’ju vlente të gjithë gazetarëve për të ‘dhënë kontibutin e tyre tëçmueshëm për të bërë Europën,unë do të shtoja, edhe botën, një të vetme. Libri, gjithashtu, eksploron rëndësinëe ‘natës së errët të shpirtit’ tëNënëTerezës në kulturën post-moderniste; nxjerr në pah rëndësinë e konceptit sociologjik të ‘kapitalit të famës’ si një variable nëkontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar, trajton politikën e besimit dhe mugesës së tij në kulturën tonë, shtjellon temën e pronës kognitive dhe intelektuale, si dhe rëndësinë e së drejtës së autorit. Natyrisht, libri na mundëson të mësojmë shumëedhe rreth Shqipërisë dhe fqinjëve të saj. Kjo vepër nxjerr në pah një të nga skajet qëburon në fakt nga brendësia e gjeografisë që ndonjëherë konsiderohet gabimisht si një ‘botë e pasur’ në mënyrë uniforme’.

Dhe se fundi, publicisti dhe shkrimtari i njohur amerikan Stephen Schwartzthekson se ‘libri ofron edhe më shumë prova se Profesor Gëzim Alpionështë një nga observuesit më inteligjentëdhe më të mprehtëikulturës shqiptare, si dhe i përfaqësuesessë saj më të famshme në kohët moderne, Nënë Terezës’.

http://amzn.to/2xu63qi&http://amzn.to/2i1tmRr

**Xhemail Peci është poet dhe shkrimtar. Ai ka një MA në Studimet Amerikane,*

Histori dhe Politikë nga University College London

Londër, 14 Tetor 2017

Rruga e Arbërit nr. 138 .139.

Nostalgji per socializmin

Nga **Ramiz GJINI**

Eh, cfare begatie kemi pas ne socializem! Lere, lere...

Me mbushen syte me lot kur e kujtoj... Aq shume me ka marre malli per ate kohe, sa.... Katundin tone, Kastriotin, e pat mbytur bolleku. Se, qe ta dini ju, edhe bolleku te mbyt, te merr frymen kur te mbulon...

Kishim stalle lopesh, stalle delesh si dhe stalle pulash, pore qumeshtin, mishin, leshin, vezet e te gjitha, i dorezonim ne shtet. Ne qeme te pasur e te lumtur, sepse tek e fundit, stallat ishin prone e jona dhe ne krenoheshim me gjithshka kishim e nuk kishim....

Po mollet?! Ah! mollet e Kastriotit; edhe ne enderr me shfaqen. Aq shume molle ka pas ne Kastriot, sa nuk i transportonin dot maunet, ndaj dhe kalbeshin. I kapte bora ne parcela, por ne i mbulonim me kashte, qe te rrinin ngrohte se na dhimbseshin. Dhe linin aty nje roje si pune katili, qe po t'i afroheshe te gjuante me gure e ndaheshe nanas me te.

Ku shkonin ato maune te ngarkuara me molle Kastrioti?! Ca eksportoheshin jashte, ca drejt e te Blloku ku jetonin, hanin e dhjesnin shoket e byrose politike. Por edhe ne hanim, qe c'ke me te, pse jo...

Mbaj mend, qe ne dyqanin tone shiteshin thela molle. Thela, te medha, mesatare dhe te vogla; pra, dicka si hazerllup, qe populli i Kastriotit te mos lodhej duke i prere me thike. Kjo ndodhte, sidomos, nje dite para festes se vitit te ri. U hiqnin kalbesinen dhe ia shisnin popullit te Kastriotit me 6 leke kilogramin.

Dhe... O zot, kur e kujtoj! cfare rregulli ka pase!

Kur vjeleset e molleve linin punen, brigadjeri u kontrollonte torbat e bukes se mos kishin fshehur aty ndonje kokerr molle. Dhe ashtu duhej, perderisa ato gra, qene llupese te medhaja, nuk ngopeshin kurre edhe pse kishte plot. Pastaj, perse te vidhnin derisa paguheshin shume mire?

Me pagen e nje dite, punetoret e fermes mund te blinin, jo shaka, por dy buke gruri; njeren per vehte, tjetren per komshiun kooperativist.

Ky komshiu kooperativist, kur realizonte normen me kazem e lopate, e kishte pagen tridhjete leke te vjetra ne dite. Sepse edhe puna, asokohe ka qene bio. Behej vetem me kazem e lopate, nuk ka qene e manipuluar me teknologji.

Ju ndoshta keni harruar, por nje buke misri kushtonte vetem tridhjete leke. Dhe, merreni me mend: ato tridhjete leke, fshatari nuk i merrte per nje muaji si ne vendet kapitaliste, por i merrte vetem per nje dite. Dhe t'i merrje kaq leke vetem ne nje dite, nuk ishte pak, apo jo? Aq e shijshme ishte at'here buka e grurit, sa katundari yne e shtynte buken e misrit me buke gruri. Por ne, si ne...! Ndonese mes bollekut, prap nuk na rrinte bytha rehat, sepse vidhnim, vidhnim sa i luanim fene, te gjithe pa perjashtim.

Nuk vidhnim per te vene kapital, ej... Vidhnim, thjeshte se na hahej... Cudi, si na hahej kaq shume asokohe, xhanem?! Dhe kjo vjedhje, ishte si te vjedhesh per sport, per hicgje, vetem sa per tu turperuar.

Edhe pse e dinim, qe te vjedhesh nuk ishte nje gje e mire, ne prap vidhnim... Nuk di pse e benim...

Kur na kapnin, na gjobisnin, na vendosnin fleterrufe si dhe na diskretitonin si hajdute para popullit tone kryehajdut.

Kurse kuadrot... Ata shkriheshin me popullin, shkriheshin dhe ngrinin prape. Shumica kishin pak bark si shenje dallimi. Ata i kishin grate antare partie, qe gjithmone ishin shume dakort me parafolsin.

Parafolsi ne Kastriot, ka qene sekretari i partise, shoku Rushit. Edhe sot i kemi parafolsit si athere, por sot, te pakten u a futim ndonje te share aq drejtepersedrejti sa i bejme te shkrihen gazit.

Tani, kur e kujtojme ate kohe, na kap nostalgjia, nje nostalgji per heroizmin tone, per ngadhnjimin; per punen me vrull revolucionar e jetesen roje te grumbulli i misrit ne are. "Pa, pa, pa...", ia bej une nganjehere me vehten time kur me kap nostalgjia, " sa i bukur pat qene ai xhumleku i sfungjerit, qe ia mora kusheririt tim uha, qe te shkoja e te konkuroja ne Tirane per tu futur ne Akademine e Arteve! Ashtu xhumleku nuk ka tani, sepse nuk ka as karrocjere tregetie. Vetem ata mund te ta gjenin nje xhumlek te tille kaq te bukur me vija. Eh, cfare te shtymje kam bere une kur preva bileten e autobuzit per Tirane! Jam krenar kur e kujtoj, sepse ia theva hundet nje xhaje duke e shtyre me koke e me berryla per t'u futur te sporteli. Ai xhaja, qe ngordhalaq, nuk e preu dot bileten ate dite, une po! Lere, lere, sa i forte kam qene asokohe...

Eh, cfare malli me ka pushtua per socializminr! Cfare nostalgjie me ka zene! Ka qene tjeter kohe atehere. Dhe ne, te tjere njerez, gjithashtu! Ishim te gjithe te rinj pavarsishte viteve qe mbanin njerezit ne kurriz: njeriu i ri socialist.

Ne mbyllje, deshiroj t'ju rrefej nje episod, qe perben, si te thuash, sekret popullor, pra, nuk dua ta marrin vesh pushtetaret e asaj kohe, qe ruanin ne syrtare sekretet shteterore. Nejse...

Kur mbarova studimet ne Akademine e Arteve, vajta te beja ca leke ne Greqi. Shkuarja atje, nuk qe me avjon, as me makine, por qe me kembe, biles as me kembe, por me stervitje taktike, diku te perulur sic ecin kacaket, e diku duke rreshqitur barkas si zvarraniket, sepse bashkeudhetarit tim iu fiksua se do ta gjuanin ushtaret me snajper. Me ne fund ia dolem te hynim ne token helene, pa na gjuajte me snajper.

Filluam pune. Vilnim ullinj ne Zakinthos dhe paguheshim mire.

Per cdo dite, kur hanim, bosi na sillte dy litra vere, nje pagure me vaj ulliri si dhe mish ose peshk me shumice.

"Pini vere sa te doni" thoshte ai, "vetem mos e teproni se do bini nga ulliri". Mirepo kishim nje hallexhi me vehte qe na u merzit aq shume sa pa u bere java, deshi te ikte per Shqiperi.

U merzit pikerisht per shkak te ushqimit. E quanin Emin. Gjithe jeten nuk qe ngopur as me buke ky Emini.

"Cfar ke Emin, qe je i merzitur", e pyeta.

Emini shau njehere grekerit si neper dhembe e tha:

"Nuk hahet ky ushqimi i tyre, jo. U dogjem per nje domate turshi, per nje gote dhalle te tharte e per nje leng hoshafi.."

Pra, Emini, nostalgjine per ate kohe e kishte ku e ku me te madhe se une.

Deshi te ikte, por ne memzi ia ndolem ta mbanim. Dhe ai ndejti, e beri vetem per hatrin tone.

Televizori

Nga **Alban TUFA**

Televizori diç dërdëllet me zërin e ulur deri në minimum në këndin e odës së rrethuar me divane me dy kënde në formë u-je. Një emision që më duket se titulli i fillon me MAG. Mbi divane janë ulu burrat, që po ti numërosh me kokë nuk janë më shumë se 8-9 veta. Nuk dallohet leht nëse janë mbledhur për mirë apo janë mbledhur për keq, por mundet me qenë mbledhë pa sebep, sepse katër burrat janë të shpisë.

Mu në krye të vendit është ulë mixha Sulë. Një plak rreth të tetëdhjetave. Mban në kokë në kësul pingul me rrashtën e kresë. Mustaqe të holla, të thinjura dhe me majë të përdredhur natyrshëm. Gëzon një pamje fisnike, ndoshta kjo e fituar me burrërinë dhe nderin e fituar ndër vite. Krahas tij janë ulë dy fqinjë, të cilët e njohnin mirë. Nga ana tjetër ishte ul edhe Xhema, nga një fshat përkundruall, me të cilin Sula, kishte ndarë shumë mexhelise dhe ia njihnin mirë llafet sho-shoqit. Ishin edhe disa nipër dhe një dhëndërr. Shtula, i zoti i shpisë, nuk ishte fort burrë i paqenë, dhe me thënë të drejtën e nderonte i gjithë katundi edhe katundet përrotull. I ulur në fund të odës, bash në shqemë të derës, mbante në dorë një celular. Para do kohe, i biri, i kishte hap një fejzbuk, dhe Shtula, ishte fut këmbë-e-kreje në të. Edhe dy burra tjerë ishin me celuarë në duar për qejfin e tyre dhe as kishin plan ta luanin terezinë.

Pas një heshtje të gjatë për një odë burrash, ia behu Sula:

-Para do kohe or Xhemë

-Fol or Sulë, -u shkund Xhema, se ia njihte terezitë.

-Pata shku ke një mik për me bujt një natë. Më priti mirë, boll mirë, si ai, si e shoqja e vet

Vetëmse or Xhemë, gjatë masdarkës nuk e foli asnjë llaf. Miku, e shoqja edhe cullt e vet, përpak nuk u futën këmbë-e-kreje në televizor edhe pse ishte pak më i vogël se ky që po bën dërr-dërr tashti- dhe drejtoji kokën nga televizori duke nxjerrë mjekrrën përpara. Mandej vazhdoi :

-Edhe me të thonë të shpirtit, or Xhemë nuk durova dot më dhe i thash: Ta gëzosh televizorin or mik, qenka shumë i ri (ndërkohë që në një cep ishte pak u thyer dhe dukej se i kishte së paku 6-7 vjet), e paske ble tashti shpejt. Të ma kishte ndriçu hëna rrugën s'do e kisha gdhi aty.

-Eu or Sulë, reagoi Xhema, mandej nisi, -I blejmë kuajt sa s'bëjnë dhe i tresim për mos me na përdorë ata ne. I çuditshëm àsht njeriu.

BOTIME M&B

www.facebook.com/ M&B - Botime dhe Studio Grafike
Për porosi: botimemb@gmail.com/Cel: 069 20 68 603
www.mbbotime.com / I gjeni te libraria M&B *(te Selvia)*, Adrion *(te Pallati i Kulturës)*, Libraria Fleta XXI *(Peshkopi)*



KANUNI I DIBRËS

Trashëgimi etnojuridike

XHAFER MARTINI

Kanuni i Dibrës vjen si dëshmia më e madhe dhe më e plotë e tipologjisë së civilizimeve lokale shqiptare. I njëkohshëm dhe i barabartë për nga rëndësia me "Kanunin e Lekë Dukagjinit" dhe me "Kanunin e Skënderbeut" (me variantet dhe invariantet e tij), – "Kanuni i Dibrës" ka të përbashkëta dhe dallime nga dy të parët. Më hollësisht këto dallime do t'i gjeni në "Hyrjen" e mbledhësit të këtij Kanuni, shkrimtarit dhe kulturologut të mrekullueshëm, Xhafer Martini. Këtu vlen të përmend vetëm një veçori dalluese të Kanunit të Dibrës – papraninë (mospërfshirjen) e institucioneve religjoze (kishës e xhamisë) duke mos privilegjuar e favorizuar në sanksionet kanunore as klerin. Nga ana tjetër, përpos barazisë së rreptë të rregullit, të cilit duhet t'i nënshtrohet gjithkush njëlloj, pa dallim, – Kanuni i Dibrës spikat për një elasticitet më human e vetëpërmbajtje më të thellë në shumë çështje "të nxehta" si "gjakmarrja", "hakmarrja", "gjaku", "xhipi"etj.
Një tjetër "avantazh" i këtij Kanuni është sasia e bollshme e fakteve, detajeve dhe e rrëfimeve të vërteta që ballafaqohen e pranëvihen gjegjësisht me tabutë e sanksionuara dhe përkufizimet e së drejtës, duke i dhënë Kanunit dimension të gjallë sintetik.
"Kanuni i Maleve të dibrës" është dëshmia monumentale e asaj "atlantide" civilizimi të kredhur në memorien dhe etnopsikikën e dibranit.



PËLLUMBAT E RRUGËS

RAMIZ GJINI

Romani më i fundit "Pëllumbat e rrugës", vjen si përmbyllje trilogjisë groteske mbi një vend imagjinar sa edhe real, Bibollin, një provincë në Shqipërinë postkomuniste, po aq edhe kryeqytet i paradokseve, paranojës dhe megallomanisë, të përfaqësuara nga romanet "Rrëketë" (2007) dhe "Bibollasit" (2009). Pjesa e tretë e trilogjisë "Pëllumbat e rrugës", është në të njëjtin stil grotesk, të njëjtët personazhe, të njëjtin topos, por në shkallë më të avancuar të sëmundjeve të postkomunizmit.
Romani ka disa pika të forta të tij, siç kemi bindjen, dhe pikë e fortë para së gjithash është uniteti, kompaktësia e linjës së rrëfimit ironik mbi Tushin dhe Lushen në sfondin e panairit grotesk të Bibollit gjithë personazhë simulakër, që përfaqësojnë instancat shoqërore e shpirtërore të kësaj topike të njohur tashmë edhe në dy romanet e mëparshme të autorit.
Në letërsinë tonë të sotme, bashkëkohore, nuk kemi ndeshur ende me nje projekt të përmbyllur suksesshëm të një trilogjie të romanit grotesk, siç janë tre romanet e Ramiz Gjinit.

TOPONIMIA E ÇIDHNËS

HAKI PËRNEZHA, RRUZHDI BITRI

Në librin e këtyre dy autorëve janë ndërthurur meritat e mbledhësit, tejshkruesit dhe të studiuesit. Aty janë bashkë edhe filologu, edhe dialektologu, edhe antropologu e historiani. Libri i tyre është një arritje etnogjuhësore, në të cilën fjala dhe bartësi i saj nuk ndahen...
Pa dyshim, në duart e studiuesve albanologë më të njohur: E. Çabej, A. Buda, K. Frashëri, po dhe të një brezi pasuesish të tyre, ky libër do të merrte dhe do të marrë vlerë tjetër një surplus të padiskutueshëm...
Libri përmban edhe një fjalës të fjalës së rrallë ose në zhdukje të shqipes nëndialektore të këtyre anëve. Të shpëtosh një fjalë nga vdekja është një shërbim i paçmueshëm për një gjuhë.



THEMRA E AKCILIT

AGRON TUFA

Prozat e shkurtra të këtij libri kanë një dallim thelbësor nga krijimtaria ime artistike në poezi, prozë të gjatë apo ese. Diku më shumë, diku më pak, në këto proza të shkurtra ndërthuren elemente dhe të poezisë, dhe të prozës romanore, dhe të esesë. Kështu, përgjatë viteve kur u shkruan prozat e shkurtra të këtij vëllimi interesi im ka qenë kërkimi i një forme sa më të përshtatshme, duke patur si impuls parësor jo më imagjinatën e pastër letrare, sikundër ndodh në poezitë, romanet, tregimet apo novelat, por me të ashtuquajturën "lëndë e gjallë", e përftuar nga kontakti i drejtpërdrejtë me realitetin. Pra, ndryshe nga procedimet e kulluara letrare, në këto proza jam rrekur të paraqes atë realitet që kam parë dhe që e njoh mirë dhe vetëm në bazë të këtij materiali të vërtetë, të mund të krijoj një kornizë letrare të përshtatshme. Nëse në krijimtarinë e kulluar letrare përparësi ka qenë imagjinata dhe fiction-i, në këto proza të shkurtra përcaktues është fraktura e realitetit konkret, të marrë drejtpërdrejt apo tërthorazi, në dorë të parë.
Nxitje për këtë ka qenë një frazë e ndeshur në një tregim të Vladimir Nabokovit: "Jeta është shumë herë më e papritur dhe më e talentuar se ne".



SABRI CAKA, KRAHU I SHQIPES NË FLAMUR

HALIL TEODORI

Zona jonë ka nxjerrë heronj dhe figura të shquara, personalitete të rëndësishme të kulturës dhe dijes, guximit dhe vendosmërisë, traditës dhe atdhetarisë.
Kjo kolanë e gjatë dishepujsh të vlerave dhe krenarisëi ka shërbyer vendit, por ata kanë ngelur pa u bërë të njohur, përfaqësuar dhe vlerësuar. Është detyrim i gjeneratave që në emër të mirënjohjes, në emrin e thirrjes së gjakut, në emër të më të shtrenjtës që na ndjek nga pas kudo që të shkojmë, në emër të plisit, t'i njohim, t'i promovojmë dhe ta çmojmë kontributin e tyre.
Është kjo përpjekje, është ky angazhim, është kjo detyrësi, ajo që na nxit të jemi ne ata që do të shkruajmë ato faqe të historisë që trualli na i ka besuar ne, sepse vetëm ne mund ta matim dhimbjen e kësaj toke, ta dëgjojmë kushtrimin e këtyre maleve, t'u bindemi këshillave të etërve flokëbardhë, ta lehtësojmë dhimbjen e kësaj plage".

NGA HIRI I TË VDEKURVE

AGRON TUFA

"Nga hiri i të vdekurve", një libër me ese kulturologjike.
Në këto ese shkrimtari trajton raportet e tij me fëmijërinë, vendlindjen, kulturën, traditën, ideologjinë, gjuhën, historinë dhe artin e të shkruarit.
Përmes stilit të tij ekspresiv, dinamik e sugjestiv, Tufa në këto ese bën një guidë meditative nëpër stacione të trazuara të së shkuarës dhe bashkëkohësisë dhe në sëmundjet e qytetërimit tonë.

TË JETOSH NË PAQE

NAIM BERISHA

Në këtë roman trajtohet tema e qëndresës së popullit të arbërit në kohën e Skënderbeut. Duke glorifikuar familjen e lashtë të Berishëve të Mazrekave në Gardh të Poshtëm, dmth, në Muhurrin e sotëm të Dibrës së Poshtme dhe të dy gjeneralëve të Skënderbeut, vëllezërve Dhimitër dhe Nikollë Berisha, djem të Gjergj Berishë Mazrekës dhe Majra Kastriotit) ai, në të njëjtën kohë, glorifikon gjithë qëndresën heroike të Arbërisë nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër tiranisë së pashembullt turke. Ky roman me bazë historike të vërtetë është sa tërheqës dhe intrigues, aq dhe me interes e domethënës. Si i tillë, ai lexohet me një frymë.

DIBRA NË SHEKUJT E SUNDIMIT OSMAN

MUNIR SHEHU

Askush nuk mund të thotë se këto këngë e gojëdhëna u trilluan ashtu, kot së koti nga populli. Ato e kanë një burim, për këtë as që mund të dyshohet.
Në to shihet qartë vringëllima e shpatës, lufta për mbijetesë, për liri.
Burimi është populli, vetë historia e tij. Pra, mund të konsiderohen si dokumente historike për ngjarjet që përshkruhen në to.
Çështja e folklorit me burim shumë të vjetër është si puna e muzikës. Nuk mund ta lexosh melodinë pa parë më parë çelsin e muzikës në krye të pentagramit.
Ashtu si për muzikën, që, këtë çelës nuk mund ta gjesh gjëkundi, vetëm në muzikë, po ashtu edhe për folklorin, këtë çelës nuk mund ta gjesh gjëkundi, vetëm në folklor, d.m.th., në popull.

UDHË NË PASQYRË

AHMET PRENÇI

Besnik Mustafaj: Unë e kisha njohur prej shumë vitesh si lexues të pasionuar Ahmetin, gjë që, siç e shihja, kishte ndikimin e vet mbi qasjen e tij ndaj njeriut, natyrës, politikës, historisë. Tashmë nuk do të ketë vend të shprehim habinë, qoftë kjo edhe një habi e bukur, sepse ai na është shfaqur edhe si një prokuror ndryshe, hetues ndryshe dhe kryepolic ndryshe ... Ahmet Pençin e ka "zbutur" dhe vazhdon ta "zbusë" e ta përsosë poezia që ka brenda vetes.
Agron Tufa: Vargje të çlirëta, me muzikalitet spontan, që rrjedhin natyrshëm, me shpengimin karakteristik të frymëzimit origjinal, ato kanë ajrin e lirë të bjeshkëve dhe peizazheve të vendlindjes. Metaforat e freskëta që i hapin udhë përfytyrimit dhe ndjenjës..

PO TË MOS ISHTE DRINI…

NAIM PLAKU

Në përmbledhjen rrëfimore "Po të mos ishte Drini…", Naim Plaku shkëlqen si prozator. Me një gjuhë mjaft elegante dhe të përpunuar, me një stilistikë të qëruar e plot kolorit të idiomave dhe frazeologjisë popullore dibrane, na paraqet një botë të trazuar kujtesash dhe emocionesh, që kanë në bazë të tyre rrëfimet mitologjike, parahistorike dhe historike dibrane.
Etiketuar si "urtësi dibrane", ky libër është një mozaik narrativ, me themele në të folmen popullore dibrane, në kujtesën kolektive dibrane, ku autori merr ngjarjet, të ndodhurat dhe i rikrijon e i përpunon me një gjuhë të latuar e të përpunuar hijshëm. Duke përdorur një gjuhë të vrullshme, me një sens të fortë përshkrues dhe rrëfimtar, plot ngjyrime dhe stolisje me fjalë e idioma lokale, autori na çon në rrugëtime mitologjike dhe parahistorike si në rrëfimin e gjatë e të mrekullueshëm "Po të mos ishte Drini, ku do të mbytej Seta", ku tregohet historia e dy ujërave të Dibrës, në një marrëdhënie të shpirtëzuar njerëzore, me fuqi sugjestive metafizike dhe transhendente.

Rruga e Arbërit nr. 138 .139.

intervistë

Nerilda Meda

Ëndrrat ndiqen duke punuar fort!

Nga **Samet ZAGRADI**

- Je një zë premtues në fushën e gazetarisë dhe marketingut. Për një publik që të njeh më pak, kush është Nerilda?

- Nerilda është një vajzë shumë kërkuese, ambicioze dhe punëtore. Një vajzë që do ta dashuronte letërsinë edhe pse në moshën 12 vjeçare do të kthehej në atdhe pa njohur mirë gjuhën shqipe.

U rrita me një kulturë tjetër, me një kulturë ku trashëgimia ishte e shenjtë, traditat ruheshin me fanatizëm dhe gjithçka përcillej te fëmijët me pasion e dashuri. Por prindërit e mi u kujdesën që krahas punës këmbëngulëse të mësuesve grekë, të punohej edhe në shtëpi fort që të ushqehej dashuria për atdheun, për kulturën, për gjithçka që i përkiste Shqipërisë. Të vendosura në një peshore, fitorja ju takonte prindërve, të cilët vendosën që të ktheheshim përfundimisht në Shqipëri. Kështu, do të ishte viti 2006 që do të bënte një kthesë rrënjësore në jetën time. Marrja përsipër e riskut për t'u ndjerë e barabartë në një mjedis ku 98% flitej shqip e unë e njihja shumë pak gjuhën time, ose atë pak gjuhë që flisja, e flisja në dialekt, ishte një sfidë. Ah, gjuhën shqipe e mësova brenda tre muajsh, më ndihmoi anglishtja... Ironike, por e vërtetë.

Më pas u dashurova marrëzisht pas librave, pas letërsisë dhe erdhi dita ku shkëlqeva. S'do ta harroj kurrë ditën kur mësuesja ime e letërsisë më lartësoi me komplimente në prani të nënës sime, duke theksuar nivelin e lartë që kisha arritur. U emocionova, por më shumë u prek ime më, të cilës iu mbushën sytë me lot.

Aty thashë, ah, unë mund të bëhem gazetare si daja, të cilit prej vitesh ia adhuroja profesionin.

- Fol pak për karrierën tuaj (si e nise, kush ishin vështirësitë, si shkoi ajo?

- Isha nxënëse e Gjimnazit "Sami Frashëri" kur m'u dha mundësia që të shkruaja pranë një gazete të përmuajshme. Eh gazeta e dibranëve, (buzëqesh) gazeta juaj, gazeta jonë. Gazeta "Rruga e Arbërit" do të mbante mbi faqet e saj një shkrim timin, çfarë emocioni, po komunikoja me dibranët e mi për herë të parë. S'do ta harroj kurrë atë moment. Më pas duhet të zgjidhja profesionin e të ardhmes, çfarë vendimi i vështirë, sa gjatë i menduar, i konsultuar. Ju largova paksa ëndrrës me premtimin e heshtur që do t'i rikthehesha një ditë dhe zgjodha Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, dega "Ekonomiks". Nga një vajzë që dashuronte librat letrarë u shndërrova në një vajzë që do të bënte analiza ekonomie, do të studionte politika makro dhe mikro-ekonomike. E sfidova veten dhe ia dola, por teksa po përfundoja ciklin e parë të studimeve, m'u zgjua dëshira për të përmbushur premtimin e heshtur. Por si? Nuk është e lehtë të bëhesh pjesë e televizionit. Për këtë më ndihmoji motra ime, e cila pati një ide brilante për të më bërë një surprizë te një nga emisionet e Agon Channel. Kisha qenë shpesh në studio televizive si e ftuar, por si atë ditë nuk më janë "dridhur gjunjët" asnjëherë tjetër. Kisha në krahë Sonila Meçon, një ndër gazetaret më të mira në vend. Po Ambra kishte të drejtë, që kur hyra në atë studio, nuk më lanë të ikja më.

Eksperienca në Agon Channel me Sonila Meçon dhe stafin e përkushtuar dhe profesionist do të shndërrohej në eksperiencën më të bukur të punës deri sot. Isha më e vogla e stafit dhe më donin e më përkëdhelnin shumë. „Surpriza je ti" do të bëhej shtëpia ime e dytë, e doja atë emision, i doja ata njerëz, i doja emocionet e kështu punoja me shpirt pa parë orën, pa u shqetësuar a kisha ngrënë apo jo. Sonila u bë modeli i profesionalizmit që unë ndiqja, ajo thoshte që ne ngjajmë shumë dhe më jepte me kënaqësi gjithçka më duhej. "Zanati vidhet", - thonë, ndërsa mua stafi im ma kanë dhënë me duart e tyre pa hezituar në asnjë moment. Më pas, pas suksesit tek "Surpriza je ti" do të bëhesha pjesë e "Kontratës", një emision që të bënte të kuptosh çdo të thotë t'i futesh punës me kokë. Kujtoj "Kontratën" me Irma Libohovën, Lorik Canën dhe me të preferuarën time atë me Ismail Ketën. Punë, përkushtim dhe në fund produkt cilësor dhe emocione.

Do të qëndroja pranë stafit deri në momentin që në Agon Channel u ndërpre energjia elektrike... ndërkohë që pranë stafit kam qenë në hapësira shoqërore, duke i pasur sot shokë të mirë. Para një jave festuam ditëlindjen e gjashtë të gocës Sonilës, ashtu së bashku, duke ndarë të njëjtën dashuri.

"Download" në Report Tv ishte një tjetër eksperiencë që do ta mbaj mend gjatë. Emisioni im. Çfarë kënaqësie kur e quaja kështu. Erdhi natyrshëm nga një sugjerim i disa miqve të mi e më pas u kontaktova nga drejtori i programacionit i cili më bëri propozimin për punë dhe më tha të bëja një provë në studio. Pas realizimin të 2-3 dublave, ia dola. Kështu do të niste një tjetër sfidë në Report Tv, ku nuk më mungoi në asnjë moment mbështetja e stafit tim, të cilët sot i kam miq të mirë.

Dhe pas Report Tv vendosa të përfshija veten në një tjetër sfidë, botën e biznesit, marketingun. A ishte e vështirë? Shumë. Ama sot jam menaxhere marketing pranë Revistës Who, një revistë prestigjoze dhe me një lexueshmëri të lartë në Shqipëri.

- Thate me sipër qe "Rruga e Arbërit" ka qenë pikënisja e karrierës tuaj, le të themi si gazetare. Kush do të ishte mesazhi qe do t'u përcillje lexuesve dibrane dhe jo vetëm?

- Unë jam dibrane vet dhe si çdo dibran, i kam pikë të dobët patriotët e mi. Nuk mendoj se është rastësore pikënisja në një gazetë që i "flet" Dibrës. Dibranët kanë vlera e vetëm duke qëndruar të bashkuar e duke mbështetur njëri-tjetrin mund t'i lartësojmë edhe më shumë vlerat tona. Zgjuarsia fle në Dibër, por na duhet një pasqyrë e madhe për të pasqyruar këtë zgjuarsi përtej Korabit, pasqyra jemi ne, gjithë së bashku.

- Kush është Nerilda jashtë profesionit apo ekranit?

- Nerilda jashtë ekranit nuk ndryshon shumë, pasi gjithmonë kam tentuar që të përcjell origjinalitet tek publiku. Nerilda jashtë ekranit, (qesh) nuk di të ndalet. Familja për mua është e shenjtë, prandaj përpiqem t'i kushtoj vëmendjen, përkujdesjen dhe dashurinë (në mënyrën time) që meritojnë. Jam shumë e dashur dhe e shoqërueshme, kam shumë miq dhe më pëlqen që një pjesë të mirë të kohës ta ndaj me ata.

Jam shumë ekstroverte, më pëlqen të flas me njerëz, të udhëtoj, të njoh kultura të reja, etj., etj.

Mendoj që për të tjerat duhet të pyesni miqtë e mi dhe kolegët.

- E mban mend daljen e parë në Tv? Na përshkruaj pak emocionet.

- Dalja e parë ka qenë në Televizionin Publik Shqiptar, kur kam qenë fare e vogël, dy ose tre vjeç së bashku me dy kushërirat e mia, Ejonën dhe Lunën. Nuk mbaj mend asgjë, por mami më thotë që skam folur fare. Ouu, - i kam thënë: Çuditem sa paskam ndryshuar.

Ndërkohë kam qenë e ftuar në disa emisione, nuk kam pasur shumë emocione në këto raste. Pasi në pozicionin e të intervistuarit kishim qenë shpesh përballë kamerës së Defrim Methsanit, i cili na ka trajnuar deri në detaje që ne mos të mos na dridhej qerpiku fare para kamerës. Në momentin që vëmendja ishte tek unë, pra, dola vetë para kamerave si gazetare, siç ju thashë edhe më parë "më janë dridhur gjunjët". Por kalon, më pas të duket shumë e natyrshme dhe ambientohesh me të folurit në publik apo para kamerës.

Tri gjërat që duhet të provojnë miqtë në Dibër
1. Provoni shijen e ëmbël të mikpritjes
2. Provojnë sheqerpare nga duart e gjyshes.
3. Ulu në "konak" një natë me dibranët...

Të gjithë lexuesit e rinj që aspirojnë të bëhen pjesë e televizionit apo botës së medias, mos nguroni, nuk ka asgjë të pamundur. Ja bërë disa dubla unë në fillim, u mërzit pak operatori e montazhieri, e çfarë pastaj mësohesh. Emocionet të bëjnë mirë. Vini pudër po dolët në kamera, se e sigurt që do të skuqeni nga sikleti. (qesh)

- Lidhjet tuaja me Dibrën? A e vizitoni shpesh?

- Përpiqem të jem sa më afër Dibrës. E dua atë vend, por edhe më dhimbset.

Pothuajse çdo vit e vizitoj, pasi atje kam gjyshërit, hallat, xhaxhain dhe tezen. Sa kohë do të jetë një pjesë e familjes sime atje, sigurisht që do e vizitoj shpesh. Pak më sipër shpjegova rëndësinë që ka familja për mua. Karakteristikë e dibranëve janë të bashkuar e të dashur me familjarët. Jam e sigurt që ata do të jenë të parët që do e lexojnë edhe këtë intervistë, sepse i kam pranë, edhe pse janë disa kilometra larg. Do doja shumë që një ditë të jepja kontributin tim për atë vend, pasi edhe pse nuk kam jetuar atje, e dua.

- Kush do ishin tre arsyet pse do i ftoje miqtë e tu në Dibër?

- Ah, pyetje e bukur. Së pari, të provonin shijen e ëmbël të mikpritjes dibrane. Kam vizituar shumë qytete, disa shumë më të bukura në pamje, por si mikpritja jonë nuk ka. Të presin me dashuri dhe pastërti. Si të rrish një natë, si një javë, janë të qeshur po njësoj.

Së dyti, të provojnë sheqerpare nga duart e gjyshes sime. (qesh) Jam e sigurt që çdo gjyshe do ta qante një sheqerpare për miqtë e nipit apo të mbesës. Ajo ëmbëlsirë në Dibër të shijon më shumë se në çdo vend. Lëre pastaj po të kesh ngrënë jufka me pulë më parë.

Së fundmi, për t'u ulur në një "konak" me dibranë. Zërë se kanë bërë një master për një natë. Unë fatmirësisht e kam edhe një gjysh në Tiranë, kështu sa herë mblidhemi, më bën ndonjë leksion të vogël, që të trashëgohen gjithë vlerat.

- Librat, filmat, muzika juaj e preferuar?

- Librat letrarë dhe profesionalë, profesionalë kur më duhet të zgjeroj njohuritë, letrarë kryesisht romane kur dua të çlodhem. Librat janë së pari ushqim për shpirtin e më pas për mendjen.

Filmat përgjithësisht në zhanër komedi dhe romancë, duhet gjetur gjithmonë kohë për një film të mirë me shoqërinë. Ndërsa për sa i përket muzikës, më pëlqen shumë muzika qytetare shqiptare, greke dhe latine.

S'dua të ndalem në specifikime, se atëherë do të duhet të rrimë shumë gjatë këtu.

- Planet e tua në te ardhmen? Në gazetari apo në marketing?

- Hmmm, akoma nuk e di. Komunikim janë të dyja, kështu që do të jem në një formë apo një tjetër pranë publikut. Me ndihmën e Zotit dua të bëhem gjithmonë e më profesioniste e të ngjis shkallët e suksesit.

Le të realizojmë një intervistë tjetër pas 5 vitesh dhe shohim kë kam zgjedhur. (qesh)

- Ndonjë mesazh për të rinjtë?

- Ndiqni ëndrrat! Por jo duke fjetur gjumë, por duke punuar. Mundësitë duhen kërkuar e kur nuk i gjeni, krijojini. Sfidoni veten, pa e provuar nuk mund ta dini çfarë doni. Ah, edhe diçka, mos u dorëzoni pas një eksperience të keqe pune apo pas ndonjë rrëzimi. Unë nuk e përmenda më lart, por një mësim shumë të vlefshëm e kam marrë në eksperiencën time të parë si marketiere, nuk rezultoi e suksesshme, ama, ja ku jam sot menaxhere marketingu.

FATMA METHASANI
Gjithçka arrihet me pak inteligjencë, shumë punë, përkushtim dhe dashuri

Nga **Samet ZAGRADI**

Ti je një nga figurat e më të dashura për të rinjtë në mbarë Shqipërinë. A mund të shuash kuriozitetin e një publiku më të madh në moshë? Kush është Fatma Methasani?

Si fillim i përshëndes pa përjashtim të gjithë lexuesit. Unë ndaj me shikuesit e mi çdo ditë detaje për personazhe nga Shqipëria dhe e gjithë bota, por e vërteta është që unë nuk jam e zonja ta bëj këtë për veten time. Unë jam një vajzë e thjeshtë, që bën atë që do. Po punoj në një televizion, po studioj dhe po përpiqem të bëj diçka të mirë për veten time.

A mund të na thuash me dy fjalë, si nisi karriera juaj?

Po. Gjithçka mund të them që ka ndodhur krejt spontanisht, si pasojë e një audicioni, ku unë isha e përzgjedhura. Unë aplikova mes shumë aplikantëve të tjerë dhe fitova. Në fakt, eksperiencën e parë fare- fare e kam pasur në një TV si asistente e thjeshtë. Vështirësitë më të mëdha, pasi u rritën angazhimet dhe duhet ta menaxhoja në perfeksion kohën time. Tani më dihet të gjej kohë për studime, familjen, shoqërinë, televizionin etj.

Çfarë ju motivon në jetë?

Më motivon çdo gjë e thjeshtë, por që bëhet me një dashuri të madhe.

Ti tashmë je e njohur, ke shumë ndjekës në rrjetet sociale. Si ka ndryshuar jeta jote para dhe pas famës?

Nuk është se ka ndryshuar. Siç e thash dhe pak më parë që sfida e vetme mund te jetë koha, pasi me të vërtetë e kam me të kufizuar për shkak të angazhimeve. Pjesa tjetër është po ashtu siç ka qenë. Unë thjesht po bëj një punë ashtu si çdokush bën punë e tij pa ndryshuar ndonjë gjë në jetën e çdokujt.

Kur ke vizituar Dibrën për herë të fundit?

Hmmmmm, në fakt nuk jam treguar aq vajze e mbarë për këtë. Ka disa kohë që nuk kam qenë andej, por do ta vizitoj sapo të bëhen qershitë. Unë vdes për qershi dhe sidomos ato të Dibrës (qesh).

E mban mend daljen tuaj të parë ne TV?

Nuk dua ta kujtoj! Jam shumë e sigurt që nuk do të më pëlqejë. Shaka (qesh). Sa më shumë kalon koha, çdokush rritet profesionalisht dhe bëhet më i plotësuar. Unë dua të punoj dhe shikoj përpara normalisht, pa harruar kush kam qenë.

Kush është Fatma jashtë ekranit?

Unë jam e lumtur që më kanë dhënë një format televiziv që nuk më ka ndryshuar mua si person. Edhe pasi të fiken kamerat, asgjë nuk ndryshon. Unë jam e njëjta si në emision, në jetën e përditshme. Përpiqem të menaxhoj mirë kohën që të rri me miqtë, me familjen.

Ku e sheh veten pas 10 vitesh?

Në fakt unë jam një tip që nuk më pëlqen të bëj parashikime. Thjesht bëj diçka që duhet bërë. Nuk para bëj shumë plane.

Keni ndonjë porosi për të rinjtë?

Unë besoj shumë te kreativteti i të rinjve. Besoj dhe te mrekullitë që mund të ndodhin çdo ditë. Vetëm mjafton pak inteligjencë, shumë punë, përkushtim e dashuri dhe gjithçka bëhet. Të jenë të bindur që bëhet!

Cilët janë librat që ti preferon?

Në fakt! Nuk është se kam ndonjë gjini të preferuar. Kohët e fundit po më tërheqin ato pak triller, por mbetem një romantike e pashuar.

Ka Fatma dikë që ndjek, dikë që ka shembull?

Jo një njeri specifik jo. Por shumë pak duke filluar nga prindërit, motrat, moshatarët, koleget, dhe imazhet televizivë. Nga çdokush mundohem të marr gjërat pozitive që kanë.

Ke harruar gjuhën dhe traditat dibrane?

Pse duhet ta bëj këtë. Unë jam nga Dibra dhe ato tradita kanë me të vërtetë shumë vlerë. Sidomos gjuha. Hahaha.

Vjen në skenë premiera "Gangsteret e Sufllaqes"

Jeta kulturore në qytetin e Peshkopisë gjithnjë e më tepër po zbehet duke organizuar shumë rrallë ndonjë aktivitet kulturor. Qytetarëve Dibranë shumë jo shpesh kanë mundësinë të kenë një natë ndryshe në një aktivitet kulturor sepse ato në të vërtetë janë shumë të rralla. Oda Dibrane, organizimi i përvitshëm mbetet ai më tradicionali që organizohet cdo vit por kjo nuk mjafton për të pasur një jetë artistike të pasur. Estrada profesioniste me disa element të rinj dhe të talentuar bëjnë tentativë herë pas here që të organizojnë aktivitete artisktike dhe shfaqe humori për një publik kaq të uritur për dicka ndryshe. E tillë ishte dhe shfaqja që aktori dhe regjizori i ri dhe i talentuar Dibran Engjëll Hoxha vendosi në skenën e pallatit të kulturës Haki Stërmilli në datat 13 dhe 14 tetor.

Me një titull sa komik aq dhe provokues " Ganksterët e Sufllaqes" gjë që nuk egzistojnë, vjen duke u dhuruar publikut dy net ndryshe mes te qeshurave, batutave dhe muzikës popullore dhe qytetare. Interesi i artëdashësve Dibranë ishte me të vertetë i kënaqshëm dhe i larmishëm për sa I përket moshës së publikut. Të rinj, të vjetër, gra, burra dhe fëmijë mbushën sallën e pallatit të kulturës që si rrallë herë ndodhte të mbushej. Aktorë të estradës profesioniste të Peshkopisë në bashkëpunim me një grup aktorësh po profesionistë të akademisë së arteve në Tiranë, si Erion Hodo, Lindjana Dubraku, dhe Ketjona Pecnikaj na dhuruan të qeshura dhe një shfaqe të bukur. Risi e këtij spektakli ishin dy emra të rinj dhe të talentuar që i dhanë një hijeshi dhe gjallëri për dy net publikut. Bësht fjalë për prezantuesen gojëëmbël Ilda Muka dhe këngëtaren me një zë premtues që arriti të merrte disa herë duartrokitjen e publikut Desara Haka.

Regjizori i shfaqes në një intervistë eksluzive për gazetën " Rruga e Arbërit" zbuloi për publikun disa detaje mjaftë interesante rreth vetes së tij, rreth shfaqjes dhe planeve të tij personal në karierën që duket mjaftë premtuese. Zoti Engjëll Hoxha nuk është një fytyrë e panjohur pasi ai për dy vite ka qenë pjesë e spektaklit më të madh të humorit sic është "Portokalli" a në kanalin televiziv Top Channel gjë e cila e ndihmoi të formohet si aktorë. Ai është vetëm 23 vjec dhe studion në akademinë e arteve dega aktrim si dhe pjesë e aktorëve të teatrit të Metropolit dhe atij Kombëtar. Si aktor dhe herë herë regjizor i estradës profesioniste Peshkopi tashmë prej 6 vitesh zotëron 3 premiera si regjizor dhe 9 si aktor prfesioinist.

Shfaqja "Gangsterët e Sufllaqes" nëpërmjet humorit vuri në dukje disa problematika që shqetësojnë komunitetin tonë duke i modifikuar dhe sjellë bukur para publikut. Rruga e Arbërit ishte një nga problematika te fokusuara ku aktorët trajtuan mundimet dhe torturat që hasim kur mendojmë që të udhëtojmë drejt Tiranës. Problematikat e të rinjëve në ditët e sotmë, kontraditat mes brezave, gjuha e bukur dhe karaterisitike dibrane bëri që idetë e regjizorit të përcohen me sukses tek publiku. Ai tregoi për ne që ishte pak ne siklet nese mesazhi do të përthithej ashtu sic ai donte duke mos u keqkuptuar nga njerëzit.

Ai shprehet që se përmes premierës "Ganksterët e Sufllaqes" bëri një eksperimet me publikun Dibran ku solli në Peshkopi fytyra të reja dhe kjo doli e suksesshme ku natën e dytë te premierës salla e pallatit të kulturës ishte pothuasje plot. Nxjerrja në pah të problemeve kryesore në Dibër të trajtuara më fines , me doza humori dhe batuta tregoi që publiku kërkon më ngulm gjëra të reja dhe kupton me të vërtetë nevojën për sa më shumë aktivitete të këtij lloji. Regjizori Hoxha u shpreh optimist për të ardhmen e artit Dibran, duke premtuar që në të ardhmen bashkë më një plëjadë artistësh Dibranë që po shkëlqejnë në tregun e tyre do rikthehen dhe do gjallërojnë jetën e artit dhe kulturës. U nisa me një qëllim për Dibër:- tregon Hoxha të mbushja sallën e dhe të bëja qytetarët e mi të qeshin, për pak minuta të harronin hallet që pu u zënë frymën.

I pyetur për sfidat që pat kjo premierë, regjizori dhe aktori kryesor Engjëll Hoxha tregoi që sfidën më të madhe e ka pasur me veten e tij, duke menduar se si do e presë publiku pasi kisha nxjerrë në pah disa vyrtyte negative të tonat, që fatmirësisht publiku I mirëpriti dhe I duartrokiti pafund. Një sfidë tjetër për të ka qënë koha e shkurtër që kanë pasur në dispozicion për të ndërtuar sfafin dhe shfaqen pasi koha qenë pak më shumë se një jave. Një ndihmë të madhe dha drejtori I pallatit të kulturës "Haki Stërmilli" zoti Ismet Spahiu I cili u tregua shumë I gatshëm që kjo premierë të vihej në skënë dhe aktorët të dilnin të kënaqur si nga ana morale dhe ajo materiale pasi ato janë profesionist dhe po bëjnë një punë mjaftë të mirë për publikun Dibran.

Moisi Murra
DIBRA NGA ANTIKITETI NË MONARKI
Monografi

Botimet M&B
ISBN 978-9928-4424-9-9
Faqe: 712
Çmimi: 2000 lekë

"Biri im, shkruej një libër për luftërat e dibranëve kundër pushtuesve të huej. Asht derdhun shumë gjak në mbrojtje të trojeve tona, shumë gjak, o bir".

Im atë, si shumë dibranë të tjerë, që panë, provuan dhe u përballën me shovinizmin më të tërbuar të kohës, kishin të drejtë. Dibra është krahina që ka pësuar hemorragjinë më të rëndë të kombit shqiptar. Nuk ka lagje, fshat, kala, fushë e mal që të mos jetë përgjakur në Dibër, që nga lashtësia e thellë e deri në Luftën e Dytë Botërore.

Dibranët, ashtu si gjithë shqiptarët, kanë bërë përpjekje mbinjerëzore për çlirim, liri e pavarësi, kundër pushtimit të gjatë osman, pushtimeve shoviniste të monarkive të Ballkanit dhe të pushtuesve nazifashistë të kohëve moderne.

Nga viti 1444, kur shqiptarët nën udhëheqjen e Skënderbeut nisën dhe fituan betejën e parë kundër turqve osmanë, më 29 qershor 1444, në Torvioll, Fushë të Kastriotit të Dibrës së Poshtme dhe deri në çlirimin e Dibrës nga pushtuesit nazifashistë, më 2 shtator 1944, dibranëve iu është imponuar një luftë në çdo dhjetë vjet. Dhe kjo nuk është pak.

Në këtë punim bëhet fjalë për Trevën Dibrane, për Oranikun (Shehri) e Dibrës, Peshkopinë, Albanopolisin e Ptolemeut, Principatat e Dibrës, lokalizimin e betejave të Skënderbeut në Dibër, organizimin administrativ dhe shoqëror të Dibrës, për Nandë Malet e Dibrës, për oxhaqet, bejlerët dhe agallarët e Dibrës; për qëndrimin e Fuqive të Mëdha ndaj çështjes dibrane, për politikat aneksioniste serbe ndaj viseve shqiptare, për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, lëvizjen kaçake në Dibër, për luftërat kundër ushtrive serbe, masakrat serbe dhe qëndresën mbinjerëzore të dibranëve, për shkolla e shkrim shqip, për demokratizimin e vendit etj...

Nëse është hedhur një gur i vogël në themelet e kalasë së madhe të Dibrës martire, merita është e dibranëve të mëdhenj, që i kanë parë dhe matur ngjarjet e kohës që kalonte Dibra dhe gjithë viset shqiptare me fuqinë e mendjes dhe grykën e pushkës.

Ka shumë mendimtarë që thonë duhet vështruar vetëm para. Por ka dhe një pjesë tjetër që thonë se duhet kthyer koka dhe prapa. Dibranët kanë arsye ta kthejnë kokën prapa, kudo që të jenë, sepse kanë një histori që shumë vende të botës, po ta kishin nuk do të pushonin së krenuarit ditë e natë.

Shkëputur nga parathënia

Informacion mbi libraritë ku mund të gjeni botimet tona ose mund t'i porosisni:

- Rrjeti i librarive Adrion
- Agjencia e Shperndarjes Dita, pranë 21-dhjetorit
- Agjensia e Shperndarjes Reklama si dhe pikat e saj të shpërndarjes në Tiranë te Farmacia 10; Bulevardi Deshmoret e Kombit (pranë Monumenti të 100 vjetorit); Rruga e Kavajës (përballë Volksvagenit); Hyrja e Parlamentit; Ura e Lanës (te Bulevardi Dëshmorë e Kombit) etj..

Librari M&B - Tiranë
Librari Fleta XXI - Peshkopi

Për kontakt:
Botimet M&B
Rruga "Isa Boletini", Nd.2, H.12, Nj.Admin.nr.9, 1017, Tiranë
Tel. 069 20 68 603 (Viber).
Tel. 068 65 08 441 (ËhatsApp).
E-mail: mbbotime@gmail.com
Facebook: https://goo.gl/hj606c
ëëë.mbbotime.com
Vendndodhja në hartë: https://her.is/2moOba1